



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice

**RAPORTI VJETOR I PUNËS
DHE I PERFORMANCES SË
AKADEMISË SË DREJTËSISË
PËR VITIN 2024**

Prishtinë, 2025

Tabela e përmbajtjes

FJALA HYRËSE	6
1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	8
2. KORNIZA LIGJORE.....	9
2.1 Përmirësimi i bazës ligjore në periudhën raportuese	9
2.2 Vështirësitë ligjore që ka hasur institucioni në përmbushjen e misionit të vet.....	10
3. PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT	10
3.1 Misioni / Vizioni	10
3.2 Kompetencat e AD-së sipas ligjit	11
4. FUSHËVEPRIMI I AKADEMISË SE DREJTËSISË.....	11
4.1 Organizimi, veprimtaria dhe personeli.....	11
4.2 Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë	12
4.3 Këshilli Programor i Akademisë së Drejtësisë	14
4.4 Ekzekutivi - Drejtori Ekzekutiv i Akademisë së Drejtësisë.....	15
4.5 Menaxhmenti i mesëm.....	16
4.5.1 Mandati i Departamenteve	17
4.6 Burimet njerëzore.....	18
4.6.1 Numri i punëtorëve	19
4.6.2 Nevojat për punëtorë të rinj	19
4.6.3 Paraqitja në formë tabelare e numrit dhe llojit të trajnimeve të stafit	20
4.7 Asetet në posedim të Akademisë së Drejtësisë.....	21
4.7.1 Planet për asete të reja.....	21
5. AKTIVITETET E AKADEMISË SË DREJTËSISË PËR VITIN 2024.....	21
5.1 Krahasimi punës së AD-se për tri vitet e fundit.....	22
5.2 Plani i punës dhe performances për vitin 2024.....	23
5.2.1 Përgatitja profesionale e gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapo emëruar.....	24
5.2.2 Avancimi i vazhdueshëm i njohurive profesionale dhe interdisiplinare të gjyqtarëve, prokurorëve, stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial si dhe profesionistëve të tjerë ligjor	24
5.2.3 Zhvillimi i programeve trajnuese përmes analizave, hulumtimeve dhe veprimtarisë botuese.....	25
5.2.4 Avancimi edhe më tej i metodologjisë trajnuese	25
5.2.5 Avancimi dhe zgjerimi i bashkëpunimit dhe koordinimit me partnerët vendor, partnerët ndërkombëtarë, donatorët dhe institucionet relevante trajnuese ndërkombëtare.	25

5.3	Aktivitetet e Akademisë së Drejtësisë në përmirësimin e veprimtarisë së saj të përcaktuar me ligj	26
6.	PËRMBUSHJA E PLANIT TË PUNËS DHE TË PERFORMANCËS SI DHE PROGRAMEVE TRAJNUESE, REKOMANDIMET DHE SFIDAT	26
6.1	ARRITJET NË ZBATIMIN E PLANIT TË PUNËS DHE TË PERFORMANCËS SI DHE PROGRAMEVE TË TRAJNIMEVE GJATË VITIT 2024	27
6.2	PËRGATITJA PROFESIONALE E GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE TË SAPO EMËRUAR TË GJENERATËS SË X SI DHE HARTIMI DHE ZBATIMI I PROGRAMEVE PËR GJYQTARËT E GJENERATËS SË XI DHE XII	29
6.2.1	Aktivitete e realizuara në Programet për Trajnim Fillestar gjatë vitit 2024	29
6.3	AVANCIMI I VAZHUESHËM I NJOHURIVE PROFESIONALE DHE NTERDISIPLINARE TË GJYQTARËVE, PROKURORËVE, STAFIT ADMINISTRATIV GJYQËSOR DHE PROKURORIAL SI DHE PROFESIONISTEVE TË TJERË LIGJOR - (PTV)	33
6.3.1	Aktivitetet trajnuese të realizuar gjatë vitit 2024 në kuadër të Programit për Trajnim të Vazhdueshme, arritjet dhe sfidat	34
6.3.2	Aktivitetet e realizuara nga Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm sipas fushave	35
6.3.3	Trajnuesit e angazhuar në zbatim të Programit për Trajnim të Vazhdueshme në vitin 2024	41
6.3.4	Mbështetja e donatorëve në ofrimin e trajnimeve të vazhdueshme	42
6.4	ZHVILLIMI I PROGRAMEVE TRAJNUESE PËRMES ANALIZAVE HULUMTIMEVE DHE VEPRIMTARISË BOTUESE	43
6.5	AVANCIMI I MËTEJMË I METODOLOGJISË TRAJNUESE	48
6.6	BASHKËPUNIMI DHE KOORDINIMI ME PARTNERËT VENDOR, PARTNERËT NDËRKOMBËTARË, DONATORËT DHE INSTITUCIONET RELEVANTE TRAJNUESE NDËRKOMBËTARE	49
	Programet praktike dhe shkëmbimi i përvojave me vendet në rajon	53
6.7	NGRITJA E TRANSPARENCËS DHE MARRËDHËNIA ME PUBLIKUN	57
6.8	NGRITJA E CILËSISË SË SHËRBIMEVE ADMINISTRATIVE DHE SHPENZIMEVE FINANCIARE TË BUXHETIT	58
7.	PLANIFIKIMI DHE EKZEKUTIMI I BUXHETIT DHE RAPORTI FINANCIAR	60
8.	SFIDAT E VITIT PARAPRAK DHE REKOMANDIMET PËR VITIN 2025	66
9.	Shtojcat	67
	Shtojca 1. Tabela me indikatorët dhe performancën e AD-së për vitin 2024	68
	Aneksi I – Trajnimet e realizuar në të gjitha programet e AD-së	73
	Aneksi II-Trajnimet e realizuara në PTF gjatë vitit 2024	74
	Trajnimet e zbatuara për gjeneratën e X të gjyqtarëve	74
	Aneksi III-Aktivitetet e realizuara në PTV	80

Aneksi IV-Trajnimet për bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor të gjykatave dhe prokurorive.....	85
Aneksi V-Trajnimet për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial.....	89
Aneksi VI–Trajnimet për profesionet e lira	91
Aneksi VII–Trajnimet per Trajnues	92
Aneksi VIII-Trajnimi për gjyqtarët porotë dhe Menaxhmentin e Prokurorive	93
Aneksi IX-Platforma e mësimit ne distancë	93
Aneksi X- Aktivitetet e realizuara në PHP	93
Aneksi IX-Aktivitetet me donatorë	94

Akronimet

ABEK - Asociacioni i Bibliotekave Elektronike të Kosovës

AD – Akademia e Drejtësisë

AQP – Agjencia Qendrore e Prokurimit

ANJF - Agjencioni për Ndihmë Juridike Falas

DAF – Departamenti i Administratës dhe Financave

DHPGJS-Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme

EIFL - Electronic Information for Libraries

EJTN – European Judicial Training Network (Rrjeti Evropian i Trajnimit Gjyqësor)

ENM – L'École Nationale de la Magistrature

GIZ - Deutsche Gesellschaft fuer Internationale Zusammenarbeit

GJEDNJ – Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut

KDM – Kodi i Drejtësisë për të Mitur

KEDNJ – Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

KGJK – Këshilli Gjyqësor i Kosovës

KPK – Këshilli Prokurorial i Kosovës

KPPK – Kodi i Procedurës Penale i Kosovës

OSBE – Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

OPP - Oda e Përmbauesve Privat

PHP – Programi për Hulumtime dhe Publikime

PTF – Programi i Trajnimit Fillestar

PTV – Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm

SIMFK – Sistemi Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës

TI – Teknologjia Informative

USAID - The United States Agency for International Development

UNDP-Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim

UNHCR-Zyra e Misionit në Kosovë

ZKA – Zyra e Kombëtare e Auditimit

FJALA HYRËSE

Raporti vjetor i punës dhe i performancës së Akademisë së Drejtësisë për vitin 2024 pasqyron punën e Akademisë së Drejtësisë dhe aktivitetet e saj në funksion të aftësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve të rinj, avancimit të kapaciteteve profesionale dhe interdisiplinare të gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë duke përfshirë edhe stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial, si dhe profesionistëve tjerë ligjor.

Raporti në detaje ofron aktivitet trajnuese të realizuara në kuadër të trajnimeve fillestare dhe trajnimeve të vazhdueshme si dhe aktivitetet tjera sipas mandatit të saj me ligj.

Në kuadrin e programit të trajnimeve fillestare në periudhën raportuese kanë vijuar tri (3) gjenerata të gjyqtarëve të sapo emëruar dhe një (1) e prokurorëve të sapo emëruar. Gjenerata e X me 28 gjyqtarë, ndërkaq e prokurorëve me 23 prokuror. Gjenerata e XI e gjyqtarëve me 15 gjyqtarë dhe gjenerata e XII me 32 gjyqtarë. Për tri këto gjenerata konform programit është realizuar trajnimi teorik dhe praktik me përjashtim të gjeneratës së XII e cila pritet realizimin e trajnimit praktik në vitin 2025 pasi kjo gjeneratë ka filluar së vijuari trajnimin fillestar gjatë muajit shtator 2024.

Ndërsa, në kuadër të programit të trajnimeve të vazhdueshme janë realizuar trajnime për çështje të ndryshme ligjore të cilat i ka determinuar procesi i vlerësimit të nevojave trajnuese dhe veçanërisht për shkak të praktikës gjyqësore jo unike, zbatimit të gabuar qoftë të ligjit material ashtu edhe ati procedural dhe veçanërisht trajnime në fushën penale për pastrimin e parave dhe hetimit financiar, korrupsionit, dhunës në familje në aspektin penal dhe civil, trajnime për drejtësinë për fëmijë, trajnimet në fushën e ndërmjetësimit, trajnime nga lemia administrative dhe aspekte tjera të punës së gjyqtarëve dhe prokurorëve për pothuajse për të gjitha juridiksionet sipas divizioneve dhe departamenteve.

E veçantë e këtij viti ishin edhe trajnimet fillestare për 15 gjyqtarët porotë dhe përgatitja tyre për ushtrimin e funksionit të gjyqtarit porotë. Gjyqtaret porote janë emëruar në këtë pozitë nga KGJK gjatë vitit 2023 por nuk kanë arritur të jenë pjesë e trajnimit me grupin e parë prej 87 gjithsej që vijuan trajnimin në Akademi të Drejtësisë menjëherë pas emërimit.

Edhe këtë vit është vazhduar me trajnimet dedikuar bashkëpunëtorëve profesional dhe zyrtarëve ligjor nga modulet e trajnimit bazik në fushë penale dhe civile-aspekti material dhe procedural, ndërkaq për stafin tjetër administrativ të gjykatave dhe prokurorive janë realizuar aktivitete trajnuese të cilat kryesisht ishin për etiken dhe për menaxhimin e dosjes dhe lëndëve në gjykata dhe prokurori.

Janë realizuar edhe aktivitetet trajnuese për ndërmjetësuesit dhe avokatët, ndërkaq profesionistët tjerë ligjor siç janë përmbaruesit, mbrojtësit e viktimave, zyrtarët e ndihmës juridike falas dhe profesionistë tjerë ligjor, pa përjashtuar edhe bashkëpunëtorët profesional kanë përfituar edhe nga trajnimet e përbashkëta me gjyqtarë dhe prokurorë.

Pjese e rëndësishme e aktiviteteve të AD-së ishte ngritja e cilësisë së metodologjisë trajnuese dhe fuqizimi edhe më tej i zbatimit të Doracakut për trajnues përmes trajnimit të trajnuesve si dhe vlerësimit të performancës së trajnuesve të angazhuar gjatë këtij viti.

Në kuadrin e hulumtimeve dhe publikimeve janë realizuar aktivitete në dobi të vlerësimit të nevojave trajnuese dhe hartimit të programeve trajnuese, si dhe botime për nevoja të zbatimit të trajnimeve fillestare si dhe botimet me Gjykatën Supreme.

Gjithashtu gjatë vitit 2024 AD është përqendruar në zbatimin dhe përmbylljen e procesit të kërkesave nga reforma e administratës publike, respektivisht zbatimi i Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, si dhe Rregullores nr.05/2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës. Aktivitete të

konsiderueshme janë ndërmarrë ne funksionalizmin e strukturës se re organizative , plotësimin e pozitive te lira dhe ngritjen a kapaciteteve profesionale te stafit ne ushtrimin e detyrave sipas përshkimit te ri te detyrave te punës.

Në raport në detaje janë aktivitetet të cilat janë realizuar me buxhetin e AD-së dhe me mbështetjen financiare të donatorëve, miqve dhe bashkëpunëtorëve të AD-së si dhe të dhëna për shpenzimet buxhetore dhe aktivitetet e prokurimit.

Për fund shfrytëzoj rastin të falënderoj Këshillin Drejtues, Këshillin Programor, Trajnuesit, Stafin dhe bashkëpunëtorët e Akademisë për kontributin dhe angazhimin maksimal në zbatimin e gjithë këtyre aktiviteteve të lartpërmendura.

Sinqerisht,

Fejzullah Rexhepi

Kryetar i Këshillit Drejtues

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Akademia e Drejtësisë sipas mandatit ligjor është angazhuar në rritjen e kapaciteteve profesionale të përfituesve të saj sipas ligjit përmes hartimit dhe zbatimit të programeve trajnuese përshtatshëmrisht me nevojat trajnuese të sistemit gjyqësor dhe prokurorial dhe prioriteteve në nivel nacional për fushën e gjyqësorit. Për zbatimin e trajnimeve dhe aktiviteteve tjera AD është angazhuar në koordinimin maksimal me KGJK dhe KPK, si dhe kryetarët e gjykatave dhe kryeprokurorët e prokurorive. Përveç me aspektin e trajnimeve është angazhuar edhe në fushën botimeve përmes krijimit dhe zhvillimit të burimeve të reja juridike, përkatësisht përmbledhjeve të praktikës gjyqësore me Gjykatën Supreme duke mundësuar kështu unifikimin e praktikës gjyqësore në të ardhmen dhe lehtësimin në zbatimin praktik të legjislacionit në fuqi.

Programi i Trajnimit Fillestar për gjyqtarët e sapo emëruar të gjeneratës së XI dhe XII ka përfshirë 6 module trajnuese që përfshijnë aspektin material dhe procedural për gjitha kompetencat e punës së gjyqtarit në departamentin e përgjithshëm si dhe legjislacionin sa i përket të drejtave të njeriut dhe BE-së dhe shkathtësitë plotësuese. Gjenerata e XI ka vijuar trajnimin teorik ndërkaq është në proces të zbatimit të trajnimit praktik në gjykatat përkatëse të emërimit ndërkaq gjenerata e XII ka vijuar vetëm trajnimin teorik dhe pritet që trajnimin praktik ta realizoj në vitin 2025. Për prokurorët e gjeneratës së X në periudhën raportuese është realizuar vetëm trajnimi praktik meqë trajnimet teorike nga 5 module trajnuese i kanë vijuar gjatë vitit 2023. Trajnimi fillestar për dy gjeneratat e gjyqtarëve me kërkesën e KGJK-së është zbatuar intenzivisht 5 ditë të javës me sesionet e trajnimit teorik dhe më pas me sesionet e trajnimit praktik në gjykatat përkatëse të emërimit.

Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm ka përfshirë juridiksionin e të gjitha departamenteve të punës së gjyqtarëve dhe prokurorëve me fokus të çështjet ligjore që janë më të ndjeshme si: dhuna në familje, aspekti i të drejtave të njeriut, krimi i organizuar dhe korrupsionin, veprat tjera të keqpërdorimit të detyrës zyrtare, pasi është vazhduar edhe më tej përfshirja e tyre në program nga proceset integruese dhe dokumentet strategjike. . Në trajnimet e vazhdueshme kanë marrë pjesë gjyqtarë prokuror dhe sipas tematikës edhe profesionistë tjerë ligjor si zyrtarë policor, zyrtarë doganor, nga njësia e inteligjencës financiare, avokatë, përmblyes etj.

Një numër i konsiderueshëm i aktiviteteve trajnuese iu është dedikuar bashkëpunëtorëve profesional dhe veçanërisht atyre që nuk i kanë vijuar trajnimet nga moduli bazik në fushën penale dhe civile dhe bashkëpunëtorëve të rinj të rekrutuar së fundmi në këtë pozitë nga KGJK meqë ka pasur një dinamikë të shtuar gjatë vitit 2024. Gjatë periudhës raportuese AD ka organizuar trajnime edhe për stafin administrativ të gjykatave dhe prokurorive duke iu dedikuar profileve të caktuara si administratorëve, ndihmës administratorëve, shefave të zyrës për menaxhimin e lëndëve, intepretëve gjyqësor etj. Raporti përfshinë edhe aktivitetet tjera dedikuar ndërmjetësuesve.

Për zbatimin e trajnimeve janë angazhuar trajnues nga radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve kryesisht të instancave më të larta dhe më pak nga niveli themelor duke përfshirë edhe profesionistët e tjerë ligjor si avokat, profesor dhe gjithashtu edhe ekspert ndërkombëtarë të cilët kanë ofruar praktikën më të mira gjyqësore në çështjet penale, civile, administrative, drejtësia për fëmijë etj. Raporti në detaje ofron trajnimet që janë realizuar për secilën kategori duke përfshirë edhe numrin e pjesëmarrësve.

Ne raport janë paraqitur edhe aktivitetet për rritjen e kapaciteteve të trajnuesve kryesisht për metodologjinë sipas doracakut për trajnues që ka përfshirë trajnuesit e rinj.

Burimet ligjore kanë vazhduar të jenë në shërbim të përfituesve të AD-së, veçanërisht formatet elektronike dhe burime ligjore ndërkombëtare përmes ABEK dhe gjithashtu edhe botimet e fundit me Gjykatën Supreme.

Akademia përmes përfaqësuesve të saj ka marrë pjesë në konferenca e takime regjionale e ndërkombëtare, ndërkaq gjyqtarëve dhe përfituesve tjerë sipas ligjit i'u ka mundësuar pjesëmarrjen në trajnime në institucione të ndryshme të trajnimit gjyqësor në nivel rajonal dhe ndërkombëtar të cilat për qëllim kishin zhvillimin profesional të tyre.

Një numër i konsiderueshëm i aktiviteteve trajnuese kryesisht në trajnimet e vazhdueshme janë realizuar me mbështetjen e donatorëve dhe partnerë tjerë të cilat kryesisht ishin në fushën penale dhe për aspektin e të drejtave të njeriut qoftë mbështetje financiare ashtu edhe me ekspertizë duke mundësuar dhe promovuar praktikat më të mira në zgjidhjen e rasteve ligjore.

Gjithashtu prioritet e larte përgjatë këtij viti ka qene funksionalizmi i strukturës se brendshme organizative, respektivisht aktivitetet e ndërmarra nga Departamenti për Shërbime Ligjore dhe të Përgjithshme , gjegjësisht brenda përgjegjësiave dhe me kompetence ka ofruar shërbime dhe mbështetje te vazhdueshme për Këshillin Drejtues , Këshillin Programore , Departamentin e Programeve te Trajnimeve si dhe divizioneve te tjera te AD. Gjate vitit 2024 sipas planit te punës , aktivitete e departamentit janë fokusuar ne vazhdimin e përmbushjes reformës se administratës publike, reformës legjislativë sipas pakos se ligjeve për drejtësinë duke përfshi edhe plotësim ndryshimet e ligjit te AD

2. KORNIZA LIGJORE

Akademia e Drejtësisë veprimtarinë e saj e ushtron duke u bazuar në Ligjin Nr. 05/L-095 për AD-në, si dhe Ligjit nr. 08/L-063, kapitulli IV për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë dhe aktet nënligjore si në vijim:

- Rregullore Nr. 02/2017, për Punën e Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë;
- Rregullorja Nr. 02/2023 - për Plotësim dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 02/2017 për Punën e Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë;
- Rregullore Nr. 04/2017, për Punën e Këshillit Programor të Akademisë së Drejtësisë;
- Rregullorja Nr. 03/2023 - për Plotësim dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 04/2017 për Punën e Këshillit Programor të Akademisë së Drejtësisë
- Rregullore Nr. 05/2017, për Tarifat e Trajnimeve për Avokat Shtetëror, Avokatë dhe Profesionet e Tjera të Lira;
- Rregullorja Nr. 02/2019 - për Trajnuesit dhe Mentorët e Akademisë së Drejtësi
- Rregullorja Nr. 01/2023 - për Plotësim dhe Ndryshimin e Rregullores Nr.02/2019 për Trajnuesit dhe Mentorët e Akademisë së Drejtësisë.
- Rregullorja Nr. 04/2023 - Për Pranimin dhe Emërimin e Drejtorit Ekzekutiv të Akademisë së Drejtësisë;
- Rregullore Nr.5/2023 Për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Akademinë e Drejtësisë

2.1 Përmirësimi i bazës ligjore në periudhën raportuese

Në periudhën raportuese ka pasur zhvillime të reja sa i përket zhvillimit të akteve nënligjore të Akademisë së Drejtësisë të cilat kryesisht ishin në funksion të zbatimit më të mirë të trajnimeve. Në këtë kuadër është nxjerrja e Rregullores së re nr. 01/2024 për trajnimin Fillestar dhe Rregullores nr. 02/2024 për plotësimin-ndryshimin e rregullores nr. 01/2023 për trajnuesit dhe mentorët e AD-së si dhe Udhëzuesit për Organizimin e trajnimeve të vazhdueshme. Projektligji për AD-në i cili kishte me sjellë risi ligjore nuk i ka kaluar gjitha proceset për të kaluar në kuvend për miratim prandaj mbetet korniza ligjore aktuale në fuqi e lartpërmendur në këtë raport.

- Rregullore nr. 02/2024 për plotësimin -ndryshimin e rregullores nr. 01/2023 për trajnuesit dhe mentorët e AD-së
- Rregullore Nr. 01/2024 për Trajnimin Fillestar
- Udhëzuesi për Organizimin e trajnimeve të vazhdueshme

2.2 Vështirësitë ligjore që ka hasur institucioni në përmbushjen e misionit të vet

Si rezultat i pakos së ligjeve të drejtësisë të dala nga deklarata e zotimeve të KGJK-së, KPK-së dhe MD-së në kuadrin e të cilave përfshihet edhe projektligji për AD-në përveq si pjesë e grupit punues është angazhuar edhe në ofrimin e komenteve si në grupe punuese ashtu edhe në dokumentin për konsultim publik sa i përket këtij projektligji.

Projektligji për AD-në fillimisht ka përmbajtur propozime për plotësim ndryshime në përbërjen e Këshillit Drejtues dhe kohëzgjatjen e mandateve të anëtarëve, përbërjen Këshillit Programor dhe kohëzgjatjen e mandateve të anëtarëve mundësimin e realizimit të trajnimeve fillestare para dekretimit të gjyqtarëve dhe prokuroreve të sapoemëruar, propozime për trajnim të detyrueshëm për gjyqtarët dhe prokuroret me mandat të përhershëm, si dhe mundësinë e nxjerrjes të akteve nënligjore të nevojshme. Andaj sipas kërkesës së grupit punues të MD, për të gjitha këto Këshilli Drejtues i AD-së ka aprovuar rekomandimet konkrete të cilat me pas janë dërguar në Ministrinë e Drejtësisë.

Zhvillimi dhe hartimi i komenteve dhe rekomandimeve për projektligjin për AD-në, kanë kontribuar edhe partnerë kryesorë ndërkombëtarë sikurse Ambasada Amerikane, Ambasada Britaneze, OSCE, Zyra e BE dhe ekspertet e projektit të EU-EUKOJUST. Ekspertet e projektit EUKOJUST dhe AD kanë prezantuar komentet përmbledhëse në takimin e Këshillit Drejtues të cilat janë diskutuar dhe si të tilla janë aprovuar nga Këshilli Drejtues në takimin e dt. 03 qershor 2024, ku me pas të njëjtat i janë dërguar Ministrisë së Drejtësisë. Të njëjtat komente AD i ka adresuar edhe më 02 korrik 2024 në periudhën sa projektligji për plotësim ndryshimin e Ligjit të AD-së ishte në diskutim publik. Lidhur me ndryshimet e fundit të draft projektligjit për plotësim ndryshimin e Ligjit të AD-së, AD i është drejtuar Ministrisë së Drejtësisë së fundi me shkresë zyrtare më dt. 28.08.2024 ku janë rikonfirmuar qëndrimet e Këshillit Drejtues rreth komenteve sa i përket plotësim ndryshimit të Ligjit.

Projektligji për AD-në vazhdon të mbetet në pritje. Hyrja në fuqi e këtij ligji edhe pse jo në konditat çfarë është kërkuar nga kuadri ligjor brenda AD-së pritet të adresoj pengesat ligjore të Ligjit aktual dhe të ushtroj veprimtarinë e saj në mënyrë më funksionale.

3. PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT

Akademia e Drejtësisë është institucion publik dhe i pavarur. Veprimtaria e saj është në funksion të aftësisë të gjyqtarëve dhe prokuroreve të rinj për sistem si dhe ngritjes së kapaciteteve profesionale dhe interdisciplinare të gjyqtarëve dhe prokuroreve në detyrë, përfshirë edhe stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial si dhe sipas kërkesave dhe mundësive edhe për profesionet e lira. Akademia e Drejtësisë këtë funksion e realizon përmes zhvillimit dhe zbatimit të programeve trajnuese dhe burimeve ligjore në përputhje me nevojat adekuate për trajnime të cilat identifikohen nga procesi i vlerësimit të nevojave trajnuese. Akademia e Drejtësisë kryen edhe analiza, hulumtime si dhe kryen veprimtari botuese për nevojat e sistemit gjyqësor dhe prokurorial si dhe profesioneve tjera të lira.

3.1 Misioni / Vizioni

- Misioni

Të ofrojë trajnim cilësor gjyqësor për gjyqtarë, prokurore dhe staf administrativ gjyqësor dhe prokurorial, si dhe për profesionistë të tjerë në gjyqësor, analiza, hulumtime dhe veprimtari botuese, në përputhje me kornizën ligjore dhe standardet më të mira të njohura ndërkombëtarisht.

- Vizioni

Të shërbejë si institucion modern i të mësuarit, i përshtatur ndaj dinamikës së përgjithshme të zhvillimit, kontribues kryesor për një gjyqësor të paanshëm, të pavarur dhe profesional që gëzon besimin e publikut.

3.2 Kompetencat e AD-së sipas ligjit

Bazuar në kompetencat që përcakton ligji, Akademia e Drejtësisë kryen funksionet e parapara si në vijim:

- Harton programet e trajnimit dhe organizon trajnimet për gjyqtarë dhe prokurorë të shtetit në pajtim me legjislacionin në fuqi;
- Zhvillon procesin e vlerësimit të nevojave për trajnime përmes mekanizmave të përcaktuara nga Akademia, dhe në bazë të kërkesave të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (më tej: KGJK), Këshillit Prokurorial të Kosovës (më tej: KPK)
- organizon trajnime për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial, pas koordinimit paraprak të nevojave për trajnime me KGJK-në dhe KPK-në, në pajtim me legjislacionin në fuqi;
- mund të organizojë trajnime të vazhdueshme profesionale për avokat shtetëror, avokat, noter, përmbarues privat, ndërmjetësues, administratorët falimentues, si dhe profesione tjera në bazë të vlerësimeve të Akademisë, sipas kërkesave të institucioneve kompetente.
- zhvillon dhe realizon programet e trajnimeve në bashkëpunim me KGJK-në dhe KPK-në, Odat e profesioneve të lira apo institucionet përkatëse;
- mbanë të dhëna për trajnime dhe programe që realizohen në Akademi në pajtim me legjislacionin në fuqi;
- mbanë të dhëna për trajnime dhe programe që realizohen në Akademi në pajtim me legjislacionin në fuqi;
- vendosë dhe mbanë bashkëpunim me institucionet vendore dhe institucionet e huaja të ngjashme lidhur me punët të cilat i kryen, duke përfshirë praktikat profesionale dhe programet e shkëmbimit;
- kryen analiza, hulumtime dhe bashkëpunon me institucionet shkencore;
- kryen veprimtari botuese në përmbushje të mandatit për nevojat e sistemit gjyqësor dhe prokurorial dhe profesioneve të lira;
- kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me ligj dhe me akte tjera të Akademisë.

4. FUSHËVEPRIMI I AKADEMISË SE DREJTËSISË

Veprimtaria e AD-së është në funksion të aftësisë të gjyqtarëve dhe prokurorëve të rinj për sistem si dhe të gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë, përfshirë edhe stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial si dhe sipas kërkesave dhe mundësive edhe për profesionet e lira përmes zhvillimit dhe zbatimit të programeve trajnuese dhe zhvillimit të burimeve ligjore përshtatshëmrisht me nevojat e gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe të sistemit gjyqësor dhe prokurorial dhe profesioneve tjera të lira.


4.1 Organizimi, veprimtaria dhe personeli

Kompetencat dhe funksionin e saj AD i kryen përmes organeve kryesore të saj si:

- Këshilli Drejtues,
- Këshilli Programor dhe
- Drejtori Ekzekutiv.

Organizmi i brendshëm sipas rregullores nr. 05/2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Akademinë e Drejtësisë është strukturuar në 2 Departamente dhe 8 divizione

- Departamenti i Trajnimeve – duke përfshi 4 divizione
- Departamentin për Çështje ligjore dhe shërbime të përgjithshme- duke përfshi 3 Divizione si dhe
- Divizionin për Buxhet dhe Financa
- Zyrtari i Lartë i Burimeve Njerëzore
- Zyrtari i Certifikimit
- Zyrtari Prokurimit



Grafikoni nr. 1: Strukturimi i AD-së me organet dhe stafin gjatë vitit 2024

4.2 Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë

Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë ka një rol kyç në udhëheqjen dhe menaxhimin e Akademisë, duke mbikëqyrur zhvillimin dhe implementimin e politikave dhe strategjive të saj. Ai është përgjegjës për mbikëqyrjen e punës së Akademisë dhe siguron që ajo të funksionojë në përputhje me ligjin dhe rregulloret përkatëse. Përbërja e Këshillit Drejtues është shumëdimensionale dhe pasqyron një përfaqësim të gjerë nga institucione të ndryshme të sistemit gjyqësor dhe prokurorial të Kosovës. Këshilli ka në total nëntë anëtarë, të cilët emërohen nga institucione të ndryshme si Gjykata Supreme, Prokuroria e Shtetit, Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), dhe Ministria e Drejtësisë.

Këshilli Drejtues ka përgjegjësinë për përcaktimin e drejtimit strategjik të Akademisë dhe për sigurimin e zhvillimit të trajnimeve për profesionistët e drejtësisë. Ai gjithashtu mbikëqyr punën e Akademisë dhe është

përgjegjës për vlerësimin e performancës së saj, duke përcaktuar prioritetet për trajnimet dhe zhvillimet e tjera, në bashkëpunim me institucionet përkatëse. Këshilli siguron që aktivitetet e Akademisë të realizohen në përputhje me ligjin dhe kërkesat e përcaktuara për trajnimet dhe zhvillimin profesional.

Këshilli Drejtues i Akademisë përbëhet nga nëntë (9) anëtarë, nga të cilët dy (2) janë anëtarë ex officio, ndërsa shtatë (7) anëtarë nga institucionet e mëposhtme:

Anëtarë ex officio janë Kryetari i Gjykatës Supreme dhe Kryeprokurori i Shtetit, ndërsa 3 (tre) anëtar të emëruar nga KGJK dhe atë, një (1) gjyqtar nga Gjykata Themelore, një (1) nga Gjykata e Apelit dhe një (1) nga Sekretariati i KGJK-së, 3 (tre) anëtar të emëruar nga KPK dhe atë, një (1) prokuror nga Prokuroria Themelore, një (1) nga Prokuroria e Apelit dhe një (1) nga Sekretariati i KPK-së dhe 1 (një) anëtarë i emëruar nga Ministria e Drejtësisë; Anëtarët e Këshillit Drejtues emërohen në kohëzgjatje prej katër (4) vite, pa mundësi rizgjedhje edhe për një mandat.

Sipas ligjit, Këshilli Drejtues i Akademisë ka kompetencë për:

- Miratimin e akteve nënligjore të përcaktuara me këtë ligj;
- Miratimin e projektbuxhetit të Akademisë;
- Miratimin e strategjisë zhvillimore, planit të punës së Akademisë dhe programit të trajnimeve;
- Miratimin e listës së trajnerëve dhe mentorëve;
- Mbikëqyrjen e punës së Akademisë;
- Përcaktimin e prioritetëve në ofrimin e trajnimeve në bashkëpunim me KGJK-në dhe KPK-në;
- Zgjedhjen dhe shkarkimin e Drejtorit Ekzekutiv;
- Emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të Këshillit Programor;
- Kryerjen e punëve tjera të përcaktuara me ligj dhe akte nënligjore;

Këshilli Drejtues gjatë vitit 2024 ka mbajtur shtatë (8) takime në kuadër të cilave ka nxjerrë një numër të konsiderueshëm të vendimeve të cilat kanë avancuar edhe më tej punën e AD-së.

Sipas planit të punës dhe të performancës ka qenë i orientuar në shqyrtimin dhe miratimin e çështjeve si në vijim:

- Raporti vjetor për vitin 2023
- Planin e Integritetit të AD-së për vitin 2024-2026
- Listën e trajnuesve të përkohshëm
- Listën e mentorëve
- Procedurat dhe Standardet për publikim
- Projekt buxhetin e Akademisë së Drejtësisë
- Formimin e komisioneve për revistat e AD-së dhe komisione tjera tjera që dalin sipas nevojës për funksionimin më të mirë të AD-së;
- Kërkesat e KGJK-së dhe KPK-së për fillimin e trajnimit fillestar për gjyqtarët dhe prokurorët që janë në proces të rekrutimit;
- Programin Trajnues dhe Planin e Performancës për vitin 2025 si dhe çështje tjera që dalin gjatë vitit 2024.

Për më hollësisht në vijim janë çështjet më kryesore për të cilat ka vendosur gjatë vitit:

- Fillimin e trajnimit teorik pa shkëputje prej 6 muajsh për 15 gjyqtarët e sapo emëruar, gjenerata e XI të dekretuar me 16 janar 2024;
- Miratimin e Rregullores së re Nr. 1/2024 për trajnimin Fillestar
- Zbatimin e programit/moduleve për prokuroren në PTF

- Miratimin i i Rregullores nr. 02/2024 për plotësimin -ndryshimin e rregullores nr. 01/2023 për trajnuesit dhe mentorët e AD-së
- Caktimi i kompensimit për trajnuesit e përkohshëm dhe për shërbimet tjera në fushën juridike;
- Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së MD-së dhe ONK, përfshirë edhe të FMC-së për trajnimet për ndërmjetësues;
- Për trajnimin dhe testin e gjyqtarëve porot;
- Kohëzgjatjen e trajnimit bazik për bashkëpunëtorët profesional;
- Për mentorët në trajnimin fillestar për prokurorët e sapo emëruar të gjeneratës së X dhe mentorët për gjyqtarët me mandat fillestar gjenerata e XI të cilët e ushtrojnë funksionin e tyre në Gjykatën Komerciale dhe Gjykatat Themelore në pjesën praktike
- Për raportin vjetor të punës dhe të performancës për vitin 2023
- Për grupin e trajnuesve të angazhuar në trajnimin fillestar që do të bëjnë vlerësimin e punimeve hulumtuese të gjyqtarëve dhe prokurorëve të apo emëruar të gjeneratës së X dhe anëtarët rezervë;
- Për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave të rezultateve të testit në DTF të gjyqtarëve dhe prokurorëve të shtetit;
- Për miratimin e Kërkesës Buxhetore 2025-2027;
- Miratimin e Udhëzuesit për Organizimin e trajnimeve të vazhdueshme
- Miratimin e komenteve dhe rekomandimeve për draft Ligjin e Akademisë së Drejtësisë
- Miratimin e grupit punues për rishikimin e Programit Fillestar për prokurorët e gjeneratës së XI
- Miratimin e grupit të trajnuesve për hartimin e programit trajnues 2025
- Për emërimin e kryesuesit dhe zëvendësuesit të KD-së
- Miratimin e listës së përditësuar të trajnuesve, listës së trajnuesve të certifikuar në kursin për certifikimin e trajnuesve
- Miratimin e programit Fillestar për gjeneratën e XII të gjyqtarëve, si dhe për fillimin e programit për këtë gjeneratë;
- Miratimin e programit Fillestar për gjeneratën e XI të prokurorëve
- Miratimi i kërkesës së gjyqtarëve të Gjykatës Supreme për publikimin e përmbledhjes së praktikës gjyqësore
- Miratimi i kërkesës së KGJK-së për organizimin e Trajnimit të Trajnuesve
- Miratimin e Planit të Punës dhe Performancës për vitin 2025;
- Miratimin e Programin Trajnues për vitin 2025;
- Miratimi i bashkëpunimit me Akademinë Evropiane të Drejtësisë ERA
- Miratimi i kërkesës për hartimin dhe publikimin e Doracakut për Provat Elektronike në Procedurë Penale

4.3 Këshilli Programor i Akademisë së Drejtësisë

Këshilli Programor është organ ndihmës profesional i cili angazhohet për hartimin e Programit të Trajnimeve dhe për të siguruar cilësi për trajnimet e ofruara nga Akademia e Drejtësisë. Funksionet kryesore të Këshillit Programor janë:

- Hartimi i propozim programit të trajnimeve të Akademisë në bashkëpunim me KGJK-në dhe KPK-në;
- Përcjellja e realizimit të programeve dhe sukseseve të tyre;
- Të jap orientime për avancimin e metodave dhe teknikave trajnuese, pavarësisht dhe në bashkëpunim me trajnuesit dhe mentorët;
- Të jap mendim për listën e trajnuesve dhe mentorëve;

- Të jap këshilla propozime dhe sugjerime, organeve të Akademisë për përmirësimin e kualitetit të trajnimeve;
- Kryejnë edhe punë tjera të përcaktuara me këtë ligj dhe akte nënligjore të Akademisë.

Këshilli Programor sipas ligjit përbëhet prej shtatë (7) anëtarëve, të cilët i emëron Këshilli Drejtues, nga radhët e gjyqtarëve, prokurorëve të shtetit dhe ekspertëve tjerë. Mandati i anëtarëve të Këshillit Programor, me përjashtim të Drejtorit Ekzekutiv, është katër (4) vite me të drejtë rizgjedhjeje edhe për një mandat. Kryesuesi i Këshillit Programor është ex officio Drejtori Ekzekutiv i Akademisë.

Këshilli Programor ka funksionuar me 6 anëtarë meqë një nga anëtarët e Këshillit Programor ka dhënë dorëheqje. Në periudhën raportuese është shpallur konkursi për plotësimin e përbërjes aktuale. Pritjet e AD-së janë të plotësohet përbërja e këtij organi me kandidatin i cili do të plotësoj kriteret konform Nenit 6A paragrafi 4 të Rregullores Nr. 03/2023 për plotësim ndryshimin e Rregullores Nr. 04/2017 për punën e Këshillit Programor. Për të përmbushur kompetencat dhe detyrat e punës së këtij organi, dhe për më tepër fushat të cilat ky organ nuk i ka mbuluar ka angazhuar trajnues nga radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve veçanërisht për hartimin e programeve trajnuese.

Këshilli Programor gjatë vitit 2024 ka mbajtur pesë (5) takime, përkatësisht në datat 30 korrik, 12 gusht, 26 shtator, 1 tetor si dhe 17 dhjetor 2024. Në këto takime është angazhuar intenzivisht në përcaktimin e kurrikulës trajnuese të AD-së me theks te programi trajnues për gjyqtarët e sapo emëruar, gjenerata e XII, për programin trajnues për prokurorët e sapo emëruar gjenerata e XI, për programin e trajnimeve të vazhdueshme për vitin 2025 si dhe për vlerësimin e performancës së trajnuesve të përkohshëm të AD-së të angazhuar në zbatimin e trajnimeve fillestare dhe të vazhdueshme gjatë vitit 2024. Në koordinim me grupin e trajnuesve të përcaktuar nga Këshilli Drejtues ka ushtruar me sukses funksionin e tij në shqyrtimin dhe përgatitjen e programeve sipas specifikave dhe përfituesve si dhe për herë të parë edhe shqyrtimin e performancës së trajnuesve dhe rekomandimet për Këshillin Drejtues.

4.4 Ekzekutivi - Drejtori Ekzekutiv i Akademisë së Drejtësisë

Bazuar në Ligjin për Akademinë e Drejtësisë dhe Rregullores Nr. 04/2023 Për Pranimin dhe Emërimin e Drejtorit Ekzekutiv të Akademisë së Drejtësisë, Drejtori Ekzekutiv bën pjesë në kategorinë e Zyrtarëve të Lartë Drejtues. Gjatë vitit 2024 është fokusuar në realizimin e aktiviteteve si në vijim:

- a. Përfaqësimin e Akademisë para institucioneve vendore dhe ndërkombëtare;
- b. Menaxhimin, administrimin e përgjithshëm dhe ligjshmërinë e punës së Akademisë;
- c. Zbatimin e vendimeve të Këshillit Drejtues;
- d. Propozimin e projektbuxhetit vjetor të Akademisë;
- e. Propozimin e Planit të Punës dhe Performancës për vitin 2025
- f. Propozimin e Programit të Trajnimeve të Vazhdueshme për vitin 2025 dhe trajnimeve fillestare për gjyqtarët e sapo emëruar gjenerata e XI dhe XII;
- g. Propozimin e listës së trajnuesve të përkohshëm për përditësimin e listës së trajnuesve të AD-së për miratim nga Këshilli Drejtues;
- h. Menaxhimin me mjetet financiare dhe pronën e Akademisë;
- i. Përgatitjen e raporteve të rregullta vjetore dhe raporteve tjera sipas kërkesave të Këshillit Drejtues.

Aktivitetet e Drejtorit Ekzekutiv kanë qenë të orientuara në funksionimin më të mirë të punës së AD-së përmes përfaqësimit të rregullt, menaxhimit dhe administrimit të përgjithshëm, përfshirë edhe ligjshmërinë e punës së AD-së.

Një pjesë e konsiderueshme e angazhimit të tij ishte në funksion të zhvillimit dhe avancimit të programeve trajnuese për përfituesit e AD-së sipas ligjit dhe në këtë kuadër bashkëpunimit dhe koordinimit me KGJK dhe KPK, kryetarët dhe kryeprokurorët, përfshirë edhe trajnuesit e AD-së cilët kanë qenë pjesë e zbatimit të programeve trajnuese në pajtim me kërkesat dhe nevojat për trajnim. Aktivitete bashkëpunimi të shtuara ka pasur me Ministrinë e Drejtësisë, si dhe me odat e profesioneve të lira në Kosovë, ku janë realizuar aktivitetet trajnuese rifreskuese për ndërmjetësuesit e licencuar.

Në periudhën raportuese Drejtori Ekzekutiv ka pasur takim me Komisionin për Legjislacion, Mandate, Imunitete Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsion për të paraqitur zhvillimet dhe sfidat e AD-së në përmbushjen e veprimtarisë së saj me ligj.

Një pjesë e konsiderueshme e aktiviteteve të tij veçohen për raportim para komisioneve të ndryshme të kuvendit për punën e AD-së, punëtoritë dhe konferencat e ndryshme në nivel rajonal dhe ndërkombëtarë, aktivitetet me Këshillin Programor në cilësinë e udhëheqësit të këtij organi dhe më qenësorja kujdesi për zbatimin e vendimeve të Këshillit Drejtues dhe aktivitete tjera për buxhetin dhe menaxhimin me mjetet financiare.

Në përputhje me kornizën ligjore të aplikueshme, zyra drejtorit në koordinim me Departamentin për Shërbime Ligjore dhe të përgjithshme ka organizuar dhe udhëhequr draftimin dhe plotësimin e akteve normative si: Rregulloren Nr. 01/2024 për Trajnimin Fillestar, Rregullore nr. 02/2024 për plotësimin -ndryshimin e rregullores nr. 01/2023 për trajnuesit dhe mentorët e AD-së si dhe Udhëzuesin për Organizimin e trajnimeve të vazhdueshme dhe të njëjtat i ka prezantuar Këshillit Drejtues për Miratim.

Në rrafshin ndërkombëtar ka pasur vizita dhe takime të ndërsjella me partnerët tjerë si përfaqësuesit e TAIEX dhe MPB-Departamenti për siguri publike, Ministrin e Drejtësisë së Maltës, Ambasadorin e Francës në Kosovë, Ambasadorin e BE-së si dhe angazhime tjera me Komitetet Drejtuese të projekteve që veprojnë në Kosovë si dhe partnerët zhvillimor të AD-së që si fushë veprim kanë përmirësimin e sundimit të ligjit.

Gjatë periudhës raportuese një numër i konsiderueshëm i takimeve me Drejtorin Ekzekutiv, janë zhvilluar që kanë rezultuar në avancimin e moduleve trajnuese dhe ofrimin e trajnimeve për gjyqtarë, prokurorë dhe profesionistët e tjerë ligjorë. Takime të vazhdueshme janë zhvilluar me përfaqësues të shumicës së Ambasadave në Kosovë, Zyrës së BE-së në Kosovë, Zyrës së Këshillit të Evropës në Kosovë, si dhe projekteve të shumta që vazhdojnë të mbështesin Akademinë e Drejtësisë në ofrimin e trajnimeve. Ndër takimet më të rëndësishme dhe të rregullta përgjatë gjithë vitit 2024, e që është me rëndësi të theksohet janë: takimet e rregullta me përfaqësuesit e zyrës së OPDAT dhe INL pranë Ambasadës së SHBA-së në Kosovë, me projektin e USAID-it sikurse Projekti për Drejtësi Komerciale, me Ambasadën Franceze dhe Shkollën e Magjistratëve të Francës, me Ambasadën Britanike, respektivisht me projektin Iniciativa për Sundimin e Ligjit në Vendet e Ballkanit Perëndimorë (WBROL), me përfaqësues të projektit të BE / EUKOJUST, me Rrjetin Evropian të Trajnimit Gjyqësor (EJTN), me Akademinë Evropiane të Drejtësisë (ERA) , me Akademinë e Drejtësisë së Turqisë, me projektet e KE PECK III, KOSEJ, dhe projektin “ Parandalimin e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave” ,me projektin “Programi Evropian për Arsimitin e Profesionistëve Ligjor për të drejtat e Njeriut (HELP)” si dhe projektet e tjera të mbështetura nga EULEX, INL-FMCS, OSBE, UNHCR, UNDP, UNODC, GIZ, IRZ, CLDP, dhe me odat e profesioneve të lira në Kosovë dhe organizatat e shoqërisë civile në Kosove. Në këto takime janë diskutuar nevojat dhe sfidat e AD-së në përmbushjen e mandatit ligjor, mundësitë e mbështetjes së projekteve, aktivitetet e realizuara dhe aktivitetet në proces si dhe çështje tjera të përbashkëta.

4.5 Menaxhmenti i mesëm

Bazuar në Rregulloren nr. 05/2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Akademinë e Drejtësisë kanë funksionuar Departamenti i Programit të Trajnimeve, Departamenti për Çështje ligjore dhe shërbime të përgjithshme si dhe njësisia e veçantë Divizioni për buxhet dhe financa. Përgjegjësitë kryesore të departamenteve janë si në vijim:

- Hartimi i programeve trajnuese, mbikëqyrja e zbatimit dhe vlerësimi i nevojave trajnuese;
- Koordinimi i hartimit të politikave, strategjive, objektivave dhe planeve për trajnime;
- Koordinimi i punës së departamenteve në funksion të zbatimit të trajnimeve si dhe
- Planifikimi dhe ekzekutimi i buxhetit konform plan programit të AD-së.

Departamenti i Programit të Trajnimeve përmban Divizionin e Trajnimeve Fillestare, Divizionin e Trajnimeve të vazhdueshme si dhe Divizionin për Analiza, Hulumtime, Botime dhe Trajnues të cilat udhëhiqen nga udhëheqësit përkatës ndërsa në krye të këtij departamenti për kundër zhvillimit të procedurës së rekrutimit për Drejtorin e këtij departamenti nuk është arritur plotësimi i kësaj pozite.

Departamenti për shërbime ligjore dhe të përgjithshme udhëhiqet nga Drejtori i këtij departamenti dhe në kuadër të këtij departamenti janë Divizioni për Shërbime Ligjore dhe Bashkëpunim Ndërinstitucional, Divizioni për Mbështetje Administrative dhe Logjistikë si dhe Divizioni i TI-së.

Divizioni për Buxhet dhe Financa është njësi e veçantë dhe udhëhiqet nga Udhëheqësi për Buxhet dhe Financa dhe përfshinë sektorë të cilët janë përgjegjës për çështjet financiare në funksion të realizimit të objektivave programore të Akademisë.

4.5.1 Mandati i Departamenteve

1. Departamenti i Programeve Trajnuese ka për mandat menaxhimin e programeve trajnuese dhe ofrimin e trajnimeve fillestare dhe trajnimeve të vazhdueshme për gjyqtarë dhe prokurorë të shtetit si dhe trajnimeve për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial, avokat shtetëror, avokat dhe profesione tjera të lira si dhe menaxhimin e aktiviteteve të Akademisë lidhur me analizat, hulumtimet dhe botimet.

Në kuadër të Departamentit të programeve trajnuese bëjnë pjese:

- Divizioni për trajnimin fillestar të gjyqtareve dhe prokurorëve të shtetit;
- Divizioni për trajnimet e vazhdueshme për gjyqtarë dhe prokurorë të shtetit;
- Divizioni për trajnimet e stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial, avokateve shtetëror, avokateve dhe profesioneve tjera të lira;
- Divizioni për analiza, hulumtime, botime dhe trajnues.

Ndërsa , detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit të Programeve Trajnuese janë:

- Hartimi dhe propozimi i politikave, objektivave dhe strategjive për trajnime për gjyqtarët, prokurorët, si dhe për profesionistët e tjerë në fushën e drejtësisë, përfshirë analizat, hulumtimet dhe botimet;
- Përgatitja, organizimi dhe zbatimi i trajnimeve fillestare dhe të vazhdueshme për gjyqtarët, prokurorët dhe stafin administrativ të sektorit gjyqësor dhe prokurorial, pas koordinimit me KGJK-në dhe KPK-në;
- Vlerësimi i nevojave për trajnime dhe mbështetja e Këshillit Programor në zhvillimin dhe përditësimin e programeve të trajnimit;
- Menaxhimi i procesit të përzgjedhjes dhe angazhimit të trajnuesve dhe mentorëve, si dhe mbikëqyrja e përbushjes së detyrave dhe përgjegjësi të tyre;
- Zhvillimi dhe përmirësimi i standardeve të metodologjisë së trajnimit për Akademinë e Drejtësisë;
- Përpunimi i planit vjetor të trajnimit dhe implementimi i kalendarit të aktiviteteve trajnuese, përfshirë aspektet financiare;

- Realizimi i analizave, hulumtimeve dhe botimeve për mbështetje të mandatit të Akademisë, përfshirë publikimin e dokumenteve të rëndësishme që pasqyrojnë punën e Akademisë;
- Mbështetja e organeve të Akademisë dhe njësisë organizative në përgatitjen e raporteve periodike dhe menaxhimi i të dhënave statistikore për aktivitetet trajnuese;
- Koordinimi dhe bashkëpunimi me njësitë e Akademisë dhe institucionet përkatëse të sektorit të drejtësisë për realizimin e aktiviteteve trajnuese;

2. Departamenti për shërbime ligjore dhe të përgjithshme ka për mandat menaxhimin e aktiviteteve të Akademisë lidhur me shërbimet ligjore, komunikimin, bashkëpunimin ndërinstitucional, shërbimet e teknologjisë së informacionit, kushtet fizike të punës, pajisjet e nevojshme, shërbimet mbështetëse dhe logjistike.

Ne kuadër të Departamentit për shërbime ligjore dhe të përgjithshme, bëjnë divizionet si ne vijim:

- Divizioni për shërbime ligjore dhe bashkëpunim ndërinstitucional
- Divizioni për teknologji informative dhe
- Divizioni për mbështetje administrative dhe Logjistike.

Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit për shërbime ligjore dhe të përgjithshme janë:

- Ofrimi i këshillave dhe ekspertizës për çështjet ligjore, duke përfshirë hartimin, analizimin dhe/ose komentimin e akteve ligjore dhe nënligjore.
- Menaxhimi i komunikimeve të brendshme dhe të jashtme të Akademisë, përfshirë faqen e internetit dhe llogaritë e mediave sociale.
- Menaxhimi i komunikimit ndërinstitucional, bashkëpunimit ndërkombëtar dhe koordinimi me donatorët.
- Ofrimi i shërbimeve të përkthimit për aktivitetet e Akademisë.
- Ofrimi i mbështetjes për TI-në për stafin e Akademisë dhe sigurimi i ofrimit të shërbimeve cilësore të pajisjeve për TI.
- Menaxhimi i sistemit të arkivit dhe dokumenteve të brendshme, hyrëse dhe dalëse të Akademisë.
- Ofrimi i shërbimeve dhe mbështetjes administrative dhe logjistike për Akademinë, përfshirë mirëmbajtjen dhe pastrimin e hapësirave të objekteve, menaxhimin dhe mirëmbajtjen e inventarit në depo, etj.
- Sigurimi i zbatimit të procedurave për menaxhimin e automjeteve që disponon Akademia në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe koordinimi me institucionet përkatëse për raportimin lidhur me gjendjen e automjeteve (servisimi, mirëmbajtja, shpenzimet e derivateve, etj.).
- Menaxhimi i pranimit, kontrollit të pasurisë, menaxhimit të stokeve dhe inventarit të Akademisë.
- Sigurimi i ofrimit të shërbimit të transportit dhe menaxhimi i automjeteve të Akademisë dhe atyre që janë në shfrytëzim të saj.

4.6 Burimet njerëzore

Të gjithë të punësuarit në Akademi të Drejtësisë janë shërbyes civil dhe i nënshtrohen ligjeve dhe rregullave për shërbimin civil në Kosovë. Në periudhën raportuese prioritet i AD-së ishte zbatimi dhe përmbyllja e procesit të kërkesave nga reforma e administratës publike, respektivisht zbatimi i Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, si dhe Rregullores nr.05/2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës.

Në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, Rregullores Nr. 14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, si dhe Rregullores nr.05/2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës në AD, është përfunduar procesi i ristrukturimit të secilit nëpunës civil të Akademisë së Drejtësisë dhe janë lëshuar aktet e reja të emërimit. Secili prej tyre varësisht nga pozitat që mbajnë janë përgjegjës për funksionimin më të mirë të AD-së në zbatim të mandatit të saj me ligj.

Kuadri i AD-së është i angazhuar me zbatimin e programeve trajnuese, në analiza hulumtime dhe veprimtari botuese në funksion ngritjes së kapaciteteve të gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistë tjerë ligjor si dhe me shërbime tjera të cilat mbështesin zbatimin e programeve dhe aktiviteteve tjera sipas Ligjit për AD-në.

Në fillim të vitit 2024, Akademia e Drejtësisë ka pasur të punësuar gjithsejtë 25 (njëzetepesë) zyrtarë. Të miratuara sipas Rregullores nr.05/2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës në AD, 36 (tridhjetegjashtë), ndërkaq të aprovuara me buxhetin për vitin 2024 kanë qenë gjithsejtë 32 (tridhjetedy) pozita.

Tashmë, aktualisht janë gjithsejtë 29 (njëzetënëntë) të punësuar. Sa i përket ngritjes së kapaciteteve profesionale prioritet ishin trajnimet bazuar në legjislacionin e administratës publike, me theks të veçantë për stafin e rekrutuar të cilët nuk kanë qenë më herët pjesë e Shërbimit Civil.

4.6.1 Numri i punëtorëve

Në fillim të vitit 2024, Akademia e Drejtësisë ka pasur të punësuar gjithsejtë 25 (njëzetepesë) zyrtarë. Sipas Rregullores nr.05/2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës në AD, numri i përgjithshëm i pozitave të miratuara ka qenë 36 (tridhjetegjashtë), ndërkaq të aprovuara sipas Ligjit për buxhetin për vitin 2024 kanë qenë gjithsejtë 32 (tridhjetedy) pozita. Nga ky numër në vitin 2024, AD ka pasur 7 pozita pune vakante. Në fillim të vitit është hartuar plani i personelit duke paraparë zhvillimin e të gjitha procedurave në përputhje me legjislacionin përkatës.

Kategoria funksionale	Nr. i stafit sipas Ligjit për Buxhetin 2024	Nr. i stafit sipas Rregullores nr.05/2023	Nr. i stafit në fillim të 2024	Nr. i stafit në fund të 2024
Kategoria e lartë drejtuese	1	1	1	1
Kategoria e mesme drejtuese	2	2	1	1
Kategoria e ulët drejtuese	6	8	5	6
Kategoria profesionale	22	25	17	20
Nëpunës teknik dhe mbështetës	1	/	1	1
Total	32	36	25	29

Tabelë nr.1: Numri i punëtorëve sipas kategorisë funksionale

4.6.2 Nevojat për punëtorë të rinj

Me qëllim të zbatimit të mandatit ligjor të AD dhe zbatimit të legjislacionit në fuqi, AD ka hartuar planifikimin e rekrutimit edhe për 3 pozitat e lira në AD për vitin 2025 ndërsa, sfiduese do të jetë buxheti i pamjaftueshëm, respektivisht sigurimi i buxhetit për 4 pozita të reja të miratuara me Rregulloren nr.05/2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës në AD.

Për tri pozitat e lira në AD që do të zhvillohen procedurat e rekrutimit janë si në vijim:

- Drejtor i departamentit të programeve trajnuese

- Zyrtar i lartë certifikues
- Zyrtar i lartë për TI sisteme

Pozita e reja të miratuara me Rregulloren nr.05/2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës në AD që pritet aprovim i buxhetit janë si në vijim:

- Udhëheqës i divizionit për trajnimet e stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial, avokatëve shtetëror, avokatëve dhe profesioneve tjera të lira
- Udhëheqës i divizionit për mbështetje administrative dhe logjistikë
- Zyrtar i lartë për trajnime
- Zyrtar i pasurisë

4.6.3 Paraqitja në formë tabelare e numrit dhe llojit të trajnimeve të stafit

Programet e trajnimit në përgjithësi synojnë të rrisin aftësinë profesionale të zyrtarëve për zhvillimin, ngritjen dhe ruajtjen e kompetencës së institucionit me personel të kualifikuar, profesional dhe të përgjegjshëm, me kulturë pune dhe bashkëpunimi. Andaj, Akademia e Drejtësisë edhe në periudhën raportuese ka vazhduar bashkëpunimin me institucione vendore dhe ndërkombëtare dhe varësisht nga programi i ofruar ka përcaktuar stafin përfitues të cilët kanë marrë pjesë në trajnime.

Trajnimi	Organizatorë/Donatorë	Nr. i stafit përfitues
Trajnimi hyrës për nëpunësit e ri civil në Shërbimin Civil të Kosovës	IKAP	2
Vlerësimi i rezultateve në punë	IKAP	1
Trajnim lidhur me përgatitjen për procesin e deklarimit të pasurisë për vitin 2024	APK	1
Trajnim për Sistemin SMAED	MPB	1
Hartimi i specifikacioneve teknike dhe funksionale	KRPP	2
Punëtori mbi Teknikat e Vlerësimit përmes metodologjisë Kirkpatrick	OPDAT	4
Si të jesh kandidati më i mirë në procesin e rekrutimit me bazë në meritë	Ambasada Britanike-Rrjeti për Fuqizimin e Grave në Pozita Vendimmarrëse në Sektorin Publik	1
Kujdesi ndaj të miturve të pashoqëruar që kryejnë vepra penale brenda një rrjeti kriminal të organizuar	Programi i Drejtësisë i BE-së	1
Hartimi i Raportit Afatmesëm për zbatimin e Planit të veprimit 2022-2024 të Strategjisë për avancimin e të drejtave të komuniteteve romë dhe ashkali në Republikën e Kosovës 2022-2026	Këshilli i Evropës dhe BE	1
Luftimi i krimeve të rënda dhe të organizuara, korrupsionit të nivelit të lartë dhe veprat komplekse	WBROLI/Chemonics	2
Punëtori rajonale mbi strategjinë dhe praktikat e trajnimit gjyqësor për krimin kibernetik dhe provat elektronike	Këshilli i Evropës/ CyberSEE	2

Tabelë nr.2: Trajnimet e stafit

4.7 Asetet në posedim të Akademisë së Drejtësisë

Në kuadër të regjistrimit të aseteve përfshihen pasuritë mbi 1,000 euro dhe pasuritë nën 1,000 euro. Në kuadër të regjistrimit të pasurive mbi 1,000 euro janë të regjistruara automjetet, fotokopjet, pajisjet e teknologjisë informative dhe pajisjet e zërimit në vlerën neto prej 58,085.63 euro.

Ndërsa, pasuritë nën vlerën 1,000 euro bëjnë me pasuritë që kanë jetëgjatësi më shumë se një vit dhe përfshijnë kryesisht pajisje të teknologjisë informative, mobilie dhe inventar të ndryshëm, librat e bibliotekës dhe për vitin 2024 ishin 72, 151.69

Pasuritë jo financiare kapitale të AD, janë të gjitha pasuritë kapitale të regjistruara në SIMFK. Në vlerën totale të pajisjeve veturave dhe të tjera përfshihet vlera neto.

Pasurit jo financiare jo kapitale të AD janë të gjitha pasuritë jo kapitale të regjistruara në E-pasuri. Në vlerën totale të pajisjeve përfshihet vlera e pajisjeve që disponon AD me 31 dhjetor 2024.

4.7.1 Planet për asete të reja

Akademia e Drejtësisë është e vendosur në një objekt privat me qera, me adresën: rr. Murat Mehmeti, nr. 1-3, Prishtinë, që nga 08.07.2022, për shkak se ndërtimi i ndërtesës së re të Akademisë, e cila menaxhohet nga Departamenti për Standarde dhe Politika të Inxhinieringut dhe Menaxhimit të Ndërtesave Qeveritare në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ende nuk ka përfunduar.

Nga takimet e zhvilluara me përfaqësuesit e DSPIMNQ në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme është konfirmuar që Operatori Ekonomik nga muaji tetor 2024 ka vazhduar punimet në objekt, sipas planit dinamik të punës. Disa punime janë përfunduar, ndërsa punimet tjera janë ende në proces.

Aktualisht hapësirat e ndërtesës ku ndodhet Akademia e Drejtësisë kanë një sipërfaqe prej rreth 2,000 m². Në bazë të kërkesave të vazhdueshme për plotësimin e personelit, zbatimin e programeve trajnuese, dhe nevojave të tjera, si trajnime të specializuara, trajnimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve fillestarë, trajnimi i profesionistëve të tjerë të përcaktuar me ligj, veprimtaria e njësisë për hulumtime dhe bibliotekës, si dhe organizimi i konferencave dhe aktiviteteve të tjera, hapësira ekzistuese nuk i plotëson kushtet e nevojshme fizike për funksionimin e saj.

Qysh në fazat e hershme të ndërtimit të ndërtesës së Akademisë së Drejtësisë, është kërkuar nga DSPIMNQ në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme që të përfshihen komentet e Projektit EUKOJUST, të cilat ishin miratuar edhe nga Këshilli Drejtues, për të mundësuar funksionalizimin e ndërtesës në përputhje me nevojat e Akademisë. Gjatë takimeve të fundit mes përfaqësuesve të Akademisë së Drejtësisë dhe DSPIMNQ të Ministrisë së Punëve të Brendshme, u konfirmua se këto komente nuk janë përfshirë në kontratën e lidhur më 16.08.2024, ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Operatorit Ekonomik për ndërtimin e ndërtesës së re të Akademisë.

5. AKTIVITETET E AKADEMISË SË DREJTËSISË PËR VITIN 2024

Bazuar në Planin e punës dhe të performancës për vitin 2024, aktivitetet e AD këtë vit janë fokusuar në arritjen e objektivave si në vijim:

1. Përgatitjen profesionale e gjyqtarëve të sapo emëruar dhe prokurorëve të sapo emëruar

2. Avancimin e vazhdueshëm të njohurive profesionale dhe interdisiplinare të gjyqtarëve, prokurorëve, stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial si dhe profesionistëve të tjerë ligjor-PTV;
3. Zhvillimin e programeve trajnuese, përmes analizave, hulumtime si dhe veprimtarisë botuese;
4. Avancimin edhe më tej të metodologjisë trajnuese;
5. Avancimin dhe zgjerimin e bashkëpunimit dhe koordinimit me partnerët vendor, partnerët ndërkombëtarë, donatorët dhe institucionet relevante trajnuese ndërkombëtare;
6. Transparencën dhe marrëdhënien me publikun si dhe
7. Ngritjen e cilësisë së shërbimeve të departamentit për administratë dhe financa

5.1 Krahasimi punës së AD-së për tri vitet e fundit

Akademia e Drejtësisë ka qenë e përkushtuar për të përcjellë zhvillimet në sistemin gjyqësor dhe prokurorial veçanërisht proceset e rekrutimit të një pas njëshme të KGJK-së dhe KPK-së për pozitat e gjyqtarëve, prokurorëve si dhe bashkëpunëtorëve profesional. Një dinamikë krejtësisht më e shtuar në raport me vitet paraprake, dhe në hap me këto zhvillime ka ndërmarrë masat për hartimin e programeve trajnuese dhe zbatimin e tyre në kohën optimale.

Vetëm në trajnimet fillestare këtë vit kanë vijuar 3 gjenerata të gjyqtarëve të sapo emëruar (X, XI, dhe XII) me 74 gjyqtarë të rinj dhe një e prokurorëve të sapo emëruar, gjenerata e X me 23 prokurorë. Të dy grupet (i gjyqtarëve dhe i prokurorëve) nga gjenerata e X kanë përfunduar trajnimin fillestar në muajin maj 2024 dhe për të dy këto profile është realizuar testi përfundimtar dhe janë përgatitur raportet me vlerësimet përfundimtare për KGJK dhe KPK. Grupet tjera të gjyqtarëve janë në proces të vijimit të trajnimit komfor programit dhe kalendarit trajnues.

Në kuadrin e trajnimeve të vazhdueshme janë realizuar 174 trajnime për gjyqtarë, prokurorë, bashkëpunëtorë profesional, stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial si dhe për profesionistë tjerë ligjor. Këto trajnime kanë përfshirë çështjet ligjore që janë identifikuar si nevojë trajnuese dhe sfiduese për praktikën gjyqësore me të vetmin qëllim që të ofrohen zgjidhjet më të mira ligjore dhe të promovohen praktikat më të mira. Karakteristikë e veçantë është edhe vlerësimi i performancës së 79 trajnuesve të angazhuar gjatë këtij viti nga Këshilli Programor dhe Këshilli Drejtues i AD-së. Përveç me aspektin e trajnimeve, AD ka mbështetur Gjykatën Supreme me dy botime që janë përmbledhje e praktikës gjyqësore që për detaje janë në vazhdim të këtij raporti te pjesa e veprimtarisë botuese.

Zhvillimet e Akademisë në raport me vitet paraprake janë të prezantuara më poshtë në formë tabelare.

Krahasimi i punës së AD-së për tri vitet e fundit			
Aktivitetet	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024
Trajnime fillestare	Për 48 gjyqtarët e sapo emëruar, gjen. IX janë realizuar 204 aktivitete trajnuese Ndërsa për 6 prokurorët e sapo emëruar, gjen. IX 113 aktivitete	Vazhdimi dhe përfundimi i trajnimit fillestar për gjeneratën e IX të gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapo emëruar Fillimi dhe zbatimi i trajnimit fillestar për gjeneratën e X (29 gjyqtarë dhe 21 prokurorë)	Vazhdimi dhe përfundimi i trajnimit fillestar për gjeneratën e X të gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapo emëruar Fillimi dhe zbatimi i trajnimit fillestar për gjeneratën e XI dhe XII të gjyqtarëve të sapoemëruar
Tranime të vazhdueshme	143	140	174

Trajnime për stafin administrative gjyqësor dhe prokurorial	23 trajnime për bashkëpunëtorë profesional 10 trajnime për stafin tjetër me 13 ditë trajnimi	55 trajnime për bashkëpunëtorë profesional me 63 ditë trajnimi dhe 6 trajnime për stafin tjetër administrativ gjyqësor dhe prokurorial me 7 ditë trajnimi	60 trajnime për Bashkëpunëtor profesional dhe Zyrtar Ligjor (53 trajnime nga Moduli Bazik dhe 7 trajnime tjera për Bashkëpunëtor Profesional/Zyrtar Ligjor) si dhe; 15 trajnime për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial.
Trajnime për profesionet e lira	10 trajnime (5 për zyrtarët e ndihmës juridike falas, 3 për mbrojtësit e viktimave dhe 2 për përmbauesit privat	4 trajnime për ndërmjetësues	14 trajnime (12 për ndërmjetësues dhe 2 për avokatë)
Aktivite tjera ¹	324	Mbi 300	Mbi 245
Pjesëmarrja gjyqtarë/prokurorë në trajnime të vazhdueshme	2005 gjyqtarë dhe 626 prokurorë	1479 gjyqtarë 479 prokurorë	962 nga radhët e gjyqtarëve, 274 nga radhët e prokurorëve,
Numri i gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapo emëruar	48 gjyqtarë 6 prokurorë	45 gjyqtarë, gjen.IX 29 gjyqtarë, gjen.X 5 prokurorë, gjen IX 21 prokurorë, gjen.X	- Gjenerata X e gjyqtarëve të sapo emëruar (28), Gjenerata X e prokurorëve të sapo emëruar (23), - Gjenerata XI e gjyqtarëve të sapo emëruar (15), - Gjeneratat XII e gjyqtarëve të sapo emëruar (31)
Numri i pjesëmarrësve nga stafi administrativ gjyqësor dhe prokurorial	2984 pjesëmarrës që janë përfshirë qoftë në trajnime të përbashkëta me gjyqtarë dhe prokurorë ashtu edhe në trajnimet dedikuar veq profileve përkatëse	1517 pjesëmarrës qoftë në trajnime të përbashkëta me gjyqtarë dhe prokurorë ashtu edhe në trajnimet dedikuar veq profileve përkatëse	789 pjesëmarrës nga radhët e bashkëpunëtorëve profesional, 627 nga radhët e zyrtarëve ligjor dhe 273 nga stafi tjetër administrativ gjyqësor dhe prokurorial
Numri i personelit të AD-së	25	25	29

Tabela nr.3: Krahasimi i punës së Akademisë në tri vitet e fundi

5.2 Plani i punës dhe performances për vitin 2024

Në dhjetor 2023, Këshilli Drejtues i AD ka miratuar Planin e punës dhe performances për vitin 2024, duke konsideruar nevojat reale dhe fokusuar në prioritet dhe objektivat e arritshme. Andaj, Plani i punës dhe i performances ishte i fokusuar ne 7 (shtate) objektiva kryesore dhe 31 (tridhjetenjë) nën objektiva sikurse te listuara me poshtë:

- Përgatitja profesionale e gjyqtarëve të sapo emëruar dhe prokurorëve të sapo emëruar
- Avancimi i vazhdueshëm të njohurive profesionale dhe interdisiplinare të gjyqtarëve, prokurorëve, stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial si dhe profesionistëve të tjerë ligjor-PTV;
- Zhvillimi i programeve trajnuese, përmes analizave, hulumtime si dhe veprimtarisë botuese;
- Avancimi edhe më tej i metodologjisë trajnuese
- Avancimi dhe zgjerimi i bashkëpunimit dhe koordinimit me partnerët vendor, partnerët ndërkombëtarë, donatorët dhe institucionet relevante trajnuese ndërkombëtare.
- Transparenca dhe marrëdhënia me publikun
- Ngritja e cilësisë së shërbimeve të departamentit për administratë dhe financa

¹ Aktivitete që nënkupton takimet e punës me KD, KP, trajnues, krerë të gjykatave dhe prokurorëve, të KGJK-së dhe KPK-së, vizita të ndërsjella në kuadër të bashkëpunimit institucional vendor dhe ndërkombëtarë, punëtori të ndryshme, takime koordinuese me partnerë ndërkombëtarë etj.

5.2.1 Përgatitja profesionale e gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapo emëruar

Në bazë të koordinimit dhe bashkëpunimit me KGJK dhe KPK, AD kishte planifikuar zbatimin e trajnimeve për gjyqtaret dhe prokurorët e sapoemëruar si në vijim:

1. Zbatimin e trajnimit fillestar për 29 gjyqtarët e sapo emëruar të gjeneratës së X në trajnimin praktik në gjykata nën mbikëqyrjen e mentorit gjyqtarë.
2. Zbatimin e trajnimit fillestar për 21 prokurorët e sapo emëruar të gjeneratës së X trajnimi teorik në Akademi të Drejtësisë dhe trajnimin praktik në prokuroritë përkatëse nën mbikëqyrjen e mentorit prokurorë.
3. Zbatimin i trajnimit fillestar për 15 gjyqtarët e sapo emëruar të gjeneratës e XI në trajnimin teorik dhe praktik.
4. Zbatimin i trajnimit fillestar për 8 gjyqtarët nga komuniteti serbë të sapo emëruar të gjeneratës e XII në trajnimin teorik dhe praktik.
5. Zbatimin e trajnimit fillestar për 30 prokurorët e sapo emëruar të gjeneratës së XI trajnimi teorik në Akademi të Drejtësisë dhe trajnimin praktik në prokuroritë përkatëse nën mbikëqyrjen e mentorit prokurorë
6. Zbatimin e trajnimit fillestar për 30 gjyqtarët e sapo emëruar të gjeneratës së XIII në trajnimin teorik dhe praktik.
7. Zhvillimi i trajnimeve të detyrueshme sipas vlerësimit të Performancës

5.2.2 Avancimi i vazhdueshëm i njohurive profesionale dhe interdisiplinare të gjyqtarëve, prokurorëve, stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial si dhe profesionistëve të tjerë ligjor

Plani i punës dhe i Performancës për vitin 2024 në kuadrin e trajnimeve të vazhdueshme ka përfshirë aktivitetet trajnuese që kanë dale si rezultat i kërkesave nga të gjitha dokumentet strategjike, prioritetet e KGJK-së dhe KPK-së dhe nga vlerësimi i nevojave trajnuese që janë identifikuar nga takimet e përbashkëta me gjyqtarë dhe prokurorë, kryetar të gjykatave dhe kryeprokuror të prokurorive. Të gjithë këta mekanizma kanë konfirmuar trajnimet për luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit, sekuestrimit dhe konfiskimit, formave tjera të keqpërdorimit të detyrës zyrtare, dhunës në familje, aspektin e të drejtave të njeriut si dhe çështjet tjera që janë sfiduese të praktikës gjyqësore.

Andaj, duke ju referuar programit të trajnimit të vazhdueshëm të miratuar në nëntor 2023 nga Këshilli Drejtues i AD, janë përfshirë gjithsejtë 117 aktivitete trajnuese me mundësi për pjesëmarrje më shumë se 1500 përfitues të trajnimeve të AD-së.

Konform Programit për trajnim të vazhdueshëm për vitin 2024, kanë qenë të planifikuara aktivitete trajnuese në fushat si në vijim:

1. Trajnimet nga lëmia Penale;
2. Trajnime nga Programet e Specializuara në fushën Penale;
3. Trajnimet nga lëmia Civile;
4. Trajnimet nga lëmia Komerciale;
5. Trajnimet nga drejtësia kushtetuese, administrative, kundërvajtëse dhe Dhoma e posaçme e Gjykatës Supreme;
6. Trajnimet për KEDNJ;
7. Trajnimet nga e Drejta e BE- së dhe e drejta ndërkombëtar;
8. Trajnimet nga kompetenca interdisciplinare;
9. Zbatimi i trajnimeve të obligueshme sipas kërkesave nga KGJK dhe KPK;

10. Zbatimi i trajnimeve për bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarët ligjor të gjykatave dhe prokurorive;
11. Trajnimet për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial;
12. Trajnimet nga lëmia e drejtësisë për fëmijë.

5.2.3 Zhvillimi i programeve trajnuese përmes analizave, hulumtimeve dhe veprimtarisë botuese

Analizat dhe hulumtimet kanë ndikim thelbësorë në zhvillimin e programeve trajnuese adekuate me nevojat trajnuese dhe krijimin e botimeve të reja në fushën juridike me theks te modulet trajnuese, doracakët, udhëzuesit dhe format tjera që lehtësojnë punën praktike të gjyqtarëve dhe prokurorëve si përfitues kryesor sipas Ligjit për Akademinë e Drejtësisë. Në këtë vështrim sipas planit të punës dhe të performancës aktivitetet e Divizionit për Analiza, Hulumtime, Botime dhe trajnues kanë qenë të orientuara si në vijim:

- Zbatimi i procesit për vlerësim të nevojave trajnuese për vitin 2025;
- Identifikimi i praktikës gjyqësore të drejtë dhe vënia në dispozicion për profesionistët ligjor;
- Zbatimi veprimtarisë botuese si dhe ofrimi i burimeve ligjore për përfituesit AD-së;
- Planifikimi institucional në zbatim të masave dhe politikave euro integruese.

5.2.4 Avancimi edhe më tej i metodologjisë trajnuese

Akademia e Drejtësisë, me qëllim të avancimit edhe më tej të metodologjisë trajnuese ka hartuar Doracakun e ri për trajnues i cili përfshinë rregulla bazë të sjelljes së trajnuesve si mjet për të siguruar standardet më të larta gjatë trajnimit të gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve tjerë ligjor. Ky doracak me metodologjinë më të avancuar të mësimdhënies në fushën e mësimin për të rritur do të zbatohet në praktikë nga trajnuesit dhe stafi i AD-së. Ky program do të zbatohet paraprakisht për gjitha trajnimet për trajnues që do të mbahen gjatë vitit 2024 përmes të cilit trajnuesit më pastaj do të aplikojnë projektimin, zhvillimin, realizimin dhe vlerësimin e trajnimit.

1. Zbatimi i Doracakut të ri për trajnues;
2. Zbatimi i Trajnimeve për Trajnues (TiT).

5.2.5 Avancimi dhe zgjerimi i bashkëpunimit dhe koordinimit me partnerët vendor, partnerët ndërkombëtarë, donatorët dhe institucionet relevante trajnuese ndërkombëtare.

Rritja e bashkëpunimit dhe koordinimi me donatore , partner vendore dhe ndërkombëtarë duke përfshi edhe institucionet dhe organizatat ndërkombëtare, është një qëllim vazhdueshme dhe pjese e qasjes se AD ne procesin euro integrues dhe ngritjen a kapaciteteve profesionale te aktereve te sistemit gjyqësore dhe prokurorial. Pjesa me e madhe e aktiviteve trajnuese ne programin e trajnimit te vazhdueshëm dhe programeve te shkëmbimit janë realizuar ne mbështetje dhe me financim te donatoreve dhe projekteve te ndryshme ndërkombëtare.

5.2.6 Ngritja e transparencës dhe marrëdhënia me publikun

Edhe për gjatë vitit 2024, Akademia e Drejtësisë kishte planifikuar që me aktivitete të saja të vazhdojë të rrit transparencën dhe marrëdhënien me publikun përmes publikimit të gjitha proceseve të punës dhe aktiviteve të saj. Web-faqja e AD-së dhe platformat e rrjeteve sociale do të përditësohet me zhvillimet e reja qoftë për

punën e organeve të saj drejtuese ashtu edhe aktivitetet trajnuese përmes njoftimeve publike, shpalljeve dhe formave tjera.

5.2.7 Ngritja e cilësisë së shërbimeve administrative dhe shpenzimeve financiare të buxhetit

Shërbimet e përgjithshme dhe financat sipas kompetencës ligjore mbështesin realizimin e të gjitha aktiviteteve të planifikuara në fushën e trajnimeve në kuadër të veprimtarisë hulumtuese dhe botuese dhe aktivitet tjera mbështetëse. Planifikimi i AD kane vazhduar te kenë prioritet fuqizimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore, plotësimi i pozitave të lira sipas rregullores për organizimin e brendshëm të AD-së dhe kapaciteteve buxhetore, përmirësimi i infrastrukturës së teknologjisë informative, furnizimet dhe mirëmbajtja e objektit, zhvillimi i planit të prokurimit në bazë të nevojave të AD-së dhe planifikimin e buxhetit për vitet në vijim. Aktivitet e AD te planifikuara për vitin 2024 janë realizuar nen objektivat si në vijim:

1. Riorganizimi brendshëm dhe sistematizim i vendeve te punës
2. Planifikimin dhe ekzekutimin e buxhetit;
3. Planifikimin e prokurimit;
4. Avancimi, përmirësimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës së teknologjisë informative për realizimin e funksioneve të Akademisë së Drejtësisë;
5. Ofrimin e shërbimeve të përgjithshme për funksionimin më të mirë të AD- së dhe aktiviteteve të planifikuara për vitin 2024.

5.3 Aktivitetet e Akademisë së Drejtësisë në përmirësimin e veprimtarisë së saj të përcaktuar me ligj

Akademia e Drejtësisë në periudhën raportuese ka qenë e angazhuar për të përcjellë zhvillimet në gjyqësor dhe risitë në legjislacion dhe konform kërkesave të KGJK-së dhe KPK-së ka hartuar programe trajnuese qoftë fillestare dhe të vazhdueshme dhe i ka zbatuar ato në kohën optimale.

Për të përmirësuar cilësinë e trajnimeve është angazhuar në zbatimin e metodologjisë trajnuese sipas Doracakut për trajnues dhe për këtë ka bërë edhe vlerësimin e performancës së trajnuesve.

Është kujdesur për zbatimin e masave dhe kërkesave që dalin nga dokumentet strategjike të vendit dhe mekanizmat tjerë integruar dhe në anëtarësimin në Institucionet e trajnimit gjyqësor në nivel rajonal.

Ka përmirësuar aktet nënligjore për trajnimet fillestare në përputhje me nevojat e Programit të Trajnimit Fillestar për gjyqtarët dhe prokurorët e sapo emëruar.

Është kujdesur për plotësimin e përbërjes së anëtarëve të Këshillit Programor pasi një nga anëtarët e këtij organi ishte dorëhequr, për plotësimin e pozitave të lira dhe konform kornizës ligjore për zyrtarët publik si dhe ka zhvilluar procedurat e rekrutimit.

6. PËRMBUSHJA E PLANIT TË PUNËS DHE TË PERFORMANCËS SI DHE PROGRAMEVE TRAJNUESE, REKOMANDIMET DHE SFIDAT

Plani i Punës dhe i Performancës për vitin 2024 është përmbushur në tërësi për këtë vit për të gjitha objektivat respektivisht nën objektivat .

Programet trajnuese për vitin 2024 kanë ofruar trajnimet për të gjitha kompetencat e punës së gjyqtarëve dhe prokurorëve fillestar si dhe atyre në shërbim për të cilat është vlerësuar se nuk ka praktikë gjyqësore unike ose janë identifikuar si sfiduese të praktikës gjyqësore.

Trajnimi fillestar është zbatuar konform programit për gjeneratën X të gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapo emëruar të cilët në fillim vitin 2024 kanë përfunduar programin duke përfshirë edhe testimin përfundimtarë. Për gjeneratën e XI është zbatuar trajnimi teorik dhe është vazhduar me zbatimin e trajnimit praktik i cili pritet të përfundoj në maj të vitit 2025 si dhe trajnimi teorik për gjeneratën e XII. Programi ka përfshirë kompetencën profesionale dhe interdisiplinare.

Trajnimet e vazhdueshme konform Programit Trajnues për vitin 2024 të miratuar nga Këshilli Drejtues është realizuar dhe i është dedikuar gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë, bashkëpunëtorëve profesional dhe zyrtarëve ligjor të gjykatave dhe prokurorëve, veçanërisht pozitave të reja në sistem, stafit administrativ të gjykatave dhe prokurorëve si dhe profesionistëve tjerë ligjor.

Analizat dhe hulumtimet kanë pasur impakt në zhvillimin e programeve trajnuese adekuate me nevojat trajnuese me ç'rast është realizuar vlerësimi i nevojave trajnuese duke përfshirë gjithë akteret e sistemit gjyqësor dhe prokurorial përmes mekanizmave të ndryshëm dhe realizimit të punëtorëve të përbashkëta. Janë realizuar edhe dy botime me Gjykatën Supreme dhe është filluar dhe në proces për vitin 2025 edhe zhvillimi i Udhëzuesi për provat elektronike

Pjese e rëndësishme e planit të punës dhe të performancës ishte edhe ngritja e cilësisë së metodologjisë trajnuese dhe fuqizimi edhe më tej i zbatimit të Doracakut për trajnues i cili është realizuar përmes zbatimit të trajnimit të trajnuesve si dhe vlerësimit të performancës së trajnuesve të angazhuar gjatë këtij viti.

Programi i certifikimit të trajnuesve ka vazhduar edhe këtë vit duke siguruar që të gjithë trajnuesit e AD-së janë të njohur me metodologjinë e mësimin për të rritur.

Me qëllim të ngritjes dhe informim të publikut, AD ka vazhduar në përditësimin dhe publikimin e njoftimeve, ngjarjeve dhe aktiviteteve të realizuara në web-faqen dhe platformave sociale të përdorura nga AD.

Gjithashtu ,në përmbushje të kërkesave të dala nga reforma e administratës publike, gjatë vitit 2024 në pajtim me Ligjin Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, Rregullores Nr. 14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, si dhe Rregullores nr.05/2023 për Organizimin e Brendshëm është përfunduar procesi i ristrukturimit për të gjithë të punësuarit në AD , janë zhvilluar akt-emërimet e reja dhe përshkrimi i detyrave të punës në AD konform katalogut për pozita në administratën publike. Ndërsa në realizim të funksionalizimit të strukturës së brendshme organizative të AD , respektivisht plotësimin e pozitave të lira janë zhvilluar gjithsej katërmëdhjetë procedura të rekrutimit, ku 9 (nëntë) procedura kanë përfunduar me sukses dhe 5 (pesë) procedura kanë rezultuar pa kandidat fitues.

6.1 ARRITJET NË ZBATIMIN E PLANIT TË PUNËS DHE TË PERFORMANCËS SI DHE PROGRAMEVE TË TRAJNIMEVE GJATË VITIT 2024

Akademia e Drejtësisë ka qenë e përkushtuar për të përcjellë zhvillimet në sistemin gjyqësor dhe prokurorial veçanërisht proceset e rekrutimit të një pas njëshme të KGJK-së dhe KPK-së për pozitat e gjyqtarëve, prokurorëve si dhe bashkëpunëtorëve profesional. Një dinamikë krejtësisht më e shtuar në raport me vitet paraprake, dhe në hap me këto zhvillime të ndërmerre masat për hartimin e programeve trajnuese dhe zbatimin e tyre në kohën optimale.

Vetëm në trajnimet fillestare kanë vijuar 3 gjenerata të gjyqtarëve të sapo emëruar (X, XI, dhe XII) me 74 gjyqtarë të rinj dhe një e prokurorëve të sapo emëruar, gjenerata e X me 23 prokurorë. Të dy grupet (i gjyqtarëve dhe i prokurorëve) nga gjenerata e X kanë përfunduar trajnimin fillestar në muajin maj 2024 dhe për të dy këto profile është realizuar testi përfundimtar dhe janë përgatitur raportet me vlerësimet përfundimtare për KGJK dhe KPK. Grupet tjera të gjyqtarëve janë në proces të vijimit të trajnimit komfor programit dhe kalendarit trajnues.

Në kuadrin e trajnimeve të vazhdueshme janë realizuar 174 trajnime për gjyqtarë, prokurorë, bashkëpunëtorë profesional, stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial si dhe për profesionistë tjerë ligjor. Këto trajnime kanë përfshirë çështjet ligjore që janë identifikuar si nevojë trajnuese dhe sfiduese për praktikën gjyqësore me të vetmin qëllim që të ofrohen zgjidhjet më të mira ligjore dhe të promovohen praktikat më të mira.

Karakteristikë e veçantë është edhe vlerësimi i performancës së 79 trajnuesve të angazhuar gjatë këtij viti nga Këshilli Programor dhe Këshilli Drejtues i AD-së.

Përveç me aspektin e trajnimeve, AD ka mbështetur Gjykatën Supreme me dy botime që janë përmbledhje e praktikës gjyqësore që për detaje janë në vazhdim të këtij raporti te pjesa e veprimtarisë botuese.

Detajet sa i përket aktiviteteve trajnuese gjenden në tabelën si në vijim:

Trajnimet fillestare	Të trajnuar	Gjinia		Sesionet e trajnimit		Ditë trajnimi	Nr. i orëve	Sesione trajnuese	Trajnuesit	Mentorët
		M	F	teorik	praktik					
Gjyqtarë/prokurorë të sapo emëruar										
Gjyqtarët-gjen X	28	16	12	/	99	99	/	/	/	28
Prokurorët-gjen X	23 ²	14	9	26	66	112	156	52	15	22
Gjyqtarët-gjen XI	15	9	6	117	96	213	702	234	36	29
Gjyqtarët-gjen XII	31	17	14	79	/	79	474	158	26	/
Totali	98	57	41	222	261	734	1332	444	77	80
Gjyqtarët porot fillestar	15	12	3	/	/	2	/	/	3	3
TIT	98			/	/	11	/	/		/
Trajnimet e vazhdueshme	Nr. i trajnimeve	Nr. i trajnimeve në ditë		Nr. i pjesëmarrësve		Të realizuara nga AD	Të mbështetura nga donatorët	Trajnues të angazhuar		
Trajnime për gjyqtar dhe prokuror	84	125		gjyqtarë	962	11	73	63	41	
				prokuror	274					
				Profes. tjerë ligjor	478 ³					
Trajnime për Bashkëpunorë profesional, zyrtarë ligjor dhe profesionistë tjerë	60	67		Bashkp. prof. dhe Zyrtare ligjor	789	34	26	15	6	
					627					
				Zyrtarë të ANJF	73					

² Grupit prej 21 prokurorëve sa ishin në këtë gjeneratë nga muaji dhjetor 2023 i janë bashkuar dy prokurore nga gjenerata e IX të cilat për shkak të pushimit të lehonisë nuk kanë përfunduar sesionet e trajnimit me gjeneratën përkatëse.

³ Në trajnime bashkë me gjyqtarë dhe prokurorë kanë marrë pjesë edhe bashkëpunëtorë profesional, zyrtarë ligjor, staf administrative gjyqësor dhe prokurorial, zyrtarë të ndihmës juridike falas, zyrtarë nga shërbimi sprovues, mbrojtës të viktimave, avokat shtetëror, ndërmjetësues zyrtarë policor dhe profesionistë tjerë nga komuniteti ligjor.

			Tjerë ⁴	35				
Stafi administ. gjyqësor/prokurorial	15	17	273		11	4	6	/
Menaxhim i prokurorisë	1	1	20		/	1	/	1
Profesione të lira - ndermjetesues & avokatë	14	26	327		/	14	12	2
Totali	174	236	3858		56	118	96	50
Trajnime në EJTJ dhe ERA	6	12	8		/	/	/	/

Tabela nr.4: Aktivitetet e realizuara gjatë vitit 2024

6.2 PËRGATITJA PROFESIONALE E GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE TË SAPO EMËRUAR TË GJENERATËS SË X SI DHE HARTIMI DHE ZBATIMI I PROGRAMEVE PËR GJYQTARËT E GJENERATËS SË XI DHE XII

Trajnimi fillestar për gjyqtarët dhe prokurorët e sapo emëruar është mandat që buron nga Ligji për Akademinë e Drejtësisë dhe legjislacioni në fuqi për sistemin gjyqësor dhe prokurorial. Ky trajnim fillon së zbatuari në Akademi të Drejtësisë menjëherë pas dekretimit në funksionin e gjyqtarit/prokurorit dhe zgjatë 12 muaj duke përfshirë aspektin teorik dhe praktik.

Trajnimi teorik përmban 6 module për gjyqtarët e sapo emëruar dhe 5 module për prokurorët e sapo emëruar. Modulet përfshijnë të gjitha degët e së drejtës dhe ligjeve vendore, Konventën Evropiane për të Drejta e Njeriut dhe akte të tjera ndërkombëtare. Modulet trajnuese janë të karakterit profesional që përfshijnë aspektin material dhe procedural të legjislacionit në fuqi për të gjitha fushat e së drejtës dhe interdisiplinare që kanë të bëjnë me aftësi praktike për menaxhimin dhe procedimin e rasteve.

Trajnimi praktik realizohet në gjykata/prokurori në të cilat janë emëruar dhe nën mbikëqyrjen e mentorit. Ky trajnim përfshinë aspektet praktike të punës së gjyqtarit/prokurorit, ndërkaq AD e monitoron këtë proces përmes koordinimit dhe punës së përbashkët me mentorë.

Pjesë përbërëse e programi trajnues janë edhe vizitat/trajnimet në institucione jo gjyqësore të cilat kanë për qëllim të ofrojnë njohuri gjyqtarëve/prokurove të shtetit të sapo emëruar me legjislacionin dhe praktikën që zbatohen në institucionet shtetërore gjatë punës së tyre, si dhe aktivitete që kryejnë këto institucionet, të ndërlidhura me punën e gjyqtarit dhe prokurorit.

Për çdo modul trajnues në fund realizohet testi përfundimtar dhe raporti i vlerësimit për gjyqtarë dërgohet në KGJK, respektivisht Komisionin për Vlerësimin e Performancës si dhe për prokurorë në KPK, përkatësisht në Komisionin për Vlerësimin e Performancës brenda afatit të paraparë.

6.2.1 Aktivitete e realizuara në Programet për Trajnim Fillestar gjatë vitit 2024

Në periudhën raportuese trajnimet fillestare i kanë vijuar 3 gjenerata të gjyqtarëve të sapo emëruar (X, XI, dhe XII) dhe një e prokurorëve të sapo emëruar (X). Në total përbëjnë 98 pjesëmarrës, prej tyre 74 gjyqtarë të sapo emëruar dhe 23 prokurorë të sapo emëruar. Pra, është vazhduar zbatimi i trajnimit praktik në gjykatat

⁴ Zyrtarë nga Agjencia për Informim dhe Privatësi, nga Oda e Avokatëve, nga OJQ, IKD etj.

përkatese të emërimit për 28 gjyqtarët e sapo emëruar të gjeneratës së X. Paralel me grupin e gjyqtarëve edhe trajnimi teorik dhe praktik njëkohësisht për 23 prokurorët e sapo emëruar të gjeneratës së X. Të dy gupet (i gjyqtarëve dhe i prokurorëve) kanë përfunduar trajnimin fillestar në muajin maj 2024 dhe për të dy këto profile është realizuar testi përfundimtar dhe janë përgatitur raportet me vlerësimet përfundimtare për KGJK dhe KPK.

Nga muaji shkurt i vitit 2024 ka filluar trajnimi fillestar edhe për 15 gjyqtarë të rinj të sapo emëruar që për AD-në përbëjnë gjeneratën e XI. Ky grup i gjyqtarëve ka përfunduar trajnimin teorik në muajin korrik dhe nga kjo periudhë kanë vijuar trajnimin praktik në gjykatat përkatese të emërimit si dhe në institucionet tjera jashtë gjyqësore.

Krahas trajnimit praktik të 15 gjyqtarëve të lartpërmendur ka filluar së zbatuari nga muaji shtator 2024 trajnimi fillestar edhe për gjeneratën e XII, përkatesisht për 31 gjyqtarë të sapo emëruar.

Për gjitha këto gjenerata janë realizuar 444 sesione trajnuese apo 1332 orë trajnim teorik dhe 261 ditë trajnimi praktik në gjykata dhe prokurori të shtetit.

Të dhënat me të detajuara janë paraqitur në tabelën e më poshtme:

Gjyqtarë / prokurorë të sapoemëruar	Nr. i të trajnuarve	Gjinia		Totali i ditëve të trajnimit	Ditë trajnimi teorik	Ditë trajnimi praktik	Sesione Trajnuese	Orë Trajnimi	Trajnues të angazhuar	Mentor të angazhuar
		M	F							
Gjenerata X e gjyqtarëve	28	16	12	99	/	99	/	/	/	28
Gjenerata XI e gjyqtarëve	15	9	6	213	117	96	234	702	36	29
Gjenerata XII e gjyqtarëve	31	17	14	79	79	/	158	474	26	/
Gjenerata X e prokurorëve	23 ^[3]	14	9	112	26	66	52	156	15	22
Totali	97	56	41	503	222	261	444	1332	77	79

Tabela nr.5: Trajnimin fillestar për vitin 2024 për gjeneratat X, XI dhe XII

- Zbatimi i Programit të trajnimit fillestar praktik për gjeneratën X (28 Gjyqtarëve të sapoemëruar) 2023-2024: Në periudhën raportuese, kjo gjeneratë e gjyqtarëve të sapo emëruar ka realizuar sesionet e trajnimit praktik deri me 24 maj me gjithsejt 99 ditë dhe me këtë është përfunduar trajnimi fillestar meqë sesionet e trajnimit teorik i ka përfunduar gjatë vitit 2023. Në kuadër të këtij trajnimi praktik, gjyqtarët nën mbikëqyrjen e gjyqtarit mentorë kanë shqyrtuar lëndët dhe kanë asistuar në të gjitha aktivitetet gjyqësore duke ndërmarrë veprimet e duhura për lëndët përkatese me rastin e praktikës. Mentorët kanë qenë të koordinuar me Akademinë e Drejtësisë në përmbushje të trajnimit praktik sipas kompetencave të përcaktuara me Programin trajnues për gjyqtarët e sapo emëruar. Pas përfundimit të trajnimit praktik është realizuar testi përfundimtar, rezultatet e të cilave janë dërguar në KGJK, përkatesisht në Komisionin për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve.

Trajnimin fillestar e kanë ndjekur 28 gjyqtar të sapo emëruar, një nga komuniteti boshnjak dhe një nga ai

^[3] Nga muaji dhjetor 2023, gjeneratës së dhjetë të prokurorëve kësaj gjenerate i është bashkuar dy prokurorë nga gjenerata e IX të cila ka përfunduar pushimin e lehonisë.

turk.

2. Zbatimi i Programit trajnues fillestar për gjeneratën X (23 prokurorët e sapoemëruar) 2023-2024: Për dallim nga gjyqtarët, për 23 prokurorët e sapo emëruar të gjeneratës së X janë realizuar sesionet e trajnimit teorik paralelisht me sesionet e trajnimit praktik deri me 25 maj 2024 me ç'rast kanë përfunduar programin fillestar konform kalendarit trajnues për këtë gjeneratë. Në total janë realizuar: 112 ditë trajnimi. Prej tyre 26 ditë trajnimi teorik apo 52 sesione trajnuese, 66 ditë trajnim praktik, prej tyre 8 vizita në institucionet jo gjyqësore në prokurorit përkatëse ku janë emëruar. Pas përfundimit të trajnimit praktik është realizuar testi përfundimtar, rezultatet e të cilave janë dërguar në KPK, përkatësisht në Komisionin për vlerësimin e performancës së Prokurorëve. Në kuadër të kësaj gjenerate ishin 21 prokurorë, ndërkaq nga data 4 dhjetor 2023 deri më 17 maj 2024 kanë vijuar edhe dy prokurorë nga gjenerata e kaluar të cilat nuk kanë përfunduar trajnimin fillestar me gjeneratën paraprake për shkak të pushimit të lehonisë. Për të njëjtat janë realizuar edhe disa moduleve trajnuese në mënyrë individuale, prej tyre 6 ditë trajnimi teorik apo 12 sesione, 21 ditë trajnim praktik në prokurori me qëllim të përbushjes në tërësi të programit trajnues dhe komfor vendimit.

Trajnimi teorik është zhvilluar në mënyrë të kombinuar me raste nga praktika gjyqësore, raste të simuluar dhe sipas 5 (pesë) kurrikulave trajnuese si në vijim:

- Shkathtësitë personale dhe ndërdisiplinare: 4 sesione apo 12 orë trajnimi nga moduli: Arsyetimi i vendimeve akteve akuzuese.
- Rendi juridik kombëtar dhe ndërkombëtar: 6 sesione apo 18 orë trajnimi nga moduli E drejta e Bashkimit Evropian dhe Bashkëpunimi Juridik Ndërkombëtar.
- Kodi Penal i Republikës së Kosovës: 4 sesione apo 12 orë trajnim nga moduli: Politika ndëshkimore.
- Kodi i Procedurës Penale: 30 sesione apo 90 orë trajnimi nga modulet: Procedurat alternative, Aktakuza dhe procedura e shqyrtimit, Roli i prokurorit në shqyrtim gjyqësor, Ushtrimi i mjeteve juridike dhe Shqyrtimi gjyqësor dhe Procedurat e veçanta sipas KPPK-së.
- Legjislacioni dhe shkathtësitë plotësuese: 8 sesione apo 24 orë nga moduli: Zhvillimi i shkathtësive gjyqësore.

Në këtë gjeneratë për zbatimin e trajnimit teorik janë angazhuar 15, trajnues prej tyre: 3 nga Prokuroria Speciale, 3 nga Prokuroria e Zyrës së Shtetit, 2 nga Prokuroria Themelore, 1 nga Prokuroria e Apelit, 2 nga Gjykata Supreme, 2 nga Gjykata e Apelit, 1 nga Zyra e Bashkimit Evropian, 1 nga Gjykata Themelore.

3. Zbatimi i Programit trajnues fillestar për gjeneratën XI (15 gjyqtarët e sapoemëruar) 2024-2025: Për këtë gjeneratë, trajnimi fillestar ka filluar së zbatuari nga muaji shkurt, përkatësisht me 05 shkurt 2024. Për gjashtë muaj me radhë janë realizuar sesionet e trajnimit teorik dhe në periudhën raportuese gjenden në proces të zbatimit të trajnimit praktik në gjykatat përkatëse të emërimit që përfundon me 28 shkurt 2025. Në kuadër të trajnimit fillestar për këtë gjeneratë janë realizuar të gjitha trajnimet teorike që përfshijnë 6 module trajnuese, përkatësisht 117 ditë të trajnimit teorik apo 234 sesione trajnuese si dhe 91 ditë trajnime praktike në gjykata dhe 5 vizita në institucione jo gjyqësore.

Trajnimi teorik është zhvilluar në mënyrë të kombinuar me raste nga praktika gjyqësore, raste të simuluar dhe sipas moduleve si në vijim:

- Shkathtësitë personale dhe ndërdisiplinare: 24 sesione apo 72 orë trajnimi nga modulet: Rregullat e komunikimit, Ngritja e shkathtësive sociale të gjyqtarëve dhe prokurorëve, Menaxhimi i rasteve, Etikë profesionale dhe përgjegjësia disiplinore dhe Arsyetimi i vendimeve gjyqësore në lëmine penale dhe civile.
- Rendi juridik kombëtar dhe ndërkombëtar: 19 sesione apo 57 orë trajnim, nga modulet: E drejta kushtetuese në raport me sistemin gjyqësor dhe prokurorial, Konventa Evropiane për Liritë dhe të Drejtat e Njeriut, E drejta e Bashkimit Evropian dhe Bashkëpunimi Juridik Ndërkombëtar në çështje

penale dhe civile.

- E drejta civile, administrative dhe ekonomike: 84 sesione apo 252 orë trajnim nga modulet: E drejta civile, Procedura kontestimore - pjesa e parë, Procedura kontestimore - pjesa e dytë, Procedura jonkontestimore, Procedura përmbartimore, E drejta administrative, E drejta e detyrimeve, E drejta e pronësisë dhe të drejtat tjera të përafërta, E drejta e punës, E drejta familjare, E drejta komerciale, E drejta administrative dhe e drejta trashëgimore”.
- Kodi Penal i Republikës së Kosovës: 35 sesione apo 105 orë trajnimi dhe janë trajtuar modulet: Kodi penal - pjesa e përgjithshme, Kodi penal - pjesa e veçantë, Krimi kibernetik, Politika ndëshkimore dhe përgjegjësia e personave juridik”.
- Kodi i Procedurës Penale: 49 sesione apo 147 orë trajnimi nga modulet: Procedura paraprake penale, Masat e fshehta të hetimit dhe të vëzhgimit, Parimet, kompetencat dhe përjashtimi i gjyqtarit në procedurën penale, Masat e sigurisë së të pandehurit në procedurë penale, Palët në procedurën penale, Dëshmitarët dhe të dëmtuarit në procedurën penale, Shqyrtimi fillestar, Shqyrtimi gjyqësor, Shpenzimet e procedurës dhe kërkesat pasurore juridike, Procedura sipas mjeteve juridike, Aktgjykimi dhe llojet e tij, Procedura penale e kryerësve me çrregullimi mendore, Procedurat e veçanta sipas KPPK, Provat në procedurën penale dhe Procedurat alternative.
- Legjislacioni dhe shkathtësitë plotësuese: 23 sesione apo 69 orë trajnim nga modulet: Kodi i drejtësisë për të mitur, Ligji për kundërvajtje, Ndërmjetësimi, Mbrojtja nga diskriminimi, Dhuna në familje dhe Zhvillimi i shkathtësive gjyqësore.

Në këtë gjeneratë për zbatimin e trajnimit teorik janë angazhuar 36 trajnues prej tyre: 4 gjyqtarë nga Gjykata Supreme, 15 nga Gjykata e Apelit, 1 nga Gjykata Komerciale, 4 nga Gjykata Themelore, 2 nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, 3 nga Prokuroria Speciale, 3 nga Prokuroria Themelore, 2 profesor universitar, 1 trajnues nga Departamenti për Bashkëpunimin Juridik Ndërkombëtar, dhe 1 trajnues i përhershëm nga Akademia e Drejtësisë.

Për këtë gjeneratë të gjyqtarëve nga muaji nëntor 2024 ka filluar së zbatuari trajnimi praktik nën mbikëqyrjen e mentorit gjyqtar me ç’rast aktualisht janë realizuar 96 ditë trajnimi. Në cilësinë e mentorit kanë qenë të angazhuar gjyqtarë.

4. Zbatimi i Programit trajnues fillestar për gjeneratën XII (31 gjyqtaret e sapoemëruar) 2024-2025: Procesit të zbatimit të trajnimeve fillestare për 31 gjyqtarët e sapo emëruar i ka paraprirë rishikimi i programit fillestar dhe hartimi i tij përshtatshëm me kërkesat e KGJK-së dhe me zhvillimet në legjislacion. Janë rishikuar modulet dhe sesionet trajnuese dhe është finalizuar programi nga Këshilli Programor i AD-së dhe i njëjti është miratuar nga Këshilli Drejtues.
Për këtë gjeneratë, trajnimi fillestar ka filluar së zbatuari nga muaji shtator, përkatësisht me 06 shtator 2024. Ngjashëm si me gjeneratën paraprake, fillimisht me sesionet e trajnimit teorik që sipas programit përfundon në muajin mars 2025 për të vazhduar më pas me sesionet e trajnimit praktik.

Në periudhën raportuese në kuadër të trajnimit teorik janë realizuar 79 ditë trajnimi me 158 sesione trajnuese apo 474 orë trajnimi nga 6 modulet trajnuese si në vijim:

- Kodi Penal i Republikës së Kosovës - janë realizuar 30 sesione trajnues apo 90 orë trajnim nga modulet: Kodi Penal-pjesa e veçantë, krimi kibernetikë dhe politika ndëshkimore.
- Kodi i Procedurës Penale: 43 sesione trajnuese apo 129 orë trajnimi nga modulet: Procedura paraprake penale, palët në procedurën penale, kompetencat dhe përjashtimi i gjyqtarit në procedurën penale, dëshmitarët dhe të dëmtuarit në procedurën penale, shqyrtimi fillestar, shqyrtimi gjyqësor, procedura sipas mjeteve juridike, forma e paraqitjes së parashtrësive dhe llogaritja e afateve, aktgjykimi dhe llojet e tij, procedurat penale e kryerësve me çrregullimi mendore, procedurat e veçanta sipas KPPK, provat në procedurën penale dhe procedurat alternative.
- Shkathtësitë personale dhe interdisciplinare: 14 sesione trajnues apo 42 orë trajnime nga modulet: Rregullat e komunikimit, etikë profesionale dhe përgjegjësia disiplinore, menaxhimi i rasteve dhe

vlerësimi i performancës dhe arsyetimi i vendimeve gjyqësore në lëmin penale.

- Rendi juridik kombëtar dhe ndërkombëtar: 18 sesione trajnues apo 54 orë trajnim nga modulet: Drejtësia kushtetuese në raport me sistemin gjyqësor dhe prokurorial”, e drejta e Bashkimit Evropian, Konventa Evropiane për Liritë dhe të Drejtat e Njeriut dhe bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në lëmin penale.
- Legjislacioni dhe shkathtësitë plotësuese: 19 sesione apo 57 orë trajnues nga modulet: Kodi i drejtësisë për të mitur, mbrojtja nga diskriminimi, ndërmjetësimi në çështje civile, ligji për kundërvajtje dhe dhuna në familje.
- E drejta civile, administrative dhe ekonomike: 34 sesione trajnues apo 102 orë trajnim nga modulet: Procedura kontestimore-pjesa e parë, procedura kontestimore-pjesa e dytë, procedura përmbartimore, e drejta e detyrimeve dhe e drejta e trashëgimisë.

Për zbatimin e trajnimit teorik janë angazhuar 26 trajnues prej tyre: 5 gjyqtarë nga Gjykata Supreme, 9 nga Gjykata e Apelit, 3 nga Gjykata Themelore, 2 nga Prokuroria Speciale, 2 nga Prokuroria Themelore, 3 profesor universitar dhe 1 trajnues nga departamentit për bashkëpunimin juridik ndërkombëtar.

5. Zbatimi i trajnimit për gjyqtaret porot: Bazuar në kërkesën e KGJK-së me 4 dhe 5 mars 2024: janë realizuar sesionet e trajnimit edhe për 15 gjyqtarët porot të emëruar gjatë vitit 2023, të cilët nuk kanë arritur të jenë pjesë e trajnimit me grupin e parë që vijuan trajnimin në Akademi të Drejtësisë menjëherë pas emërimit. Konform vendimit të KGJK-së nr. 01/133 të datës 09 shkurt 2024 trajnimi është realizuar duke i'u përmbajtur kurrikulës së rekomanduar nga ky institucion. Qëllimi i këtij trajnimi ishte aftësimi i gjyqtarëve porot për detyrat dhe përgjegjësitë e tyre sipas legjislacionit në fuqi në çështjet familjare dhe procedurën kontestimore.

Gjyqtarët porot për dy ditë ma radhë janë njoftuar me Kodin e Etikes dhe përgjegjësinë disiplinore fillimisht, e më pastaj për aspekte të rëndësishme të procedurës kontestimore në çështjet familjare, që sipas legjislacionit në fuqi janë pjesë përbërëse e trupit gjykues bashkë me gjyqtarin profesionist. Pas përfundimit të trajnimit teorik për gjyqtarët porot është organizuar testi me shkrim për njohuritë e përfituara gjatë këtij trajnimi, rezultatet e të cilave i janë dërguar Këshillit Gjyqësor të Kosovës menjëherë pas vlerësimit. Gjyqtarët që kanë përfunduar suksesshëm trajnimin teorik i janë nënshtruar edhe trajnimit praktik në gjykatat përkatëse të emërimit nën mbikëqyrjen e mentorëve të përcaktuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Në kuadrin e trajnimeve fillestare, Akademia e Drejtësisë në Planin e saj të punës dhe të performancës ka paraparë zbatimin e trajnimeve fillestare për gjeneratën e XI të prokurorëve dhe gjeneratën e XIII të gjyqtarëve prej muajit qershor -korrik 2024 por që nuk janë realizuar për shkak të vonesave në procedurat e rekrutimit të KPK-së dhe KGJK-së, dhe te njëjtat janë barte te realizohen gjate vitit 2025.

Po ashtu në planin e saj ka planifikuar edhe trajnime të detyrueshme si rezultat i performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve por që nuk janë realizuar për shkak që nuk ka pasur kërkesa nga KGJK dhe KPK.

6.3 AVANCIMI I VAZHUESHËM I NJOHURIVE PROFESIONALE DHE NTERDISIPLINARE TË GJYQTARËVE, PROKURORËVE, STAFIT ADMINISTRATIV GJYQËSOR DHE PROKURORIAL SI DHE PROFESIONISTEVE TË TJERË LIGJOR - (PTV)

Trajnimet e vazhdueshme synojnë avancimin e vazhdueshëm të njohurive profesionale dhe interdisiplinare të gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë, duke përfshirë edhe kuadrin tjetër ligjor brenda gjykatave dhe prokurorive dhe profesioneve të lira, të cilët sipas ligjit janë përfitues të kurrikulave trajnuese që ofron Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme.

Edhe këtë vit programi ka qenë gjithëpërfshirës dhe ka ofruar trajnime nga fusha penale, civile, drejtësia për fëmijë - aspekti civil dhe penal, drejtësia komerciale, administrative, kushtetuese, për Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut – KEDNJ, të drejtën e BE-së, kundërvajtje, ndërmjetësim, për mos diskriminim, për dhunën ndaj grave, dhunën në familje dhe dhunën në baza gjinore, si dhe trajnimet nga kompetenca interdisciplinare.

6.3.1 Aktivitetet trajnuese të realizuar gjatë vitit 2024 në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, arritjet dhe sfidat

Në periudhën raportuese, janë realizuar 174 aktivitete trajnuese, me gjithsej 236 ditë trajnimi. Numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve ishte 3858. Prej tyre 962 nga radhët e gjyqtarëve 274 nga radhët e prokurorëve, 327 nga radhët e ndërmjetësuesve, 31 nga radhët e avokatëve, 983 nga radhët e bashkëpunëtorëve profesional të gjykatave dhe prokurorive, 662 nga radhët e zyrtarëve ligjor po ashtu nga gjykatat dhe prokuroritë, 76 nga radhët e zyrtarëve të Agjencisë për Ndihme Juridike Falas, 288 staf administrativ gjyqësor dhe prokurorial, 20 nga menaxhmenti i prokurorive, 13 zyrtar nga Shërbimi Sprovues i Kosovës, 4 Mbrojtës të viktimave, 5 Avokate Shtetëror, 73 Zyrtar Policor, 21 Inspektorati Policor i Kosovës, s dhe 119 profesionist te tjerë ligjor. Nga 174 aktivitete trajnuese të realizuara gjatë vitit 2024: 84 ishin për gjyqtarë, prokurorë dhe kategori tjera përfituese, 12 trajnime për ndërmjetësues, 2 trajnime për avokatë, 60 trajnime për Bashkëpunëtor profesional dhe Zyrtar Ligjor (53 trajnime nga Moduli Bazik dhe 7 trajnime tjera), 1 për Menaxhmentin e prokurorisë si dhe 15 trajnime për Stafin Administrativ gjyqësor dhe prokurorial.

Aktivitetet trajnuese në PTV të realizuar gjatë vitit 2024							
Nr.	Përfituesit	Trajnime Tryeza	Ditë trajnimi	Pjesëmarrës	Tipi i Pjesëmarrjes		
1.	Aktivitete Trajnuese të realizuar gjatë 2024	174	236	3858 (një pjesëmarrësi i trajnuar më shumë se njëherë)	Gjyqtarë, Prokurorë dhe tjerë		
2.	Aktivitete Trajnuese të realizuar për gjyqtarë dhe prokurorë	84	125	1714	Gjyqtarë	962 ⁵	285 ⁶
					Prokurorë	274 ⁷	112 ⁸
					Bashkëpunëtorë Profesional	194	
					Zyrtar Ligjor	35	
					Staf Administrativ gjyqësor dhe prokurorial	15	
					Zyrtare te Agjencisë për Ndihme Juridike Falas	3	
					Zyrtar nga Shërbimi Sprovues i Kosovës	13	
					Mbrojtës të viktimave	4	
					Avokatë Shtetëror	5	
					Ndërmjetësues	31	
					Zyrtar Policor	73	
					Inspektorati Policor i Kosovës	21	
					Te tjerë ⁹	84	

⁵ Numri prej 962 tregon pjesëmarrjen nga radhët e gjyqtarëve

⁶ Numri prej 285 tregon numrin e gjyqtarëve të trajnuarve

⁷ Numri prej 274 tregon pjesëmarrjen nga radhët e prokurorëve

⁸ Numri prej 112 tregon numrin e prokurorëve të trajnuarve

⁹ Per detaje rreth pjesëmarrjes shih tabelën në vijim

3.	Trajnime për profesione te lira - Ndërmjetësues	12	24	296		296
4.	Trajnime për profesione te lira - Avokatë	2	2	31		31
5.	Bashkëpunëtor profesional dhe Zyrtar Ligjor	60 (53 nga Modulet bazike dhe 7 tjera)	67	1524	Bashkëpunëtor Profesional Zyrtar Ligjor Zyrtare te Agjencisë për Ndhim Juridike Falas Tjerë	789 627 73 35
6.	Trajnime për Menaxhimin e prokurorisë	1	1			20
7.	Stafi Administrativ gjyqësor dhe prokurorial	15	17			273

Tabela nr. 6: Aktivitetet trajnuese në PTV të realizuar gjatë vitit 2024

Pjesëmarrës tjerë në aktivitetet trajnuese bashkë me gjyqtarë dhe prokurorë		
Kategoria përfituese	Kategoria përfituese	Kategoria përfituese
Këshilltar Juridik nga Gjykata Kushtetuese	2	2
Praktikant nga Gjykata Komerciale	18	5
Praktikant nga Këshilli Gjyqësor	2	2
Praktikant nga Ministria e Drejtësisë	1	1
Prokurore nga Prokuroria-Shkodër	1	1
Zyrtar nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara	7	7
Zyrtar ligjor nga Agjencia Kosovare e Privatizimit	1	1
Staf i Akademisë	1	1
Zyrtar nga CRP/K	3	3
Zyrtar nga Dogana e Kosovës	3	3
Zyrtar nga Ministria e Drejtësisë	6	6
Zyrtar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	5	5
Analist i Inteligjencës Financiare nga Njësia e Inteligjencës Financiare	4	4
Drejtor ekzekutiv nga Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve (QMGF) në Prishtinë	1	1
Drejtori nga Shkolla e Magjistraturës së Shqipërisë	1	1
Ekspert dhe Zyrtar nga UNHCR	3	3
Asistent nga YIHR KS	1	1
Mjekë Veterinerë	2	2
Drejtoresh nga AUV	1	1
Koordinator	1	1
Anëtar i Komisionit për Refugjatë	1	1
Zyrtar të kontraktuar nga USAUD-i që punojnë për Gjykatën Komerciale	19	4

Tabela nr.7: Pjesëmarrës tjerë në aktivitetet trajnuese bashkë me gjyqtarë dhe prokurorë

6.3.2 Aktivitetet e realizuara nga Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm sipas fushave

Në periudhën raportuese janë realizuar trajnime nga të gjitha fushat e së drejtës përfshirë atë civile, penale, drejtësinë për fëmijë (penale dhe civile), ekonomike-komerciale, administrative, kundërvajtje, KEDNJ, BE dhe ndërkombëtare, e drejta kushtetuese, ndërmjetësim si dhe nga kompetenca nderdisciplinare.

Nr	Trajnimet e realizuar sipas fushave për gjyqtarë dhe prokurorë gjatë vitit 2024	Gjithsej trajnime
1.	Penale	32
2.	Civile	11
3.	Drejtësia për Fëmijë - Civile	2
4.	Drejtësia për Fëmijë - Penale	2
5.	E drejtë e BE-së	1
6.	Ekonomike	13

7.	Interdisiplinare	2
8.	KEDNJ	5
9.	Kundërvajtje	2
10.	Kushtetuese	2
11.	Administrative	5
12.	Kunderdiskriminim	3
13.	Ndërmjetësim	4
Totali		84

Tabela nr. 8: Trajnimet e realizuara sipas fushave

1. Aktivitetet trajnuese nga lëmia penale (materiale dhe procedurale)

Në fushën penale janë realizuar 32 aktivitete trajnuese, në të cilat kanë marrë pjesë 577 pjesëmarrës. Në kuadër të këtyre aktiviteteve, janë trajtuar çështje nga e drejta penale materiale dhe e drejta procedurale. Temat e trajtuara janë si në vijim: Mbrojtja e interesave të tretëve dhe të kreditorëve gjatë procesit të konfiskimit pasuror për garantimin e të drejtave reale e atyre të pronësisë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe garantimin, Dëshmitarët e mbrojtur, marrëveshja mbi pranimin e fajësisë dhe dëshmitarët bashkëpunues, Hetimet Financiare dhe Rikuperimin e Aseteve, Kompetencat e gjyqtarit gjatë procedurës së sekuestrimit dhe konfiskimit pasuror dhe kushtet kur mund të vendoset konfiskimi, Trajtimi i të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë gjatë qasjes në drejtësi, Luftimi i krimeve të rënda dhe të organizuar, korrupsionit të nivelit të lartë dhe veprave komplekse, Pastrimi i parave dhe hetimi financiar, Krimet e luftës, Sekuestrimi dhe Konfiskimi i pasurisë, Gjykimi në mungesë, Trajnim i specializuar gjyqësor lidhur me Bashkëpunimin ndërkombëtar, Terrorizmi dhe Ekstremizmi i Dhunshëm, Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare, Ngrirja, konfiskimi dhe menaxhimi i asetve virtuale në rastet e pastrimit të parave, Krimi kibernetik dhe kriptovalutat, Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare; ngrirja e asetve dhe konfiskimi, Zbatimi i Udhëzueseve për politikën ndëshkimore, unifikimi i praktikës për matjen së dënimit, Gjykimi i rasteve me armë të zjarrit, Vështrim i kërcënimeve të reja dhe kompleksitetet ligjore, Luftimi i krimeve të rënda dhe të organizuar, korrupsionit të nivelit të lartë dhe veprave komplekse, Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare, Strategjia e hetimit, masat e veçanta hetimore, Trajnim për institucionet ligj zbatuese rreth abuzimit ndaj kafshëve dhe ndërlidhjes me dhunën në familje, Prokurimi Publik si dhe Procedura penale e kryesve me çrregullime mendore.

Qëllimi i aktiviteteve trajnuese ishte adresimi i çështjeve sfiduese të praktikës gjyqësore dhe ofrimi i praktikave më të mira në zbatimin e drejtë të legjislacionit të aplikueshëm dhe zgjidhjen meritore të rasteve gjyqësore.

2. Aktivitetet trajnuese nga lëmia civile (materiale dhe procedurale)

Në fushën civile janë realizuar njëmbëdhjetë (11) aktivitete trajnuese, me 299 pjesëmarrës. Aktivitet trajnuese në fushën civile janë realizuar në formë të tryezave në ambient interaktiv të diskutimeve dhe ushtrimeve praktike dhe si të tilla kanë shërbyer për unifikim të praktikave jo unike në gjykatat e instancave me të ulëta. Çështjet e trajtuara ishin praktika gjyqësore gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimeve të gjykatave të instancave më të ulëta në kontestet për anulimin e kontratave, çështjet pronësore lidhur me fitimin e pronësisë nga baza e parashkrimit fitues dhe baza e ndërtimit, kontestet e shpërblimit të dëmit material lidhur me fitimin e humbur, rentën e arritur dhe rentën për të ardhmen, çështje nga proceduara kontestimore, jokontestimore dhe procedura përmbartimore, procedura trashëgimore dhe kontestet gjyqësore nga baza e trashëgimisë, shqyrtimi paraprak i padisë në kontestet e punës, në kontestet e pengim posedimit dhe në kontestet e fyerjes dhe shpifjes –afatshmëria/ lejueshmëria si prezumim procedural, Ndihma dhe bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështjet civile, marrëdhëniet detyrimeve me element të huaj dhe bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështjet civile.

Qëllim i aktiviteteve trajnuese ishte adresimi i çështjeve sfiduese në zbatimin e dispozitave të Ligjit për Pronësinë dhe të drejtat tjera sendore nga këto forma të fitimit të pronësisë, sfidave dhe problematikave në rastet e veçanta për zbatimin e Ligjit të Procedurës Jokontestimore, sfidave nga praktika gjyqësore të kontestet gjyqësore nga baza e trashëgimisë, sfidave të bashkëpunimit juridik ndërkombëtar për çështjet civile dhe nëfushën e së drejtës private në Kosovë, me theks të veçantë në marrëdhëniet detyrimore për rritjen e efikasitetit dhe cilësinë në vendimmarrje për rastet përkatëse.

3. Aktivitetet trajnuese për Drejtësinë për fëmijë – aspekti civil dhe penal

Për drejtësinë për fëmijë janë realizuar katër (4) aktivitete trajnuese, me 89 pjesëmarrës. Në aspektin civil është trajtuar mbrojtja gjyqësore e të drejtave të fëmijëve në procedurën kontestimore dhe jo kontestimore e cila është realizuar dy here brenda vitit ku janë përfshirë gjyqtarët dhe prokurorët e të gjitha regjioneve.

Në aspektin penal janë trajtuar veprat penale kundër integritetit seksual, ndjeshmëria e aspekteve psikologjike gjatë trajtimit të fëmijëve – viktima të dhunës seksuale si dhe procedura penale që zhvillohet ndaj të miturit, masat dhe dënimet që shqiptohen ndaj të miturit.

Qëllim i këtyre aktiviteteve trajnuese ishte ngritja e aftësive dhe shkathtësive të gjyqtarëve dhe prokurorëve rreth vlerësimit të ligjshmërisë së vendimeve të gjykatave të instancave më të ulëta në kontestet lidhur me çështjet statusore si dhe për veprat penale konform Kodit të Drejtësisë për të mitur dhe akteve ndërkombëtare

4. Aktivitetet trajnuese nga fusha Komerciale

Për drejtësinë komerciale janë realizuar trembëdhjete (13) trajnime me 322 pjesëmarrës. Në këto trajnime janë trajtuar çështjet si në vijim: Arbitrazhi në kontestet investitor-Shtet (ISDS), Marrëdhëniet komerciale me element të huaj dhe bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështjet komerciale, Implikimet në praktikë të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, Hulumtimi, shkrimi dhe arsyetimi ligjor në fushën komerciale, Zbatimi dhe specifikat e instrumenteve ndërkombëtarë, Direktivave dhe Rregulloreve të UE-së mbi çështjet komerciale dhe doganore, Kuptimi i industrisë bankare, sigurimeve dhe institucioneve financiare, Procedura e falimentimit, Njohuritë financiare, Të drejtat e pronësisë intelektuale, markat tregtare, patentat dhe specifikat e industrisë së TIK-ut, licencimit dhe të drejtave të pronësisë industriale, Njohja dhe përmbartimi i vendimeve të Arbitrazhit vendor dhe të huaj, E drejta kontraktuese, kontratat e ndërtimit, Ndërmjetësimi Komercial si mekanizëm alternativ për zgjidhjen e kontesteve, Ndërmjetësimi, mënyrat e referimit të lëndëve në procedurën e ndërmjetësimit - raste praktike, Procedura e aprovimit ose anulimit të marrëveshjeve të ndërmjetësimit komercial, Elaborimi i rasteve praktike ndërkombëtare të rasteve komerciale në ndërmjetësim dhe Trajnim për treguesit gjeografikë dhe emërtimet e origjinës.

Realizimi i këtyre trajnimeve synoi ngritjen e kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve të Gjykatës Komerciale dhe bashkëpunëtorëve profesional lidhur me çështjet ligjore që hyjnë në juridiksionin e kësaj gjykate dhe vendosjen drejtë dhe në mënyrë meritore të rasteve përkatëse.

5. Aktivitetet trajnuese nga fusha Administrative

Në fushën administrative janë realizuar pesë (5) aktivitete trajnuese në të cilat kanë marrë pjesë 72 pjesëmarrës. Temat e trajtuara ishin: Risitë e Ligjit për Konfliktet Administrative, Mbrojtja gjyqësore në konfliktin administrativ, Arsyetimi i vendimeve gjyqësore në procedurën e konfliktit administrativ, E drejta e Azilit - Praktikrat gjyqësore në vend dhe Evropë në fushën e Mbrojtjes Ndërkombëtare të Refugjatëve, procedura gjyqësore administrative.

Qëllimi i këtyre aktiviteteve ishte rritja edhe më tej e kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve në interpretimin dhe zbatimin e drejtë të dispozitave ligjore për procedurën administrative dhe procedurën e konfliktit

administrativ, të kuptojnë rolin dhe rëndësinë e parimeve të shkrimit të mirë ligjor si dhe të avancojnë njohuritë rreth praktikave gjyqësore lidhur me vendimet mbi paditë për njohjen e statusit të refugjatit.

6. Aktivitetet trajnuese nga e Drejta Kushtetuese

Në periudhën raportuese janë realizuar dy (2) trajnime me 34 pjesëmarrës nga lëmia e së drejtës kushtetuese. Temat e trajtuara ishin: Praktika aktuale e Gjykatës Kushtetuese në lidhshmëri me praktikën e GJEDNJ sipas kërkesave në lëmin civile si dhe Praktika aktuale e Gjykatës Kushtetuese në lidhshmëri me praktikën e GJEDNJ sipas kërkesave në lëmin penale.

Synim kryesor i këtyre trajnimeve ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe përfituesve të tjerë lidhur me njohuritë e reja dhe vendimet kryesore në praktiken aktuale të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës në lidhshmëri me praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) sipas kërkesave në lëmin civile dhe penale.

7. Aktivitetet trajnuese për Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Rendësi e veçantë në programin trajnues i është kushtuar trajnimeve për mbrojtjen e të drejtave të njeriut gjatë zhvillimit të procedurave ligjore. Për KEDNJ, gjatë periudhës raportuese janë realizuar pesë (5) trajnime, me 129 pjesëmarrës. Aspektet e trajtuara ishin si në vijim: Qasja në mjete juridike efektive, Praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut sipas nenit 5 dhe nenit 6 të KEDNJ, Liria e Shprehjes dhe Mbrojtja gjyqësore në rastet e cenimit të lirisë së shprehjes - Trajnim i specializuar për Paditë Strategjike Kundër Pjesëmarrjes Publike (SLAPPs), Mbrojtja e të dhënave personale si dhe Mbrojtja e të Drejtave Themelore në Evrope.

Fokusi kryesor i këtyre trajnimeve ishte ngritja e aftësive dhe shkathtësive profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve në avancimin e njohurive lidhur me zbatimin e nenit 5, 6 dhe 10 të KEDNJ, zbatimin e standardeve dhe praktikave përkatëse të GJEDNJ-së për të drejtën për një mjet efektiv juridik në praktikën e tyre gjyqësore, promovimin e së drejtës për qasje në dokumente publike si dhe promovimin e së drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale.

8. Aktivitetet trajnuese për të Drejtën Evropiane

Në kuadër të kësaj fushe është realizuar trajnimi Unifikimi i legjislacionit penal me atë të vendeve të UE-së - Bashkëpunimi gjyqësor në çështjet penale (aspekti procedural) në Unionin Evropian si dhe Zbatimi dhe specifikat e instrumenteve ndërkombëtarë, Direktivave dhe Rregulloreve të UE-se mbi çështjet komerciale dhe doganore që është paraqitur te aktivitetet e drejtësisë komerciale. Trajnimi ka synuar përgatitjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve për të kuptuar dhe zbatuar më mirë parimet dhe standardet evropiane në bashkëpunimin gjyqësor. Në këtë trajnim kanë marrë pjesë 21 pjesëmarrës.

9. Aktivitetet trajnuese nga fusha e kundërvajtjeve

Nga fusha kundërvajtëse gjatë periudhës raportuese janë realizuar dy trajnime me 17 pjesëmarrës. Temat e trajtuara ishin: Personat Juridik si kryerës të veprave kundërvajtëse dhe Ligji për Pyjet e Kosovës, Mbrojtjen e Natyrës dhe Mbrojtjen e Ambientit. Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte avancimi i njohurive të përfituesve përmes elaborimit të legjislacionit të zbatueshëm që ka të bëjë me statusin juridik të subjekteve afariste në procedurën gjyqësore si dhe përkufizimi i drejtë i kompetencave për kundërvajtjet dhe sanksionet kundërvajtëse të Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës, dhe të Ligjit për Mbrojtjen e Ambientit në raport me Gjykatat.

10. Aktivitetet trajnuese nga fusha e ndërmjetësimit

Në periudhën raportuese janë realizuar katër (4) trajnime regjionale me teme Referimi i lëndëve në procedurën e ndërmjetësimit-raste praktike, procedura e aprovimit ose anulimit të marrëveshjeve të ndërmjetësimit, ndërmjetësimi i detyrueshëm. Pjesëmarrës në trajnime ishin 76 prej tyre 41 gjyqtarë dhe prokurorë dhe 35

ndërmjetësues. Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte avancimi i njohurive rreth procedurës së ndërmjetësimit nga momenti i referimit të lëndës në ndërmjetësim, procedurën e aprovimit ose anulimit të marrëveshjeve të ndërmjetësimit si dhe sqarimi lidhur me ndërmjetësimin e detyrueshëm.

11. Aktivitetet trajnuese nga kompetenca interdispilinare

Në kuadër të kompetencës interdispilinare janë realizuar dy (2) trajnime me 50 pjesëmarrës. Temat e trajtuara ishin: Menaxhimi i lëndëve penale dhe orarit të gjykimeve si dhe Menaxhimi i prokurorisë. Synim kryesor i këtyre trajnimeve ishte avancimi i njohurive rreth menaxhimit dhe administrimit të lëndëve në gjykata dhe prokurori si dhe zbatimi i parimeve dhe standardeve të menaxhimit të mirë.

12. Aktivitetet trajnuese për mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhunës ndaj Grave (aspekti penal dhe civil)

Aktivitete trajnuese për mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhunës ndaj Grave në aspektin penal dhe atë civil në periudhën raportuese kanë tejkaluar planifikimin sipas programit trajnues. Në këtë kuadër janë realizuar shtate (7) trajnime, me 133 pjesëmarrës. Temat e trajtuara ishin: Dhuna ndaj Grave, Dhuna në Familje dhe Dhuna në Bazë Gjinore, Veprat e dhunës në familje: Përgjigja efektive e drejtësisë penale, Veprat penale që përfshijnë Dhunën ndaj Grave: Ndjekja penale dhe gjykimet e informuara mbi traumën dhe Kuptimi i Dhunës në Familje në të Drejtën Civile: Urdhrat Mbrojtës dhe Konsiderimet e të drejtës familjare, Dhunën në Familje dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut si dhe Dhuna në familje.

Qëllimi i zbatimit të kurrikulës për dhunën ndaj grave, dhunën në familje dhe dhunën me bazë gjinore ishte trajtimi i sfidave dhe çështjet specifike të identifikuara nga gjyqtarët dhe prokurorët në trajtimin e këtyre çështjeve dhe zgjidhja e këtyre rasteve konform legjislacionit në fuqi dhe standardeve të Konventës së Stambollit dhe instrumenteve tjera ndërkombëtare të akceptueshme në Kushtetutën tonë.

13. Aktivitetet trajnuese Kundër diskriminimit

Me qëllim të adresimit të sfidave të ndërgjegjësimit dhe të kuptuarit të konceptit të antigjipsizmit, duke përfshirë kontekstin historik, manifestimet dhe ndikimin e tij në komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian janë realizuar tri (3) trajnime për Antigjipsizimin. Në këto trajnime kanë marrë pjesë 37 pjesëmarrës. Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte ofrimi i njohurive për pjesëmarrësit në trajtimin e rasteve të antigjipsizmit brenda proceseve ligjore dhe administrative dhe efektet e tij në administrimin e drejtësisë.

14. Aktivitetet trajnuese për bashkëpunëtor profesional dhe zyrtar ligjor

Gjatë vitit 2024 për bashkëpunëtor profesional dhe zyrtarë ligjor të gjykatave dhe prokurorive janë realizuar gjithsej 60 trajnime me kohëzgjatje 67 ditë trajnimi, me numër të pjesëmarrjes 1524 veta. Nga Modulet e trajnimit bazik për bashkëpunëtorët profesional, në lëmin civile dhe penale janë gjithsej 53 trajnime me kohëzgjatje 53 ditë trajnimi. Nga lëmia penale, materiale dhe procedurale janë realizuar 35 trajnime, nga lëmia civile materiale dhe procedurale janë realizuar 18 trajnime. Numri i pjesëmarrjes ne modulën bazik 1524, prej tyre 789 bashkëpunëtor profesion, 627 zyrtar ligjor, 73 nga Agjencia për Ndihmë Juridike Falas si dhe 35 përfitues tjerë.

Përveç trajnimeve nga Moduli bazik, në periudhën raportuese janë realizuar edhe 7 trajnime tjera nga fusha penale ku përfitues kanë qenë kryesisht bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarët ligjor nga departamentet speciale (Gjykata Themelore në Prishtinë dhe PSRK). Numri i pjesëmarrjes ishte 105, prej tyre 65 bashkëpunëtor profesional dhe 40 zyrtar ligjor.

Modulet Bazike për Bashkëpunëtorë Profesional & Zyrtarë Ligjor	Nr.	Trajnimet e financuara	Nr.	Trajnime tjera për Bashkëpunëtorë Profesional & Zyrtarë Ligjor	Nr.	Trajnimet e financuara
Trajnime të realizuara	53	Akademia e Drejtësisë	33	Trajnime të realizuara	7	Trajnimet e financuara Western Balkans Rule of Law Initiative (WBROLI)
Penale	35	GIZ	10	Bashkëpunëtorë Profesional	65	
Civile	18	EULEX	10	Zyrtare Ligjor	40	
Bashkëpunëtorë Profesional	724					
Zyrtare Ligjor	587					
Zyrtar nga ANJF	73					
Përfitues tjerë	35					
Total	1419		53		105	

Tabela nr. 9: Trajnime të realizuara për Bashkëpunëtorë Profesional dhe Zyrtare Ligjor

15. Aktivitetet trajnuese për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial

Për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial janë realizuar 15 trajnime. Numri i pjesëmarrjes në këto trajnime ishte 273. Qëllimi kryesor i këtyre trajnimeve ishte avancimi i njohurive profesionale të stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial për rritjen e cilësisë së shërbimeve, efikasitetit të proceseve dhe ndërtimin e një sistemi gjyqësor sa më të besueshëm.

Trajnime për Stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial	
Trajnime të realizuar	15
Ditë trajnimi	16
Numri i pjesëmarrësve në total	273
Trajnimet e financuara nga Akademia e Drejtësisë	12
Trajnimet e financuara nga GIZ	2
EUKOJUST	1

Tabela nr. 10: Trajnime të realizuara për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial

16. Aktivitetet trajnuese për Ndërmjetësues

Përveç trajnimeve në fushën e ndërmjetësisë të cilat i janë dedikuar gjyqtarëve dhe dhe kuadrit ligjor brenda gjykatave për ndërmjetësimin janë realizuar edhe dymbëdhjetë (12) trajnime rifreskuese dhe të avancuara të cilat i janë dedikuar zyrtarëve të ndërmjetësisë. Këto trajnime i kanë vijuar 296 pjesëmarrës. Trajnimet rifreskuese për ndërmjetësues janë realizuar në 7 regjionet e Kosovës. Ndërsa trajnimet e avancuara për ndërmjetësues janë realizuar nga fusha: Penale, Komerciale, Civile/Pronësore, Familjare, Gjinore dhe Shkrim të marrëveshjeve të Ndërmjetësisë. Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte që ndërmjetësuesve të licencuar të ju ofrohen njohuri të avancuara dhe rifreskuese rreth procedurës së ndërmjetësisë, në fushën penale, familjare, pronësore dhe komerciale.

Trajnimet për Ndërmjetësues	
Trajnime të realizuara	12
Dite trajnimi	24
Pjesëmarrës	296

Tabela nr. 11: Trajnimet për Ndërmjetësues

17. Aktivitetet trajnuese për Avokatë

Gjatë vitit 2024 janë realizuar dy (2) trajnime për avokatë me temë: Dhunën në Familje dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Numri i pjesëmarrjes në këto trajnime ishte 31.

Qëllimi i trajnimeve ishte avancim i njohurive të avokatëve me konceptet themelore të Konventës së Stambollit dhe trajtimi i rasteve konform kërkesave të kësaj konvente për kryesit e dhunës dhe viktimat e dhunës në familje.

Trajnimet për Avokatë	
Trajnime të realizuara	2
Ditë trajnimi	2
Pjesëmarrës	31

Tabela nr. 12: Trajnimet për Avokatë

18. Zbatimi i trajnimeve përmes platformës në distancë

Në periudhën raportuese në platformën HELP janë zhvilluar dy kurse trajnuese për pjesëmarrësit nga Kosova. Njëri kurs ishte me temë: Arsyetimi gjyqësor të cilin e kanë përfunduar 16 pjesëmarrës dhe kursi tjetër me temë: Qasja në Drejtësi për Gratë që po ashtu e kanë përfunduar 16 pjesëmarrës. Gjithashtu edhe dy sesione trajnuese në bashkëpunim me UNDP/SAEK për Hetimin financiar. Këto sesione trajnuese janë realizuar me pjesëmarrje fizike ndërkaq të gjitha materialet trajnuese kanë qenë të integruara në platformën MOODLE e cila ka shërbyer si data bazë për pjesëmarrësit dhe trajnuesit në vendosjen e materialeve të trajnimit si dhe ushtrimet praktike. Këto sesione trajnuese i kanë vijuar 2 gjyqtarë, 1 prokurorë si dhe 9 bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor të gjykatave dhe prokurorive si dhe 9 zyrtarë policor.

6.3.3 Trajnuesit e angazhuar në zbatim të Programit për Trajnime të Vazhdueshme në vitin 2024

Për zbatimin e aktiviteteve trajnuese të planifikuara sipas Programit Trajnues dhe atyre të përfshira me kërkesë të partnerëve të AD-së gjatë 2024 janë angazhuar një numër i konsiderueshëm i trajnuesve.

Për detaje shih tabelën me poshtë:

Trajnuesit e angazhuar për zbatim të PTV gjatë 2023	
Trajnuesit nga radhët e sistemi gjyqësor	29
Gjykata Supreme	7
Gjykata e Apelit	13
DHPGJS	1
Gjykata Komerciale	3
Gjykatat Themelore	5
Trajnuesit nga radhët e Sistemit Prokurorial	21
ZKPSH	3
Prokuroria e Apelit	3
PSRK	10
Prokuroria Themelore	5
Trajnues të Tjerë	24
Avokate	2
Profesor Universitar	4
Profesione të Lira – Ndërmjetësuese	12
Njësi e Inteligjencës Financiare	2
MD	1
Tjerë	3
Totali	74

Tabela nr. 13 Trajnuesit e angazhuar për zbatim të PTV gjatë 2023

6.3.4 Mbështetja e donatorëve në ofrimin e trajnimeve të vazhdueshme

Trajnimet e vazhdueshme në masë të madhe janë mbështetur nga bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë të cilët kanë ndihmuar AD-në ngritjen e kapaciteteve të përfituesve të saj përmes ofrimit të ekspertizës, programeve të qëndrueshme dhe shkëmbimit të përvojave dhe praktikave të mira.

Në mbështetje të partnerëve ndërkombëtarë janë realizuar një numër i konsiderueshëm i aktiviteteve trajnuese duke kombinuar kështu ekspertize vendore me atë ndërkombëtare. Nga 174 aktivitetet trajnuese 118 janë mbështetur nga donatorët, ndërsa 56 janë realizuar nga buxheti i Akademisë së Drejtësisë. Nga 84 trajnime të realizuara për gjyqtarë dhe prokurorë, 73 janë realizuar me mbështetjen e donatorëve dhe 11 nga buxheti i Akademisë së Drejtësisë (për detaje shih tabelën nr. 3).

Në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme 68% e aktiviteteve trajnuese janë financuar nga donatorët dhe projektet e ndryshme, ndërsa 32% nga buxheti i AD-së. Në tabelën nr.3 pasqyrohet nr. i aktiviteteve trajnuese të realizuara si rezultat i bashkëpunimit të ngushtë me partnerë dhe donatorë.

Aktivitetet Trajnuese të realizuara gjatë vitit 2024 në kuadër të PTV-së nga AD dhe Donatorët														
Aktivitetet Trajnuese për Gjyqtarë dhe prokurorë			Bashkëpunëtor profesional			Stafi Administrativ gjyqësor dhe prokurorial			Menaxhmentin e Prokurorisë			Profesione të Lira Ndërmjetësues dhe avokatë		
84	AD	11	60	AD	34	15	AD	11	1	AD	0	14	AD	0
	Donator	73		Donator	26		Donator	4		Donator	1		Donator	14

Tabela nr.14: Aktivitetet trajnuese të vazhdueshme të realizuara nga AD dhe Donatorët

Nr	Trajnimet e financuara nga Donatorët e AD-së	Totali
1.	Ambasada Amerikane (FMCS-INL dhe IKD)	12
2.	US-DOJ/OPDAT	15
3.	USAID / Drejtësia Komerciale	14
4.	Ambasada Franceze	2
5.	Bashkimi Evropian - SIGMA	2
6.	Bashkimi Evropian - EUKOJUST	1
7.	CLARD - Qendra për Ndihmë Juridike dhe Zhvillim Regjional	2
8.	EIPA	1
9.	EULEX	11
10.	GIZ (Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit)	16
11.	Humanitarian Law Center Kosovo	1
12.	IRZ (German Foundation for International Legal Cooperation)	1
13.	Këshilli i Evropës - Mbështetja e Gjykatës Kushtetuese në zbatimin dhe shpërndarjen e standardeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut	4
14.	Këshilli i Evropës - Projekti kundër krimit ekonomik në Kosovë (PECK III)	1
15.	Këshilli i Evropës - Projekti CYBERKOP	1
16.	Këshilli i Evropës - Projekti Përafrimi I ligjeve dhe politikave me Konventën e Stambollit	4
17.	Këshilli i Evropës - Mbrojtja e lirisë së shprehjes dhe e medias PRO-FREX	1
18.	OSBE	4
19.	Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës - KRCT	2
20.	Regional Anti-Corruption Initiative (RAI) – Sekretariat	2
21.	Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN)	1
22.	Tier im Recht (TIR; Fondacioni për Kafshët në Ligj), Zvicër	1
23.	UNDP/SAEK	2
24.	UNHCR	2
25.	United Nations Office on Drugs and Crime - UNODC	2

26.	Western Balkans Rule of Law Initiative (WBROLI)	9
27.	Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve - KOMF	1
28.	Terre des hommes	3
Totali		118

Tabela nr. 15.: Numri i Trajnimeve të vazhdueshme të realizuara në mbështetje të Donatorëve 2024

6.4 ZHVILLIMI I PROGRAMEVE TRAJNUESE PËRMES ANALIZAVE HULUMTIMEVE DHE VEPRIMTARISË BOTUESE

Divizioni për analiza, hulumtime, botime dhe trajnues ka për qëllim zhvillimin profesional të gjyqtarëve, prokurorëve, stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial dhe profesionistëve tjerë ligjor përmes zhvillimit të programeve trajnuese përshtatshëmrisht me nevojat trajnuese si dhe krijimit të botimeve dhe burimeve të reja juridike me theks te praktika gjyqësore përmes hulumtimeve dhe veprimtarisë kërkimore. Aktivitetet e kësaj njësie kanë qenë të fokusuar në përgatitjen e raporteve të punës, planeve dhe dokumenteve tjera të rëndësishme që janë kërkesë e ligjit, në krijimin dhe zhvillimin e burimeve të reja juridike, përkatësisht përmbledhjeve të praktikës gjyqësore, përditësimin e bibliotekës elektronike me burime të reja ligjore, mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave statistikore dhe aktivitete tjera në funksion të ndarjes së informatave me komunitetin ligjor dhe raportimit institucioneve të sistemit të drejtësisë dhe për mekanizmat tjerë integruar.

1. Zbatimi i procesit të nevojave trajnuese për hartimin e Programit Trajnues dhe Planit të Punës dhe të Performancës së AD-së për vitin 2025

Vlerësimi i nevojave trajnuese është tejet me rëndësi për Akademinë e Drejtësisë. Është instrumenti thelbësor dhe parakusht për hartimin e një programi trajnues relevant dhe adekuat me nevojat trajnuese të gjyqtarëve, prokurorëve dhe përfituesve tjerë sipas ligjit. Andaj edhe në periudhën raportuese në pajtim me kornizën ligjore në fuqi, neni 6, pika 1.1, 1.2 dhe 1.5 e Ligjit për Akademinë është realizuar procesi i vlerësimit të nevojave trajnuese i cili ka kërkuar përkushtim dhe angazhim gjatë gjithë vitit. Së pari duke përcjellë konkluzionet pas trajnimeve të realizuara sipas kalendarit trajnues 2024 dhe në vijim duke zbatuar mekanizmat tjerë për vlerësim me qëllim që të shterohen gjitha burimet e nevojshme dhe të identifikohen saktë problemet praktike në gjyqësor.

Në këtë proces është përfshirë shqyrtimi i dokumenteve strategjike që kërkojnë nga institucionet e sistemit të drejtësisë përfshirë këtu edhe Akademinë e Drejtësisë angazhim në përmirësim të drejtësisë në shumë kompetenca të punës së gjyqtarëve dhe prokurorëve. Fokus më i madhe i është dhënë masave të cilat e bëjnë përgjegjëse AD-në në Strategjinë për sundimin e Ligjit 2021-2026, Strategjinë për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhunës ndaj grave 2022-2026 si dhe nga Programi Kombëtarë për të Drejtat e Njeriut 2021-2025 dhe prioritizimi tyre në programin trajnues të radhës sipas mundësive dhe kapaciteteve të AD-së meqë këto strategji janë obligative për të gjitha institucionet e vendit. Një pjesë e konsiderueshme e masave në këto dokumente e bëjnë Akademinë e Drejtësisë qoftë udhëheqëse ose edhe në bashkëpunim me KGJK dhe KPK duke përfshirë edhe me institucionet e profesioneve të lira.

Krahas shqyrtimit të gjithanshëm të dokumenteve dhe raporteve që monitorojnë sistemin gjyqësor dhe prokurorial është realizuar edhe mbledhja e të dhënave nga anketat vlerësuese të përcjella në gjykata dhe prokurori por edhe pas çdo sesi trajnues të mbajtur në AD. Shqyrtimi i propozimeve nga vizitat dhe takimet në KGJK dhe KPK, gjykata dhe prokurori të mbajtura gjatë gjithë vitit, propozimeve nga takimet e përditshme me trajnuesit me rastin e zbatimit të programeve trajnuese. Veçanërisht thelbësore kanë qenë rezultatet e punëtorisë për vlerësimin e nevojave trajnuese të realizuar me kryetar të gjykatave dhe kryeprokuror të prokurorive gjatë muajit korrik. Në këtë punëtori janë përfshirë edhe përfaqësues nga KGJK dhe KPK në kuadër të cilës është shteruar debati për nevojat trajnuese dhe është përcaktuar kurrikula trajnuese për të gjitha fushat. Rol të rëndësishëm në këtë proces kishte edhe perspektiva e shoqërisë civile dhe mediave të shkruara dhe elektronike për sistemin e drejtësisë.

Ofrimi i rezultateve nga të gjithë mekanizmat e lartpërmendur dhe përgatitja e draftit përmbledhës me raportin analizë të vlerësimit të nevojave trajnuese për Këshillin Programor të AD-së dhe më pas për Këshillin Drejtues ishte aktiviteti i fundit në këtë proces për vlerësim të nevojave trajnuese.

Si çdo vit me radhë edhe gjatë vitit 2024, Akademia e Drejtësisë ka vazhduar përkushtimin e saj në vlerësimin e nevojave trajnuese për gjyqtarët, prokurorët si dhe stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial si target kryesor duke zbatuar mekanizmat për vlerësimin e nevojave trajnuese si në vijim:

- Formularët e vlerësimit pas secilit sesion trajnues;
- Pyetësorët për gjyqtarë dhe për prokurorë njëherë brenda vitit;
- Shkresat drejtuar KGJK-së dhe KPK-së, përkatësisht perspektiva e njësive përgjegjëse brenda këtyre këshillave;
- Takimet me gjyqtarë dhe prokurorë, kryetarë të gjykatave dhe kryeprokurorë të prokurorive;
- Takimet dhe diskutimet me trajnuesit të AD-së-së dhe veçanërisht rekomandimet për AD-në pas trajnimeve por edhe konkluzionet e përgjithshme;
- Strategjitë dhe dokumentet e miratuara nga institucionet të cilat përmbajnë rekomandime për gjyqësorin dhe sundimin e ligjit;
- Raporti i KE-së për Kosovën, Raportet e Departamentit të SHBA-ve për Kosovën, OSBE-së, IAP, Raporti mbi Monitorimin e Proceseve gjyqësore në Ballkanin Perëndimor dhe Raporti i Organizatave të shoqërisë civile që monitorojnë sundimin e ligjit;
- Agjenda legjislativë, përkatësisht risitë ligjore në fuqi për vitin 2025 si dhe
- Punëtorja për vlerësimin e nevojave trajnuese për vitin 2025.

Gjetjet nga gjitha këto burime janë shqyrtuar edhe më tej në punëtorinë për vlerësimin e nevojave trajnuese të realizuar me 25 korrik 2024 si mekanizmi i fundit dhe vendimtarë në përcaktimin e përmbajtjes së programit të trajnimeve të vazhdueshme për vitin 2025. Në këtë punëtori ishin kryetarët e gjykatave dhe kryeprokurorët e prokurorive nga të gjitha instancat e gjykatave dhe prokurorive duke përfshirë edhe nga KGJK dhe KPK si dhe partneret zhvillimor të AD-së përkatësisht OPDAT, KE, OSBE, USAID, GIZ, EULEX etj. Fokusi i kësaj punëtorie ishte diskutimi i gjetjeve nga burimet e lartë theksuara për Programin trajnues 2025 të cilët u vlerësuan si relevante për program duke ofruar perspektivën e tyre përmes punës në grupe ndërkaq nga partnerët zhvillimor edhe bashkëpunimi edhe më tej me Akademinë e Drejtësisë në zbatimin e trajnimeve.

Për Programin e trajnimit fillestar për gjyqtarët dhe prokurorët e sapo emëruar po ashtu janë realizuar dy punëtori të veçanta një për gjyqtarët e sapo emëruar dhe një për prokurorët e sapo emëruar. Si rezultat i këtyre punëtorive dhe vlerësimit të nevojave trajnuese janë rishikuar programet për dy profilet duke rishikuar sesionet trajnuese dhe metodologjinë e zbatimit të trajnimeve.

Këshilli Programor si organ profesional për cilësi ka qenë pjesë aktive e hartimit të programit trajnues si në trajnime të vazhdueshme ashtu edhe në atë fillestare. Për trajnimet e vazhdueshme bashkë me grupin e trajnuesve të caktuar nga Këshilli Drejtues bazuar në gjetjet e procesit të vlerësimit të nevojave trajnuese ka hartuar Programin Trajnues për vitin 2025. Për trajnimet fillestare ka rekomanduar trajnuesit rishikimin e moduleve sipas vlerësimit të nevojave trajnuese nga KGJK dhe KPK. Programet përkatëse të trajnimit në pajtim me Ligjin për AD-në janë dërguar për miratim në Këshillin Drejtues.

2. Identifikimi i praktikës gjyqësore të drejtë dhe vënia në dispozicion për profesionistët ligjor

Ky nën objektivi është realizuar sipas Planit të punës dhe Performancës i cili ka pasur për synim arritjen e konkluzioneve për unifikimin e praktikës gjyqësore përmes tryezave të realizuara me panalistë Në periudhën raportuese tryezat e realizuara kanë pasur karakterin e trajnimeve që për të njëjtat trajnuesit kanë hartuar raporte

me rekomandime për Akademinë dhe programet e saj dhe si të tilla nuk kanë qenë konkluzione të shqyrtuara dhe të dakorduara me pjesëmarrësi për unifikimin e praktikës gjyqësore.

3. Ofrimit të burimeve ligjore sipas kërkesave të përfituesve të AD-së;

Akademia e Drejtësisë disponon me bibliotekën ligjore elektronike e cila është në shërbim të përfituesve të saj sipas ligjit. Për të gjithë komunitetin ligjor që kanë shprehur interes për materialet ligjore që gjenden në këtë platformë i është ofruar asistencë dhe mbështetje praktike. Kërkesat për materiale ligjore edhe për vitin 2025 kanë qenë kryesisht në kategorinë e komentarëve ligjor, përmbledhjeve të praktikës gjyqësore dhe doracakëve dhe kjo më tepër nga praktikantët e gjykatave, bashkëpunëtorët profesional dhe studentet e më pak nga gjyqtarët dhe prokurorët, meqenëse gjyqtarët dhe prokurorët janë të pajisur me formatet fizike. Biblioteka ligjore e materialeve në kopje fizike ka vazhduar të mos jetë e kërkueshme.

AD ka vazhduar anëtarësimin e saj në Asociacionin e Bibliotekave Elektronike për të përfituar edhe më tej abonimin në data baza ndërkombëtare që përfituesve të saj t’iu ofrohen edhe resurse dhe burime ligjore nga rrafshi ndërkombëtarë. Si rezultat ka vazhduar qasja në data bazat e natyrës ligjore dhe të përgjithshme si në vijim:

- IOP science që ka mundësuar studiuesit të hyjnë në përmbajtje shkencore, teknike dhe mjekësore.
- Autoritetet shkencore të Oksfordit për të drejtën ndërkombëtare e cila ka përfshirë traktatet autoritative, të cilat vazhdojnë definimin e fushave të tyre të së drejtës, punimet referuese dhe komentaret e Black-letter që ndihmojnë në përgjigjen ndaj disa pyetjeve praktike të së drejtës dhe publikime të cilat ofrojnë këndvështrime inovative për problemet aktuale ligjore.
- Enciklopedia e Max Planck për të Drejtën Publike Ndërkombëtare që ka ofruar artikuj enciklopedik lidhur me më shumë se 1600 çështje ligjore ndërkombëtare, koncepte dhe raste.
- Publikimet Edward Elgar që ka ofruar e-libra dhe revista të publikuara mbi ligjin, biznesin, ekonominë dhe shkencat sociale.
- Revistat online të Cambridge që ka ofruar qasje në koleksionin multi-diciplinor mbi 330 revista të cilat mbulojnë temat mbi shkencën, teknologjinë, mjekësinë, humanizmin dhe shkencat sociale.
- OECD-iLibrary e integruar për libra, revista, punime dhe statistika
- eBiblioteka e Fondit Monetar Ndërkombëtar – që ka siguruar qasje të fuqishme dhe të përshtatshme në internet për mbledhjen e plotë të përmbajtjes autoritative ekonomike globale të publikuara nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN). Me më shumë se 11,000 botime të tekstit dhe qasje të plotë tek bazat e të dhënave statistikore të FMN-së.
- Baza Evropiane e të Dhënave të Jurisprudencës së të Drejtave të Njeriut për vendet e Evropës Juglindore. Kjo data bazë ka ofruar vendime të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, përmbledhje të çështjeve të rëndësishme për rajonin në gjuhët lokale si dhe botime tjera si manuale dhe udhëzues të praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Në periudhën raportuese AD në mbështetje të projektit të USAID-it Justice Activity in Kosovo ka siguruar edhe qasjen në platformën “Dokumente ligjore” e konsoliduar nga Rrjeti i Inovacionit për drejtësi

4. Zbatimi i veprimtarisë botuese si dhe ofrimi i tyre për përfituesit AD-së

Veprimtaria botuese se dhe e publikimit të AD-së ka qenë e orientuar në botime për nevoja të gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve ligjor në zbatimin praktik të legjislacionit në fuqi, nevoja të zbatimit të programeve trajnuese si dhe të karakterit informues apo periodike siq janë raporti, plani i punës, buletini dhe raportet nga aktivitetet trajnuese, konferencat, tryezat e punës, tryezat e diskutimeve dhe tubimet e tjera profesionale

Për aspektin e botimeve dhe veçanërisht në krijimin e burimeve të reja juridike që lehtësojnë punën e gjyqtarëve dhe profesionistëve tjerë ligjor në zbatimin praktik të legjislacionit në fuqi është punuar ngushtë me Gjykatën Supreme të Kosovës dhe KGJK-në, pa përjashtuar edhe gjyqtarët dhe prokurorët që kanë shfaqë interes në këtë fushë. Këtij procesi i ka parapri takimi i përbashkët i vlerësimit të nevojave për botime të reja dhe kryesisht në lëmine e praktikës gjyqësore për unifikimin e saj pasi janë identifikuar shkelje të shpeshta të dispozitave materiale dhe procedurale të ligjit nga gjykatat e instancave më të ulta. Nga gjetjet e praktikës gjyqësore dhe me qëllim adresimin e tyre janë zhvilluar dy botime si:

- Përmbledhje nga Praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës në çështje civile dhe penale si dhe
- Vendime të përzgjedhura të Gjykatës Supreme të Kosovës.

Të dy botimet janë përkthyer edhe në serbisht dhe janë të qasshme për gjithë gjyqtarët dhe profesionistët ligjor. Printimi e këtyre botimeve e ka mundësuar projekti Western Balkans Rule of Law Initiative (WBROLI) Chemonics.

Këto botime shërbejnë si udhërrëfyese për unifikimin e praktikës gjyqësore pasi përmbajnë praktikën gjyqësore të lëndëve të kthyer në rigjykim dhe të ndryshuara duke përfshirë edhe udhëzimet se si të veprohet në situatat e ngjashme konform dispozitave ligjore dhe gjithashtu praktikat dhe standardet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ).

Në funksion të zbatimit të Programit të Trajnimit Fillestar për 15 gjyqtarët e gjeneratës së XI dhe 32 gjyqtarët e gjeneratës së XII, janë zhvilluar dhe hartuar nga trajnerët e përkohshëm të AD se modulet trajnuese si në vijim:

- Moduli: Kodi Penal;
- Moduli: Kodi i Procedurës Penale;
- Moduli: Rendi Juridik Kombëtar dhe Ndërkombëtar;
- Moduli: Legjislacioni dhe shkathtësitë plotësuese;
- Moduli: Shkathtësitë personale dhe ndër personale;
- Moduli: E drejta civile administrative dhe ekonomike;

Në funksion të rritjes së kapaciteteve profesionale të bashkëpunëtorëve profesional të gjykatave dhe prokurorive dhe veçanërisht stafit të ri në këto pozita është rishtypë Moduli bazik në fushën penale materiale dhe procedurale si dhe Moduli bazik në fushën civile materiale dhe procedurale. AD ka rishtyp botimin përkatës në sasi prej 199 copë, prej tyre në 169 copë në gjuhën shqipe dhe 30 në gjuhën serbe dhe të njëjtat janë shpërndarë dhe vazhdojnë edhe më tej gjatë trajnimeve për këto kategori.

Për nevoja të funksionimit dhe zhvillimit të veprimtarisë së AD-së janë krijuar dhe zhvilluar botimet si në vijim:

- Raporti vjetor i punës dhe i performancës së AD-së për vitin 2023
- Programi i Trajnimit për vitin 2025
- Programi i Trajnimit Fillestar për gjyqtarët e sapo emëruar, gjenerata e XI
- Programi i Trajnimit Fillestar për gjyqtarët e sapo emëruar, gjenerata e XII
- Plani i punës dhe i performancës për vitin 2025 i AD-së
- Plani i Integritetit të AD-së për vitin 2024-2026.

5. Planifikimi institucional në zbatim të masave dhe politikave euro integruese

Edhe në periudhën raportuese Akademia e Drejtësisë ka vazhduar përkushtimin e saj në zbatimin e masave dhe kërkesave nga dokumentet strategjike në nivel nacional dhe në përgatitjen e raporteve në baza periodike për Strategjinë për sundimin e Ligjit, Strategjinë për mbrojtjen nga dhuna në familje, Programin Kombëtar për të

Drejtat e njeriut dhe dokumente tjera strategjike në nivel nacional të cilat janë si rrjedhojë e MSA-së dhe raportit të BE-së për Kosovën. Në vazhdimësi janë hartuar raportet në baza të rregullta për institucionet dhe mekanizmat përkatës për çka nga raportet e ndryshme veçanërisht të strategjive të lartpërmendura të cilat Akademinë e Drejtësisë për kundër kapaciteteve të limituara qoftë njerëzore ashtu edhe financiare e vendosin në institucionet më të përgjegjshme si në zbatim ashtu edhe në raportimin e masave.

Raporti i fundit i përgatitur nga Sekretariati i Strategjisë për Sundimin e Ligjit dhe i ndarë me institucionet përgjegjëse, AD e rendit në listën e institucioneve të përgjegjshme karshi zbatimit të aktiviteteve dhe masave që parasheh kjo strategji. Prej 48 masave që përfshijnë aktivitete trajnuese, hartim të kurrikulave trajnuese dhe aktivitete tjera, përqindja e zbatimit të plotë është 65%, përqindja e aktiviteteve në zbatim e sipër 23 % dhe përqindja e aktiviteteve të pa zbatuara 13 %..

Raporti i Strategjisë për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhunës ndaj grave po ashtu AD-në e rendit në listën e institucioneve me performancën më të mirë. Nga 6 masa që parashihej zhvillim i kurrikulave trajnuese konform standardeve të Konventës së Stambollit dhe ofrimit të trajnimeve për gjyqtarët, prokurorët dhe profesionistët e tjerë ligjor janë përmbushur të gjitha.

Masat dhe kërkesat nga dokumentet strategjike	Numri i Aktivitetve	% e zbatimit të plotë	% e aktiviteteve në zbatim e sipër	% aktiviteteve të pa zbatuara
Strategjia për sundimin e ligjit	48	65%	23%	31%
Strategjia për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhunës ndaj grave	6	6	0	0

Tabelë nr. 16: Masat dhe kërkesat nga dokumentet strategjike

Programi Kombëtar për të Drejtat e Njeriut e bënë përgjegjëse Akademinë e Drejtësisë në shtatë (7) masa të cilat po ashtu kërkojnë zhvillim të kurrikulave trajnuese për gjyqtarë dhe prokurorë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në pajtim me standardet evropiane. Masat nga ky program për aspektin e dhunës në familje dhe procedurën e kryesve me çrregullime mendore është e ngjashme me Strategjinë e dhunës në familje ndërkaq përfshinë edhe ngritjen e kapaciteteve të gjyqtarëve dhe prokurorëve edhe për trajtimin e rasteve që kanë të bëjnë me lirinë e shprehjes, gjuhën e urrejtjes, lirinë e medias, për sinjalizimin e gazetarëve, ngacmimin seksual veçanërisht pas ndryshimeve dhe plotësimeve të Kodit Penal. Edhe për kërkesat që dalin nga ky dokument AD ka realizuar një mori aktivitete trajnuese për të cilat kanë përfituar gjyqtarë, prokurorë dhe profesionistë tjerë ligjor.

Plani Kombëtar për Integrim Evropian dhe Agjenda Evropiane (ERA) kërkon rritje të kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve në trajtimin e rasteve që kanë të bëjnë me hetimet financiare, pastrimin e parave, konfiskimin dhe sekuestrimin. Në këtë kuadër jo vetëm si kërkesë e këtij mekanizmi por edhe vet gjyqtarëve dhe prokurorëve janë realizuar 10 aktivitete trajnuese në të cilat kanë përfituar gjyqtarë e prokurorë dhe jo vetëm.

Masat dhe kërkesat nga dokumentet tjera strategjike	
Aktivitetet në përmbushje të Programit Kombëtarë për të Drejtat e Njeriut-2024	
Trajnime	Numri
Trajnime për procedurën e kryesve me çrregullime mendore	1
Trajnime vetëm për gjyqtarë e prokurorë për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhunës ndaj grave	7
Trajnime me fokus në mbrojtjen e të dhënave personale dhe themelore, lirinë e shprehjes, antigjipsizmin, sinjalizimin e gazetarëve si dhe për barazinë gjinore	8
Trajnimeve në fushën e të drejtave të njeriut, veçanërisht me theks të veçantë për praktikën dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së	5

PKIE & Agjenda Evropiane (ERA)-2024	
Trajnime	Numri
Trajnime për konfiskimin dhe sekuestrimin	5
Trajnime për hetime financiare, rikuperim të asetëve dhe pastrimin e parave	5

Tabelë nr. 17: Masat dhe kërkesat nga dokumentet tjera strategjike

Përveç mekanizmave të lartpërmendur në mënyrë indirekte përmes KGJK-së dhe KPK-së është kontribuar edhe për mekanizma tjerë dhe strategji tjera si Ekstremizmin dhe radikalizmin, për Trafikimin me qenje njerëzore etj. Akademia e Drejtësisë ka vazhduar edhe më tej bashkëpunimin me KGJK dhe KPK dhe komisionet për shqyrtimin e performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve që veprojnë në kuadër të dy këshillave duke i ofruar të dhëna mbi vijueshmërinë e gjyqtarëve dhe prokurorëve në trajnime të cilat kanë qenë të nevojshme për vlerësimin e tyre, përfaqësimin në konferenca, takime dhe forma tjera që tregojnë ngritjen dhe avancimin profesional të tyre përmes trajnimeve të AD-së.

6. Analiza dhe mbledhja e të dhënave për vlerësimin e performancës së trajnuesve në zbatimin e trajnimeve fillestare dhe të vazhdueshme gjatë vitit 2024

Në periudhën raportuese në pajtim me Rregulloren Nr. 02/2019 për Trajnues dhe Mentorët e AD-së si dhe rregullores Nr. 01/2023 për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores nr. 02/2019 është punuar në mbledhjen dhe analizën e të dhënave për trajnuesit e caktuar nga Këshilli Drejtues për zbatimin e trajnimeve sipas programit të trajnimeve fillestare dhe të vazhdueshme. Bazuar në kriteret dhe indikatorët e rregullores përkatëse janë mbledhë gjitha të dhënat sa i përket kontributit të trajnuesve në hartimin e planit dhe programit vjetor të trajnimit, përgatitjet paraprake sa i përket materialeve trajnuese dhe dokumenteve tjera përcjellëse si dhe me rastin e zbatimit të trajnimeve edhe vlerësimet e tyre nga pjesëmarrësit dhe stafi.

Nga gjetjet e data bazës SMAT dhe burimeve tjera brenda AD-së, përkatësisht nga kuadri ligjor përgjegjës kanë rezultuar që nga lista e trajnuesve prej 142 sa janë gjithsejtë përfshirë edhe dy trajnuesit e përhershëm të AD-së gjatë vitit 2024 janë angazhuar 79 trajnues të cilët kryesisht ishin nga radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe më pak nga profesionistët e tjerë ligjor.

Për 79 trajnuesit është përgatitur raporti i performancës dhe sipas indikatorëve dhe kriterëve të rregullores është bërë vlerësimi i performancës fillimisht nga Këshilli Programor dhe më pastaj edhe nga Këshillin Drejtues.

6.5 AVANCIMI I MËTEJMË I METODOLOGJISË TRAJNUESE

Edhe gjatë vitit 2024, AD është kujdesur për rritjen e kapaciteteve trajnuese, shkathtësive dhe metodologjisë trajnuese për trajnuesit e saj dhe veçanërisht për trajnuesit e rinj të rekrutuar së fundmi. Gjatë kësaj periudhe në mbështetj të donatorëve janë realizuar në total 7 (shtatë) trajnime të trajnuesve. Prej tyre 1 (një) në fushën e drejtësisë për fëmijë, 1 (një) në fushën e të drejtave të njeriut, përkatësisht për nenin 10 të KEDNJ, 1 (një) në fushën e diskriminimit dhe 4 (katër) trajnime lidhur me metodologjinë trajnuese të bazuara në Doracakun për trajnues. Akademia gjatë vitit 2024 ka pasur edhe një proces rekrutimi të trajnuesve me qëllim të mbulimit të gjitha fushave të nevojshme për zbatimin e programit trajnues. Trajnuesit e rinj i janë nënshtruar trajnimit për trajnues me qëllim të zbatimit të metodologjisë trajnuese e cila kërkon aftësitë komunikuese dhe ndërvepruese me pjesëmarrësit, përdorimin efektiv të mjeteve dhe teknologjisë në procesin e trajnimit si dhe përforcimin e njohurive në fushën e specializimit të tyre. Pavarësisht disa sfidave programi ka dhënë rezultat të mira dhe ka hapur rrugën për përmirësimin e mëtejshëm edhe në vitin e ardhshëm. Për detaje tabela në vijim me ditët e trajnimit dhe numrin e pjesëmarrësve.

Trajnimi i Trajnuesve -2024			
Fusha e trajnimit	Nr. i trajnimeve	Ditë trajnimi	Nr. i të trajnuarve
Metodologjia e sipas Doracakut për Trajnues të AD-së	4	8	88
Neni 10 i KEDNJ	1	2	12
Standardet ndërkombëtare dhe evropiane për të drejtat e fëmijëve dhe drejtësinë për të mitur, teknikat e intervistimit, perspektiva gjinore dhe komunikimi miqësor me fëmijët gjatë proceseve gjyqësore	1	3	9
Trajtimi i rasteve të femicidit	1	1	5
Totali	7	14	114

Tabelë nr. 18: Trajnimet për Trajnues sipas temave dhe pjesëmarrjes

6.6 BASHKËPUNIMI DHE KOORDINIMI ME PARTNERËT VENDOR, PARTNERËT NDËRKOMBËTARË, DONATORËT DHE INSTITUCIONET RELEVANTE TRAJNUESE NDËRKOMBËTARE.

Në periudhën raportuese Akademia e Drejtësisë është angazhuar në bashkëpunimin me partnerët vendor dhe ndërkombëtarë të cilët i kanë kontribuar funksionimit dhe zbatimit më të mirë të mandatit të saj me ligj. Në këtë vështrim ka përcjellë zhvillimet në sistemin gjyqësor dhe prokurorial dhe ka adresuar gjitha kërkesat që dalin nga këto institucione. Ka mbajtur takime të rregullta me të gjithë krerët e sistemit gjyqësor dhe prokurorial dhe partnerët tjerë strategjik me ç'rast nga ky bashkëpunim ka përfituar mbështetje në realizim të trajnimeve, punëtorive dhe tryezave të shumta si dhe pjesëmarrje në konferenca dhe forume të ndryshme ndërkombëtare.

Në vijim për secilën nga këto bashkëpunime jepen detaje të hollësishme për numrin e aktiviteteve dhe të dhëna tjera të rëndësishme.

1. Bashkëpunimi dhe koordinimi me KGJK dhe KPK si dhe me Gjykatat dhe Prokuroritë e Kosovës

Viti 2024 veçohet për një dinamikë të shtuar veçmas me procesin e rekrutimit të grupeve të reja të gjyqtarëve, prokurorëve dhe bashkëpunëtorëve të rinj profesional, me lëvizje të gjyqtarëve dhe prokurorëve nga një nivel në tjetrin të cilat pa dyshim kanë paur impakt në punën e AD-së dhe në programet e saj. Në funksion të hartimit dhe zbatimit më të mirë të programeve trajnuese, AD ka bashkëpunuar ngushtë me KGJK dhe KPK, kuadrin e saj ligjor mbrenda AD-së, përfshirë Kryetarët e Gjykatave dhe Kryeprokurorët e Prokurorive dhe ka ndërmarrë gjitha masat për të përmbushë kërkesat për trajnime që kanë institucionet përkatëse. Me Gjykatën Supreme edhe në fushën e botimeve veçanërisht në botimin e dy përmbledhjeve të praktikës gjyqësore të cilat u shpërndanë për gjithë gjyqtarë në kuadrin e ditëve të gjyqësorit. Edhe këtë vit ka vazhduar bashkëpunimi dhe koordinimi për vijueshmërinë në trajnime dhe për çështje tjera që janë në interes të përbashkët.

2. Bashkëpunimi dhe koordinimi me institucionet e tjera të sistemit të drejtësisë

Në periudhën raportuese Akademia e Drejtësisë ka qenë pjesë e grupeve punuese të themeluara nga MD për kompletimin e akteve nënligjore ashtu edhe për planifikimet dhe zbatueshmërinë e masave të Strategjisë për sundimin e ligjit dhe Strategjisë për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhunës ndaj grave. Gjithashtu ka arritur marrëveshje bashkëpunimi me MD dhe Odën e Ndërmjetësuesve për ofrimin e trajnimeve të vazhdueshme për ndërmjetësuesit e licencuar. Përveç me MD ka bashkëpunuar edhe me institucionet tjera të sistemit të drejtësisë për zbatimin e trajnimeve praktike të gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapo emëruar dhe atë me Gjykatën Kushtetuese, Avokatin e Popullit, Policinë e Kosovës, Shërbimin Sprovues, Shërbimin Korrektues, Doganën e Kosovës, Agjencinë për Informim dhe Privatësi dhe

Institucionin e Mjekësisë Ligjore. Po ashtu edhe me Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit veçmas për Planin e integritetit dhe kërkesave tjera të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit si dhe me institucione tjera varësisht prej programeve dhe përfituesve të trajnimeve.

BASHKËPUNIMI ME PARTNERËT NDËRKOMBËTARË NË ZBATIMIN E TRAJNIMEVE DHE AKTIVITETEVE TJERA

Edhe këtë vit, Akademia e Drejtësisë ka vazhduar bashkëpunimin me dhe projektet ndërkombëtare si AIRE CENTRE, EIPA, INL, WBROLI, projektet tjera të Ambasadës Amerikane dhe Franceze si dhe me projektet e Zyrës së Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës. Ky bashkëpunim ka mundësuar zhvillimin e kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve, prokurorëve dhe institucioneve të drejtësisë në Kosovë, duke ofruar seminare dhe trajnime për çështje të ndryshme ligjore që janë sfiduese për praktikën gjyqësore dhe janë si në vijim:

1. Aktivitetet e realizuara me Departamentin e Drejtësisë së SHBA-së, OPDAT dhe Ambasadën Amerikane

Gjatë vitit 2024, si rezultat i bashkëpunimit me Departamentin Amerikan të Drejtësisë/OPDAT, dhe Ambasadën Amerikane janë realizuar njëzetë e gjashtë (26) aktivitete trajnuese. Këto aktivitete trajnuese ishin në fushën e ndërmjetësisë, në rastet e dhunës në familje, për menaxhimin e lëndëve penale dhe menaxhimin e prokurorisë, për pastrimin e parave dhe hetimit financiar, institute të veçanta si dëshmitarët e mbrojtur, gjykimi në mungesë, për krimin kibernetikë dhe kriptovalutat, politikën ndëshkimore, për përpilimin e aktakuzave, arsyetimit dhe vlerësimit të provave, strategjitë dhe masat e veçanta hetimore si dhe për prokurimin publik. Për disa nga aktivitetet përkatëse kanë ofruar përveç tjerash edhe ekspertizë duke sjellë praktikantë më të mira ndërkombëtare. Përveç aktiviteteve trajnuese stafin menaxhues të AD-në e ka mbështetur edhe me vizitën në SHBA-përkatësisht në Kartolinën e Jugut për të rritur kapacitetet në vlerësimin e programeve dhe trajnuesve.

2. Aktivitetet e realizuara me Ambasadën Franceze

Në sajë të bashkëpunimit me Ambasadën Franceze janë realizuar dy (2) trajnime shumë specifike. Trajnimi i parë për dhunën në familje me ç'rast është ofruar perspektiva e juridiksionit francez në trajtimin e këtyre rasteve. Trajnimi i dytë për Treguesit Gjeografikë dhe Emërtimet e Origjinës pjesë e të Drejtave Pronësore Intelktuale dhe në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe ekonomisë lokale Të dy trajnimet janë dedikuar gjyqtarëve dhe prokurorëve me qëllim të interpretimit dhe zbatimit të drejtë të legjislacionit në fuqi si dhe vendosjes meritorë të rasteve të dhunës në familje dhe trafikimit me pasuritë kulturore ku bizneset, përkatësisht kryesisht përfitojnë nga ky aktivitet kriminal.

3. Aktivitetet e realizuara me Projektin për Drejtësi Komerciale të mbështetura nga USAID

Si rezultat i bashkëpunimit me Projektin për Drejtësi Komerciale janë realizuar katërmëdhjetë (14) aktivitete trajnuese të cilat ishin të fokusuar në procedurën e ndërmjetësisë dhe në çështjet që janë kompetencë e punës së gjyqtarëve në çështjet komerciale dhe atë për Ligjin për shoqëritë tregtare, për industrinë bankare, rregullativën ligjore të UE-së mbi çështjet komerciale dhe doganore, arbitrazhin dhe çështje tjera specifike nga juridiksioni i kësaj gjykate. Për drejtësinë komerciale janë realizuar nëntë (9) trajnime dhe pesë (5) për referimin e lëndëve në procedurën e ndërmjetësisë të cilat ishin regjionale dhe ndërmjetësimi komercial si mekanizëm alternativ për zgjidhjen e kontesteve.

4. Aktivitetet e realizuara me zyrën e Bashkimit Evropian dhe projektet e saj

Me projektin EUKOJUST është realizuar një (1) aktivitet trajnues në çështje interdisiplinare me temë: Trajnim për Përdorimin e Koncepteve dhe Terminologjisë Ligjore në përgjithësi, për përkthyesit e KPK-së

dhe MD-së. Në mbështetje të Bashkimit Evropian është realizuar edhe një (1) trajnim në fushën administrative me theks te procedura në çështje administrative në kuadër të cilit kanë ofruar edhe ekspertizën nga jashtë duke mundësuar njohjen me praktikën e vendeve të BE-së në këtë fushë.

5. Aktivitetet e realizuara me zyrën e Këshillit të Evropës dhe projektet e saj

Projekte e Këshillit të Evropës veçohen me mbështetjen e tyre sidomos për aspektin e të drejtave të njeriut dhe jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë. Në sajë të bashkëpunimit me zyrën e Këshillit të Evropës janë realizuar gjithsejtë dymbëdhjetë (12) aktivitete trajnuese për gjyqtarë, prokurorë dhe profesionistë tjerë ligjor. Prej tyre gjashtë (6) aktivitete trajnuese ishin të orientuara në ofrimin e praktikës së GJEDNJ-së për çështje të ndryshme ligjore me fokus te qasja në mjete juridike efektive dhe zbatimin të nenit 5 dhe 6 të KEDNJ-së.

Me projektin: Përforcimi i luftës kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje - Faza e II janë realizuar aktivitete trajnuese për rastet e dhunës në familje të cilat ishin të fokusuar për përgjigjen efektive të drejtësisë penale dhe asaj civile me qasje të përqendruar tek viktimat e dhunës në familje, ndjekja penale dhe gjykimet e informuara mbi traumën.

Me PECK III është realizuar një trajnim për Ngrirjen, konfiskimin dhe menaxhimin e aseteve virtuale në rastet e pastrimit të parave si dhe projektin PRO-FREX-K- trajnimi: Liria e shprehjes dhe Mbrojtja gjyqësore në rastet e cenimit të lirisë së shprehjes – Trajnim i Specializuar për Paditë Strategjike Kundër Pjesëmarrjes Publike (SLAPPs).

6. Aktivitetet e realizuara me projektin Iniciativa për Sundim të Ligjit në Ballkanin Perëndimor (WBROLI), financuar nga Mbretëria e Bashkuar

Në bashkëpunim me projektin WBROLI janë realizuar nëntë (9) aktivitete trajnuese. Prej tyre tri (3) për gjyqtarë dhe prokurorë në fushën e krimeve të rënda dhe të korrupsionit, si dhe gjashtë (6) për bashkëpunëtorë profesional me theks e trajtimi i dëshmitarëve, kompletimit të përfaqësimit në gjykatë, për ngrirjen e aseteve dhe konfiskimin, pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit si dhe për krimet e reja financiare.

7. Aktivitetet e realizuara me OSBE-në

Në mbështetje të OSBE-së janë realizuar katër (4) aktivitete trajnuese, në të cilat kanë përfituar gjyqtarë, prokurorë si dhe profesionistë tjerë ligjor nga sistemi gjyqësor dhe prokurorial. Fushat në të cilat janë përqendruar aktivitetet përkatëse ishin për unifikimin e legjislacionit penal me atë të vendeve të U-së me theks te Bashkëpunimi gjyqësor në çështje penale, për procedurën penale të kryesve me çrregullime mendore për kontestet gjyqësore nga baza e trashëgimisë dhe për mbrojtjen gjyqësore të fëmijëve në procedurën kontestimore dhe jokoontestimore.

8. Aktivitetet e realizuara me GIZ

Në mbështetje të GIZ janë realizuar gjashtëmbëdhjetë (16) aktivitete trajnuese të cilat i janë dedikuar gjyqtarëve, prokurorëve dhe bashkëpunëtorëve profesional të gjykatave dhe prokurorive. Në kuadër të këtyre aktiviteteve trajnuese janë trajtuar aspekte të rëndësishme në çështjet arbitrazhit, bashkëpunimit juridik ndërkombëtarë në çështje komerciale dhe civile, aspekte të rëndësishme të drejtësisë për të mirur, përkatësisht për masat dhe dënimet, për mbrojtjen e të dhënave personale si dhe çështje tjera ligjore materiale dhe procedurale nga moduli bazik për bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor. Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte avancimi i njohurive të përfituesve sipas ligjit që përmes diskutimeve dhe prezantimit të praktikave më të mira, të ngriten kapacitetet profesionale të gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve tjerë ligjor për zgjidhjen e drejtë të rasteve ligjore përkatëse.

9. [Aktivitetet me IRZ \(German Foundation for International Legal Cooperation\)](#)

Në mbështetje të kësaj organizate është realizuar trajnimi me temë: Ndhma dhe bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështjet civile. Gjyqtarët pjesëmarrës patën mundësinë e njohjes me procedurat për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në fushën civile për kërkesat që burojnë nga Kosova, apo nga shtetet e huaja, rolin e gjykatave dhe të Departamentit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në këtë procedurë, si dhe juridiksioni në bazë të Ligjit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Civile.

10. [Aktivitetet e realizuara me UNDP/SAEK](#)

Në mbështetje të UNDP dhe SAEK janë realizuar dy (2) aktivitete trajnuese për rritje të kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bashkëpunëtorëve profesional dhe zyrtarëve ligjor në çështjet e hetimit financiar dhe rikuperimit të aseteve dhe gjykimin e tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi.

11. [Aktivitetet e realizuara me UNHCR-Zyra e Misionit në Kosovë](#)

Gjatë vitit 2024 në sajë të bashkëpunimit të vazhdueshëm me UNCHR, janë realizuar dy (2) trajnime për gjyqtarët e departamentet administrativ në fushën e azilit me theks te Praktikat gjyqësore në vend dhe Evropë në fushën e Mbrojtjes Ndërkombëtare të Refugjatëve si dhe për Arsyetimin e vendimeve gjyqësore në procedurën e konfliktit administrativ

Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte rritja e aftësive të gjyqtarëve në zbatimin e legjislacionit vendor në përputhje me parimet e së drejtës ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të azilkërkuësve, refugjateve dhe në përpilimin dhe arsyetimin e vendimeve gjyqësore.

12. [Aktivitetet e realizuara me EULEX](#)

Në periudhën raportuese, AD në bashkëpunim me EULEX ka realizuar njëmbëdhjetë (11) aktivitete trajnuese. Prej tyre një(1) trajnim ishte për gjyqtarë dhe prokurorë për drejtësinë përballë mbrojtjes së të dhënave personale dhe qasjes në dokumente publike. Ndërkaq dhjetë (10) trajnime ishin të dedikuara për bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor nga moduli bazik -aspekti material dhe procedura në çështje penale dhe civile.

13. [Aktivitetet e realizuara me Humanitarian Law Center](#)

Krimet e luftës kanë vazhduar të jenë pjesë integrale e programit trajnues për shkak të specifikave të këtyre veprave dhe mungesës së përvojës në trajtimin e këtyre rasteve. Në mbështetje të këtij institucioni është realizuar një (1) aktivitetet trajnues në të cilin kanë përfituar veçanërisht gjyqtarët nga departamenti special dhe prokurorët e PRSK-së.

14. [Aktivitetet e realizuara me CLARD –Qendra për Ndhmë Juridike dhe Zhvillim Regjional](#)

Në periudhën raportuese AD në bashkëpunim me CLARD ka realizuar një (1) aktivitet trajnues në fushë e dhunës në familje me temë: Trajnim i avancuar për parandalimin e dhunës në familje- Konventa e Stambollit. Nga ky trajnim kanë përfituar avokatë, zyrtarë të ndihmës juridike falas si dhe zyrtarë policor.

15. [Aktivitetet e realizuara me EIPA](#)

Në mbështetjen e EIPA është realizur një trajnim i përbashkët online i AD-së dhe Akademisë për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë ‘Pavel Shatev’ të Maqedonisë së Veriut. Trajnimi ishte me temë: “Mbrojtja e të drejtave të njeriut në Evropë” me ç’rast gjyqtarët dhe prokurorët pjesëmarrës të dy vendeve patën mundësinë e njohjes së rëndësisë së të drejtave të njeriut dhe atyre themelore për procesin e integritimit në BE dhe në sistemin juridik të BE-së dhe mekanizmave për kontrollimin dhe rishikimin e ligjshmërisë së

politikave dhe instrumenteve të BE-së karshi individëve, të ushtruara nga BE-ja ose tërthorazi nga shtetet anëtare.

16. Aktivitetet e realizuara me Qendrën Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës - KRCT

Në mbështetjen e kësaj qendre janë realizuar dy (2) aktivitete trajnuese me temë: Trajtimi i të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë gjatë qasjes në drejtësi si dhe Veprat penale kundër integritetit seksual, ndjeshmëria e aspekteve psikologjike gjatë trajtimit të fëmijëve – viktima të dhunës seksuale. Nga këto trajnime kanë përfituar gjyqtarë, prokurorë dhe profesionistë tjetër ligjor.

17. Aktivitetet me Sekretariatit e Regional Anti-Corruption Initiative (RAI)

Në mbështetjen e kësaj organizate janë realizuar dy (2) aktivitete trajnuese me temë: Mbrojtja e interesave të të tretëve dhe të kreditorëve gjatë procesit të konfiskimit pasuror për garantimin e të drejtave reale e atyre të pronësisë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe garantimin dhe Kompetencat e gjyqtarit gjatë procedurës së sekuestrimit dhe konfiskimit pasuror dhe kushtet kur mund të vendoset konfiskim. Nga këto trajnime kanë përfituar gjyqtarë, prokurorë dhe profesionistë tjetër ligjor që kanë kompetencë për rastet përkatëse.

18. Aktivitetet me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Huluntuose (BIRN)

Në sajë të bashkëpunimit me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Huluntuose (BIRN) është realizuar trajnimi me temë: Terrorizmi dhe Ekstremizmi i Dhunshëm. Këtë trajnim e kanë vijuar kryesisht gjyqtarët dhe prokurorët që kanë për kompetencë krimet e rënda dhe nga departamenti special i gjykatave dhe nga PRSK.

19. Aktivitetet me Tier im Recht (TIR; Fondacioni për Kafshët në Ligi)

Në sajë të bashkëpunimit me Tier im Recht është realizuar trajnimi me temë: Trajnim për institucionet ligj zbatuese rreth abuzimit ndaj kafshëve dhe ndërlidhjes me dhunën në familje. Ky trajnim ishte shumë specifik dhe i veçantë dhe sidomos praktika e vendeve jera në rajon në rastet përkatëse.

20. Aktivitetet me United Nations Office on Drugs and Crime – UNODC

Në mbështetjen e kësaj organizate janë realizuar dy (2) aktivitete trajnuese me temë: Gjykimi i rasteve me armë të zjarrit, Vështrim i kërcënimeve të reja dhe kompleksitetet ligjore si dhe Praktika gjyqësore për veprat me armë zjarri, drogë dhe krimin e organizuar. Qëllimi i këtyre aktiviteteve trajnuese ishte ngritja e kapaciteteve profesionale për gjykimin e drejtë të rasteve me armë zjarri dhe vendosja meritore e rasteve përkatëse.

21. Aktivitetet me Terres d'ers Home

Në mbështetjen e kësaj organizate janë realizuar tri (3) aktivitete trajnuese me temë: Antigjipsizmi Qëllimi i këtyre aktiviteteve trajnuese ishte ngritja e kapaciteteve profesionale për antigjipsizimin dhe gjykimin e drejtë të rasteve në gjykata.

Programet praktike dhe shkëmbimi i përvojave me vendet ne rajon

1. Programi praktik për kandidatet e Shkollës së Magjistraturës së Francës në institucionet gjyqësore në Kosovë

Edhe gjatë vitit 2024 ka vazhduar programi praktik me kandidatë të Shkollës së Magjistraturës së Francës në institucionet gjyqësore në Kosovë. Në vazhden e bashkëpunimit me këtë institucion dhe përmes

Ambasadës Franceze në Kosovë nga data 20 shkurt deri me 08 mars 2024 për dy kandidate për gjyqtare nga kjo shkollë është organizuar programi praktik tre javor në institucionet gjyqësore në Kosovë. Kandidatet për gjyqtare gjatë programit praktik patën mundësinë e njohjes me funksionimin e AD-së dhe njëherit njohjen për së afërmi me trajnimin fillestar. Në vijim të këtij programi praktik ato kanë vizituar disa nga Gjykatat dhe Prokuroritë e Kosovës

2. Aktivitetet me Rrjetin Evropian të Trajnimit Gjyqësor (EJTN)

Akademia e Drejtësisë ka vazhduar të bashkëpunoj me Rrjetin Evropian të Trajnimit gjyqësor si dhe me Akademinë e së Drejtës Evropiane për të lehtësuar pjesëmarrjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve nga Kosova në institucionet trajnuese përkatëse.

Nga viti 2024, Akademia e Drejtësisë është bërë zyrtarisht pjesë e Programit të Drejtësisë së Komisionit Evropian. Këtij procesi i ka paraprirë pjesëmarrja e Drejtorit Ekzekutiv të AD-së në Asamblenë e Përgjithshme, të organizuar nga EJNT në Belgjikë, Bruksel. Përmes kësaj është shënuar një hap i rëndësishëm në forcimin e sistemit të drejtësisë dhe bashkëpunimin ndërkombëtar. Gjithashtu mundësi e re për zhvillimin e trajnimit gjyqësor dhe avancimit të njohurive dhe praktikave ligjore të gjyqtarëve dhe prokurorëve në nivel evropian.

Në periudhën raportuese në kuadër të programit të shkëmbimit me EJTN janë realizuar disa programe në të cilat kanë marrë pjesë Kryetarët të Gjykatave dhe Prokurorë nga Kosova. Një nga kryetarët e Gjykatave Themelore të Kosovës ka marrë pjesë në vizitën studimore në Gjykatën Lokale të Dortmundit në Gjermani. Në kuadër të kësaj vizite është njoftuar me funksionimin elektronik të dosjeve dhe praktikat në aspektin e menaxhimit dhe administrimit të gjykatës. Përveç kësaj ka pasur mundësinë e vizitave edhe të gjykatave tjera në rajon dhe Qendrës së Ndalimit dhe Stacionin Policor në Dortmund. Në seminarin Konferencë për Leadership Personal për Udhëheqësit Gjyqësorë si dhe Komunikimi për udhëheqësit e Gjyqësorit ka marrë pjesë po ashtu nga Kosova një Kryetar i Gjykatës Themelore dhe në seminarin e fundit bashkë edhe me një prokurorë nga niveli themelor.

3. Aktivitetet me Akademinë Evropiane të Drejtësisë ERA

Në kuadër të aktiviteteve të Akademisë së Drejtës Evropiane (ERA) me qendër në Trier të Gjermanisë kanë marrë pjesë 2 prokurorë dhe 3 gjyqtarë dhe kryesisht në trajnimet që kishin në fokus Ligjin kundër diskriminimit dhe Ligjin e BE-së për barazi gjinore.

4. Projekti JUSTITIA - Rritja e Ekspertizës Gjyqësore për Balancimin e të Drejtave të Njeriut dhe Sigurisë

Në mars 2024, Ministria Franceze e Drejtësisë dhe Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (UNODC), në kuadër të Projektit Justitia, ka organizuar vizitë studimore për gjyqtarë nga Ballkani Perëndimor në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) dhe në institucionet gjyqësore Franceze në Strasburg. Pjesëmarrës nga Kosova ishte Drejtori i AD-së bashkë me tre gjyqtarë nga Gjykata Supreme e Kosovës. Qëllimi i kësaj vizite ishte ndërveprimi i drejtpërdrejtë me zyrtarët e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe diskutimi i praktikave më të mira të kësaj gjykate, veçanërisht në rastet komplekse të lidhura me sigurinë.

5. Vizitë studimore e delegacionit nga Akademia e Drejtësisë dhe Këshillit Prokurorial të Republikës së Kosovës në Karolinën e Jugut

Në prill të vitit 2024, në mbështetje të Ambasadës Amerikane, përkatësisht zyrës së OPDAT, për udhëheqësit e programeve të AD-së dhe për përfaqësues të KPK-së është realizuar një vizitë studimore në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, përkatësisht në Qendrën Kombëtare të Avokimit në Kolumbia dhe në

Charleston të Karolinës së Jugut. Delegacioni në përbërje të AD-së dhe Këshillit Prokurorial, përfshirë edhe Kryetarin e Gjykatës Supreme kanë pasur mundësinë e informimit mbi aktivitetet trajnuese të Departamentit të Drejtësisë në Qendrën Kombëtare të Avokimit (NAC) në Kolumbia dhe roli i saj në arsimimin ligjor të prokurorëve federal dhe stafit mbështetës të prokurorisë. Vëmendje të veçantë kishin teknikat e vlerësimit, procesi i vlerësimit të nevojave trajnuese dhe vlerësimi i performancës së trajnuesve.

Përveq trajnimit në Qendrën Kombëtare të Avokimit, delegacionit nga Kosova iu mundësua edhe vizita në Kampusin Universitar, përkatësisht në Fakultetin Juridik të Kolumbias duke përfshirë vizita në Gjykatën Supreme dhe Prokurorinë Federale si dhe pjesëmarrjes në një seancë gjyqësore që kishte të bënte me një rast të shitblerjes dhe shpërndarjes së substancave narkotike

Delegacioni ishte në përbërje prej Drejtorit Ekzekutiv dhe 5 zyrtarëve tjerë të AD-së, Kryetarit të Gjykatës Supreme, U.D Kryeprokurorit të Shtetit dhe 5 prokurorëve si dhe 1 zyrtarë nga Këshilli Prokurorial dhe 3 zyrtarë, specialist ligjor nga Ambasada Amerikane.

6. Programi ndërkombëtar i trajnimit për çështjet bashkëkohore për të drejtat e njeriut

Me datë 22-24 maj 2024, në bashkëpunim me Akademinë e Drejtësisë, në Shkup të Maqedonisë së Veriut është realizuar "Programi Ndërkombëtar i Trajnimit për Çështjet Bashkëkohore në Ligjin për të Drejtat e Njeriut". Qëllimi i këtij programi ishte për të krijuar një mjedis produktiv dhe për të shkëmbyer njohuri dhe aftësi në gjykimin e rasteve që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut dhe për të krijuar fusha të reja të bashkëpunimit me çështjet e rajonit. Ky program ishte i karakterit garues në të cilën morën pjesë tre gjyqtarë nga Programi për Trajnim Fillestar.

7. Konferencë Ndërkombëtare në Bashkëpunimin Ligjor Ndërkombëtar në Çështje Kriminale dhe Krim Kibernetikë

Në maj të vitit 2024, në Ankara të Turqisë me ftesë të projektit Octopus, CyberKop action dhe Zyrës së KE-së në Ankara, Drejtori Ekzekutiv i Akademisë së Drejtësisë së bashku me Udhëheqësen e PTV-së dhe dy prokuror nga Prokuroria Speciale kanë marrë pjesë në Konferencën Ndërkombëtare për Bashkëpunimin Ligjor Ndërkombëtar në Çështje Kriminale dhe Krim Kibernetik. Pjesë të kësaj konference kanë qenë edhe zyrtar nga Ministria e Drejtësisë, Departamenti për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar si dhe Zyrtar nga Policia e Kosovës, njësia për Krim Kibernetik. Qëllimi i kësaj konference ishin sfidat dhe praktikat më të mira në lidhje me bashkëpunimin ndërkombëtar në çështjet penale si dhe avancimi i bashkëpunimit në fushën e trajnimit dhe shkëmbimit të përvojave në fushën e drejtësisë dhe bashkëpunimit ndërkombëtar.

8. Seminar ndërkombëtar “Përkujdesja ndaj të miturve të pashoqëruar që kryejnë vepra penale brenda një rrjeti kriminal të organizuar”

Si rezultat i bashkëpunimit me shkollën e Magjistraturës së Francës, respektivisht përmes projektit JUST CHILD, dhe me ftesë të Programit Evropian për Drejtësi, me 19 dhe 21 qershor 2024, dy gjyqtar dhe dy prokurorë nga Kosova të shoqëruar nga një përfaqësues i AD-së kanë marrë pjesë në seminarin ndërkombëtarë me temën: “Përkujdesja ndaj të miturve të pashoqëruar që kryejnë vepra penale brenda një rrjeti kriminal të organizuar”.

Qëllimi i këtij seminari ishte të sigurojë efektivitetin e drejtësisë miqësorë për fëmijë, në përputhje me direktivat evropiane që janë pjesë e strategjisë së Bashkimit Evropian për të drejtat e fëmijëve. Duke ju kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve, përkatësisht të miturve të pashoqëruar, të cilët janë objektivi kryesor i rrjeteve të krimit të organizuar dhe trafikimit të qenieve njerëzore.

9. Konferenca Vjetore e Rrjetit Evropian për Edukim në të Drejtat e Njeriut për Profesionistët Ligjorë (HELP)

Në korrik 2024 me ftesë të Programit të Këshillit të Evropës për Edukimin e të Drejtave të Njeriut për Profesionistët Ligjorë (HELP), Drejtori Ekzekutiv i Akademisë së Drejtësisë mori pjesë në Konferencën vjetore 2024. Konferenca u mbajt në ambientet e Këshillit të Evropës (KE) në Strasburg, Francë dhe u ndoq nga 125 pjesëmarrës personalisht dhe nga rreth 100 pjesëmarrës përmes platformës online. Konferenca Vjetore e Rrjetit HELP është mbledhja kryesore e anëtarëve të Rrjetit HELP (përfaqësues të institucioneve kombëtare të trajnimit gjyqësor për gjyqtarë, prokurorë dhe avokatë) dhe partnerë të tillë si Rrjeti Evropian i Trajnimit Gjyqësor (EJTN), Këshilli i Avokatëve dhe Shoqatave të Avokatisë së Evropës (CCBE), Agjencia e BE-së për të Drejtat Themelore (FRA), etj. Ngjarja u transmetua gjithashtu online.

10. Konferenca e III regjionale-Më të fuqishëm së bashku: Gazetarët dhe gjyqësori në mbrojtje të lirisë së medias

Në shtator 2024, në Mavrovë të Maqedonisë së Veriut është realizuar konferenca “Më të fortë së bashku: gazetarë, gjyqtarë, prokurorë, avokatë dhe profesionistë të medias” në të cilën kanë marrë pjesë mbi 100 profesionistë nga Ballkani Perëndimor dhe Evropa përfshirë edhe përfaqësuesin nga Akademia e Drejtësisë.

Fokusi kryesor i konferencës ishte pasiguria ligjore e gazetarëve dhe punonjësve të medias, mekanizmat për mbrojtjen ligjore të profesionistëve të medias si dhe sfidat me padi strategjike kundër pjesëmarrjes publike (SLAPPs).

Akademia e Drejtësisë në këtë konferencë përfitoi mundësinë e bashkëpunimit në të ardhmen me organizatorët e konferencës për ruajtjen e sundimit të ligjit në Ballkanin Perëndimor. Konferenca është organizuar nga Komiteti Holandez i Helsinkit, Freepress Unlimited dhe Shoqata e gazetarëve të Maqedonisë së Veriut.

11. Programi i Zhvillimit të së Drejtës Tregtare (CLDP)

Në shtator 2024, në mbështetje të Departamentit të Drejtësisë Amerikane, Programi për Zhvillim të Drejtësisë Komerciale, dhe në bashkëpunim me Akademinë e Drejtësisë, në Tivar të Malit të zi është realizuar punëtori për gjyqtarët e Gjykatës Komerciale. Qëllimi i kësaj punëtorie ishte shkëmbimi i përvojave dhe praktikave më të mira në çështjet komerciale. Pjesëmarrës në këtë punëtori ishin 8 gjyqtarë nga Kosova dhe zyrtari për trajnime të vazhdueshme.

12. Programi i Shkëmbimit me Akademinë e Drejtësisë së Turqisë

Në shtator të vitit 2024 për tetë ditë me radhë në Ankara të Turqisë është realizuar një program shkëmbimi një javor për gjyqtarët nga vendet e Ballkanit Perëndimor, përkatësisht për gjyqtarët nga Kosova, Maqedonia e Veriut, Bosna dhe Hercegovina si dhe të Rumanisë. Programi ishte i dedikuar gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapo emëruar dhe kishte qëllim diskutimin dhe krahasimin e sistemit të drejtësisë të vendeve pjesëmarrëse. Gjyqtarët dhe prokurorët pjesëmarrës kanë pasur mundësinë e prezantimit të sistemit gjyqësor dhe prokurorial të vendeve përfaqësuese dhe të njihen për së afërmi edhe funksionimin e sistemit të drejtësisë në Turi përmes vizitave praktike në institucionet e sistemit gjyqësor dhe prokurorial të Turqisë. Pjesëmarrës në këtë program shkëmbimi ka qenë një gjyqtar nga Gjykata Themelore në Prizren.

13 Seminar ndërkombëtar: “Të miturit e pashoqëruar si viktime ose dëshmitarë në një rrjet të krimit të organizuar”

Në nëntor të vitit 2024, në Napoli të Italisë është realizuar seminari ndërkombëtarë me temë: “Të miturit e pashoqëruar si viktime ose dëshmitarë në një rrjet të krimit të organizuar”. Pjesëmarrja nga Kosova, përkatësisht përfaqësuesit të AD-së si dhe një gjyqtari dhe dy prokurorëve ka qenë me ftesën e Shkollës së

Magjistraturës së Francës. Seminari përfshiu aktivitete dhe sesione të ndryshme për profesionistë nga shtete të ndryshme të Evropës, si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, akademikë si dhe përfaqësues të organizatave që punojnë me të mitur të pashoqëruar. Qëllimi i seminarit ishte përmirësimi i drejtësisë miqësore për fëmijët, në përputhje me strategjitë e Bashkimit Evropian.

14. Programi i Mentorimit për profesionistët ligjorë për qasjen e grave në drejtësi

Në nëntor të vitit 2024, në Tiranë me ftesën e Komitetit Drejtues të Projektit rajonal: “Qasja e Grave në Drejtësi: zbatimi i standardeve të Këshillit të Evropës për barazinë gjinore dhe dhunën ndaj grave”, përfaqësues të institucioneve të trajnimit gjyqësor përfshirë edhe nga Akademia e Drejtësisë kanë marrë pjesë në takimin për vlerësimin dhe shkëmbimin midis Partneritetit Lindor dhe të Ballkanit Perëndimor.

Takimi kishte qëllim diskutimin e barrierave sistematike me të cilat gratë ndeshen kur aksesojnë drejtësinë me theks te sfidat ligjore dhe institucionale ashtu edhe barrierat socio-kulturore që materializohen si paragjykim gjinor në sistemet e drejtësisë të vendeve të Partneritetit Lindor dhe të Ballkanit Perëndimor. Gjithashtu edhe luftimin e dhunës ndaj grave përmes veprimtarisë së tyre me ligj si institucione të trajnimit gjyqësor duke zhvilluar dhe zbatuar programe trajnuese për gjyqtarë, prokurorë dhe zbatues tjerë të ligjit që janë në përputhje me standardet e Këshillit të Evropës për barazinë gjinore dhe dhunën ndaj grave.

15. Punëtori identifikuese e sektorit gjyqësor: Kibernetika dhe provat digjitale

Në dhjetor 2024 në Vjenë të Austrisë, me ftesë të projektit CRDF GLOBAL, përfaqësues nga Gjyqësori i Kosovës dhe nga Akademia e Drejtësisë morën pjesë në punëtorinë me temë: “Kibernetika dhe provat digjitale”.

Qëllimi i kësaj punëtorie ishte diskutimi i sfidave dhe vështirësive të shteteve në nivel kombëtarë në luftimin e krimit kibernetik dhe përdorimit të forenzikës digjitale në hetimet gjyqësore. Gjatë kësaj punëtorie u zhvilluan diskutime dhe prezantime mbi praktikën më të mira, sfidat ligjore dhe teknologjike që lidhen me provat digjitale dhe rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe ndër-institucional.

6.7 NGRITJA E TRANSPARENCËS DHE MARRËDHËNIA ME PUBLIKUN

Akademia e Drejtësisë është angazhuar në bërjen publike të punës dhe aktiviteteve të saj përmes përmes portalit dhe Web faqes dhe platformave tjera si linedln dhe facebook. Gjithashtu ka publikuar të gjitha vendimet e KD-së që janë marrë gjatë vitit për punën e AD-së, janë bërë njoftimet për të gjitha proceset e rekrutimit që janë realizuar gjatë vitit dhe janë publikuar në faqen e saj, shpalljet dhe thirrjet për aktivitete të ndryshme, programet trajnuese, kalendari i trajnimeve, njoftimet për realizimin e trajnimeve. Në total janë gjithësejt 618 azhurnime të reja në faqen e AD-së me 499 njoftime në kategorinë e lajmeve dhe aktiviteteve, 2 në aspektin e rregullativës ligjor, 44 vendime të reja, 7 në shpallje publike, 12 për vendet e lira si dhe publikime të dokumenteve periodike të AD-së, agjendave dhe njoftime tjera. Në facebook janë gjithësejt 64 publikime dhe në LinkedIn 33 publikime. E gjitha kjo për të lehtësuar qasjen për komunitetin ligjor dhe publikun në përgjithësi.

6.8 NGRITJA E CILËSISË SË SHËRBIMEVE ADMINISTRATIVE DHE SHPENZIMEVE FINANCIARE TË BUXHETIT

Sipas Planit të punës dhe të performancës për vitin 2024, shërbimet ligjore, komunikimi, bashkëpunimi ndërinstitucional dhe ndërkombëtar, shërbimet e teknologjisë së informacionit, si dhe shërbimet mbështetëse dhe logjistike janë fokusuar në realizimin e të gjitha aktiviteteve të planifikuara.

Aktivitetet e Departamentit për Shërbime Ligjore dhe të Përgjithshme janë përqendruar në ofrimin e kontributit përmes komenteve dhe sugjerimeve në hartimin e plotësim-ndryshimeve të Ligjit të AD. Në mbështetje të punës së Këshillit Drejtues dhe punës së Këshillit Programor dhe në mbështetje të Departamentit të Programeve si dhe njesive tjera të AD. Gjithashtu, janë ndërmarrë aktivitete të shtuara në fushën e shërbimeve të teknologjisë së informacionit, sigurimin e kushteve fizike të punës, pajisjet e nevojshme, si dhe ofrimin e shërbimeve mbështetëse dhe logjistike, në bashkëpunim ndërinstitucional dhe komunikim.

1. Departamenti për shërbime ligjore dhe të përgjithshme: gjatë vitit 2024 ka realizuar aktivitetet e AD-së në pajtim me përgjegjësitë e tij dhe atë si në vijim:

- Hartimi i Rregullores Nr. 01/2024 për Trajnimin Fillestar.
- Hartimi i Rregullores Nr. 01/2023 për Plotësim dhe Ndryshim të Rregullores Nr. 02/2019 për Trajnuesit dhe Mentorët e Akademisë së Drejtësisë.
- Hartimi i dyzet e tete (48) propozim-vendimeve për punën e Këshillit Drejtues;
- Pjesëmarrja dhe dhënia e kontributeve në Grupin Punues për hartimin e Projektligjit të Akademisë së Drejtësisë të themeluar nga Ministria e Drejtësisë dhe në dokumentin për konsultim publik;
- Hartimi i Memorandumit të Bashkëpunimit ndërmjet Akademisë së Drejtësisë me Ministrinë e Drejtësisë dhe Oden e Ndërmjetësuesve për zhvillimin e trajnimeve rifreskuese për ndërmjetësues.

2. Divizioni për Shërbime Ligjore dhe Bashkëpunim Ndërinstitucional ka mbështet dhe organizuar punën e organeve Drejtuese të AD, si dhe në mungesë të Udhëheqësit të Divizionit për Mbështetje Administrative dhe Logjistike deri në buxhetimin e kësaj pozite, ka vazhduar të realizojë dhe mbikëqyrë aktivitetet e këtij divizioni. Në mbështetje të organeve drejtuese të AD ky divizion ka realizuar aktivitetet si në vijim:

- Organizimi dhe mbarëvajtja e tetë (8) takimeve të Këshillit Drejtues.
- Organizimi dhe mbarëvajtja e pesë (5) takimeve të Këshillit Programor të Akademisë së Drejtësisë.
- Hartimi i procesverbaleve të takimeve të organeve drejtuese dhe i rekomandimeve të Këshillit Programor.

Po ashtu pasi Këshilli Programor nuk ka qenë në përbërje të plotë sipas dispozitave ligjore, kemi iniciuar procesin e rekrutimit për një (1) anëtar të Këshillit Programor. Ky proces pritet të finalizohet në takimin e parë të Këshillit Drejtues në vitin 2025.

Në funksion të zbatimit të planit të punës dhe obligimeve kontraktuale me operatorë të ndryshëm ekonomikë, si dhe përgjegjësi institucionale ndaj Agjencisë Kundër Korrupsionit, janë hartuar propozim-vendime të brendshme që kanë ndikuar në realizimin e këtyre përgjegjësi dhe zbatimin e tyre.

Gjatë vitit 2024, Divizioni për Shërbime Ligjore dhe Bashkëpunim Ndërinstitucional ka vazhduar bashkëpunimin ndërinstitucional dhe ndërkombëtar, duke realizuar aktivitete, seminare dhe vizita studimore në bashkëpunim me partnerë ndërkombëtarë. Nga këto aktivitete të cilat janë të shfaqura më lartë në këtë raport veq e veq, përfituesit e Akademisë së Drejtësisë kanë pasur mundësinë të marrin njohuri të reja për forcimin e kapaciteteve të tyre profesionale.

Si pjesë e këtij bashkëpunimi dhe me qëllim të ngritjes së kapaciteteve në fushën e gjyqësorit dhe prokurorisë, gjatë vitit 2024, Akademia e Drejtësisë ka bashkëpunuar me një numër të konsiderueshëm projektesh për zhvillimin e programeve të ndryshme ligjore. Në këtë drejtim, janë organizuar një sërë aktivitetesh dhe seminaresh, ku përfitues kanë qenë gjyqtarë dhe prokurorë të niveleve të ndryshme nga Kosova.

3. Divizioni për Mbështetje administrative dhe Logjistikë: deri në plotësimin e pozitës së Udhëheqësit të Divizionit aktivitetet e realizuar në këtë divizion janë ndërmarr dhe mbikëqyrur nga Udhëheqësi i Divizionit për Shërbime Ligjore dhe Bashkëpunim Ndërinstitucional. Në kuadër të këtij divizioni janë realizuar aktivitetet e ndërlidhura në zbatimin e procedurave për menaxhimin dhe administrimin e pasurisë, inventarit, mallrave dhe pajisjeve tjera të zyrës. Si çdo vit me radhë ka vazhduar në mënyrë të rregullt regjistrimin e aseteve/pasurisë jo financiare në sistemin E-pasuri dhe SIMFK-së, varësisht nga blerjet e aseteve brenda vitit. Është angazhuar në pranimin e faturave nga kompanitë kontraktuese të AD-së dhe regjistrimin e tyre sipas specifikave, protokolimit dhe dërgimit të tyre tek zyrtari i zotues. Një pjesë e konsiderueshme e punës së këtij divizioni ishte e përqendruar në mirëmbajtjen e pajisjeve për hyrjet dhe daljet, përgatitjen e sallave dhe mirëmbajtjen e tyre si dhe sigurimin e kushteve për mbajtjen e trajnimeve konform kërkesave të programeve trajnuese.

6.8.1 Riorganizimi i brendshëm dhe sistematizimi i vendeve të punës

Në periudhën raportuese prioriteti i AD-së ishte zbatimi dhe përmbyllja e procesit të kërkesave nga reforma e administratës publike, respektivisht zbatimi i Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, si dhe Rregullores nr.05/2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës.

Në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, Rregullores Nr. 14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, si dhe Rregullores nr.05/2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës në AD, është përfunduar procesi i ristrukturimit të secilit nëpunës civil të Akademisë së Drejtësisë dhe janë lëshuar aktet e reja të emërimit. Secili prej tyre varësisht nga pozitat që mbajnë janë përgjegjës për funksionimin më të mirë të AD-së në zbatim të mandatit të saj me ligj.

Si rezultat i ristrukturimit të brendshëm dhe pozitave të lira janë zhvilluar gjithsej 14 (katërbëdhjetë) procedura të rekrutimit. Prej tyre 9 (nëntë) procedura kanë përfunduar me sukses dhe 5 (pesë) procedura kanë rezultuar pa kandidat fitues. Një nga këto pozita fillon punën nga data 03 janar 2025 deri sa akti i emërimit është nënshkruar me datë 27.12.2024. Në muajin prill 1 (një) zyrtar është kthyer nga pushimi pa pagesë. Në muajin nëntor 1 (një) nëpunës është kthyer nga pushimi i lehonisë, si dhe 2 (dy) nëpunës kanë dhënë dorëheqje.

6.8.2 Përdorimi i teknologjisë informative për realizimin e funksioneve të Akademisë së Drejtësisë

Një pjesë e konsiderueshme e aktivitetëve ka qenë e fokusuar edhe në shtimin e paisjeve. Janë blerë 5 (pesë) kompjuter për stafin e ri të AD-së, 2 (dy) sete të pajisjeve të përkthimit dhe janë montuar në dy salla të AD-së si dhe 5 (pesë) UPS për stafin e AD-së.

Vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe faqes zyrtare dhe rrjeteve tjera sociale të AD-së me plotësimin dhe rifreskimin e informatave si dhe lëshimit online në dy periudha të kursit në platformën e mësimin në distancë me temë: Hetimet financiare dhe rikuperimi i aseteve.

Përveç kësaj, janë publikuar aktet nënligjore të miratuara nga Këshilli Drejtues si dhe dokumentet strategjike të AD, duke siguruar transparencë dhe qasje të lehtë në informacionin e rëndësishëm institucional.

6.8.3 Planifikimi i prokurimit

Akademia e Drejtësisë ka hartuar planifikimin e prokurimit për vitin 2024 sipas legjislacionit në fuqi si dhe në baze të kërkesave dhe nevojave vjetore nga të gjitha departamente e AD. Planifikimi i prokurimit ka përfshinë përshkrimin e punëve/furnizimeve dhe shërbimeve së bashku me vlerën e parashikuar. Sipas ndryshimeve ligjore në fushën e prokurimit, AD si institucion me më pak se 50 nëpunës nuk ka të drejtë të zhvilloj procedura të prokurimit prandaj edhe të gjitha aktivitetet e prokurimit i ka realizuar përmes AQP-së.

Gjatë vitit 2024 janë realizuar furnizimet me pajisje të Teknologjisë Informative-Furnizim, me pajisje të përkthimit me PC dhe UPS. Furnizim me karburante për vetura, për ngrohje dhe gjenerator. Furnizim me materiale të shtypura dhe dizajn (botime dhe publikime), me letër për kopje, material të ndryshëm zyrtarë, me artikuj të ndryshëm ushqimor-furnizim me produkte për kafiteri, shërbime të akomodimit, ushqimit dhe pijeve për pjesëmarrësit në trajnime në Prishtinë dhe Brezovicë-Prevallë, servisimi dhe mirëmbajtje të automjeteve, shërbime të sigurimit fizik të objektit, pastrimit dhe mirëmbajtjes së objektit, shërbime të transportit ajror si dhe shërbime të fotokopjimit dhe printerëve me qira.

Për të njëjtat furnizime janë realizuar aktivitetet e prokurimit për të cilat janë nënshkruar kontrata nga AQP për Nivelin Qendror dhe për Agjencitë e Pavarura, pjesë e të cilave ishte edhe AD

Gjatë vitit 2024, ky divizion ka qenë i përqendruar në dixhitalizimin e mëtejshëm të shërbimeve, avancimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve dhe sistemeve të Akademisë së Drejtësisë. Intensiteti i trajnimeve dhe numri i pjesëmarrësve në trajnime ka pasur impakt në punën e këtij divizioni. Sidomos në mirëmbajtjen e pajisjeve si kompjuterë, llap top, server, telefona fiks dhe pasije tjera tjera dhe mbështetje e vazhdueshme për stafin, trajnuesit dhe pjesëmarrësit për çështjet e Teknologjisë Informative. Veçanërisht realizimin e testeve dhe vlerësimeve në mënyrë dixhitale të gjyqtarëve të sapo emëruar që kanë përfunduar trajnimin fillestar gjatë këtij viti.

7. PLANIFIKIMI DHE EKZEKUTIMI I BUXHETIT DHE RAPORTI FINANCIAR

Divizioni për Buxhet dhe financa (DBF) është përgjegjës për menaxhimin e financave me mbikëqyrje dhe përcjellje të shpenzimeve financiare të buxhetit, monitorimin dhe ekzekutimin e të gjitha transaksioneve financiare në kuadër të Akademisë së Drejtësisë duke respektuar legjislacionin në fuqi. Gjithashtu mbajtjen e evidencës së kërkesave dhe përcjelljes së realizimit të faturave për obligimet ndaj furnitorëve sipas kodeve ekonomike si dhe bënë analiza të shpenzimeve sipas destinimeve dhe kategorive ekonomike, ndërmarrjen e veprimeve të duhura që të shlyhen saktë dhe me kohë të gjitha detyrimet ndaj partnerëve brenda afatit ligjor dhe raportimin për obligimet e pakryera.

Në mbështetje të Ligjit mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës, buxheti i aprovuar për Akademinë Drejtësisë për vitin 2024 ishte 863,244.98 euro, ndërsa buxheti përfundimtar duke i përfshirë kursimet, reduktimet dhe donacionet e menaxhuara përmes llogarisë së Thesarit ishte 739,643.38 euro. Gjatë vitit 2024 janë realizuar aktivitetet si ne vijim:

- Janë përgatitur pasqyrat vjetore financiare për vitin 2023;
- Është përgatitur pyetësi për vetëvlerësim për vitin 2023;
- Është përgatitur rrjedha e parasë së gatshme për vitin 2024;
- Është përgatitur Korniza Afatmesme e Shpenzimeve dhe Buxheti për periudhën 2025-2027;
- Janë bërë barazimet periodike të shpenzimeve me thesar;
- Janë përgatitur raporte të ndryshme periodike financiare;

- Të gjitha shpenzimet e proceduara për këtë periudhë janë regjistruar në databazën e brendshme të financave dhe në SIMFK.

Shpenzimet e krijuara gjatë kësaj periudhe janë mbuluar nga Buxheti i Republikës së Kosovës si burim kryesor financiar si dhe nga mbështetja e granteve të donatorëve.

Shpenzimet e buxhetit përfshihen në këto kategori kryesore ekonomike: pagat dhe mëditjet, mallrat dhe shërbimet, shpenzimet komunale dhe shpenzime kapitale. Tabela në vijim pasqyron buxhetin fillestar dhe buxhetin përfundimtar për vitin 2024, duke përfshirë kategoritë ekonomike.

Buxheti dhe Shpenzimet 2024				
Kategoria	Buxheti fillestar	Reduktimet dhe kursimet buxhetore	Buxheti përfundimtar	Shpenzimet
Pagat dhe Mëditjet	276,797.00	(22,154.22)	254,651.78	254,448.62
Mallrat dhe Shërbimet	519,948.00	(100,000.00)	419,948.00	349,774.02
Shpenzimet Komunale	16,500.00	(5,500.00)	11,000.00	10,505.55
Shpenzime Kpitale	50,000.00	-	50,000.00	48,548.51
Donacionet	-	-	4,043.60	4,043.60
Totali	863,245.00	(127,645.22)	739,643.38	667,320.30

Tabela nr. 19: Raporti i Buxheti për vitin 2024

Ligjin mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, buxheti fillestar për këtë vit ka qenë 863,244.98 euro, për të gjitha kategoritë ekonomike përfshirë këtu pagat dhe mëditje, mallrat dhe shërbimet, shpenzime komunale dhe shpenzime kapitale.

Totali i donacioneve të realizuara për vitin 2024 ka qenë 4,043.60 euro dhe janë donacion nga UNDP, nga të cilat 43.60 euro janë bartje nga viti i 2023.


Buxheti përfundimtar për vitin 2024 në të gjitha kategoritë në vlerë prej 739,643.38 euro (BKK 735,599.78 + donacione 4,043.60):

- Paga dhe shtesa, buxheti ka qenë 276,796.98 euro, ndërsa sipas vendimit të datës 24.12.2024 me numër 03/239 të Qeverisë së Republikës së Kosovës është reduktuar buxheti në këtë kategori për 22,145.20 euro që do të thotë se buxheti përfundimtar është në vlerë prej 254,651.78 euro,
- Mallra dhe shërbime, buxheti ka qenë 519,948.00 euro, ndërsa sipas vendimit të datës 18.12.2024 me numër 14/238 të Qeverisë së Republikës së Kosovës është reduktuar buxheti në këtë kategori për 100,000.00 euro, buxheti përfundimtar në këtë kategori është 423,399.16 euro prej të cilave 419,948.00 janë nga buxheti dhe 4,043.60 euro janë donacion nga UNDP,
- Shpenzime komunal, buxheti ka qenë 16,500.00 euro, ndërsa sipas vendimit të datës 18.12.2024 me numër 14/238 të Qeverisë së Republikës së Kosovës është reduktuar buxheti në këtë kategori për 5,500.00 euro, buxheti përfundimtar në këtë kategori është 11,000.00 euro,
- Shpenzime kapitale, buxheti ka qenë 50,000.00 euro.

Kategoria	Buxheti	Shpenzimet	Shpenzimet në % në raport me buxhetin total	Mbetja	Përqindja	Shpërndarja e buxhetit në %
Pagat dhe Mëditjet	254,651.78	254,448.62	38.36%	203.16	99.92	34.62
Mallrat dhe Shërbimet	419,948.00	349,774.02	52.73%	70,173.98	83.29	57.09
Shpenzimet Komunale	11,000.00	10,505.55	1.58%	494.45	95.51	1.50


Shpenzime Kapitale	50,000.00	48,548.51	7.32%	1,451.49	97.10	6.80
Totali	735,599.78	663,276.70	98.42%	72,323.08	90.17	98.50

Tabela nr. 20: Ekzekutimi i Buxhetit për vitin 2024




Grafikoni nr. 2: Ekzekutimi i Buxhetit për vitin 2024

Nga buxheti përfundimtar janë shpenzuar 663,276.70 euro apo 90.17 % e buxhetit.



Grafikoni nr. 3: Shpërndarja e buxhetit

Siç shihet në grafikon se 35% e buxhetit përfundimtar është ndarë për paga dhe shtesa, 57% për mallra dhe shërbime, 1% për shpenzimet komunale dhe 7% për shpenzime kapitale.



Grafikoni nr. 4: Shpenzimi i buxhetit

Në raport me shumën totale të buxhetit të shpenzuar: pagat dhe shtesa janë 38.36%, mallrat dhe shërbimet janë 52.73%, shpenzimet komunale janë 1.58% dhe shpenzime kapitale janë 7.32%.

Në tabelën në vazhdim përveç kategorive ekonomike shpenzimet prezantohen edhe për nënkategoritë ekonomike duke krahasuar me buxhetin e vitit për secilën kategori dhe nënkategori.

Buxheti dhe shpenzimet sipas kategorive dhe nënkategorive për vitin 2024					
Kategoria	Nënkategoria	Shpenzimet	Buxheti	Ndryshimi	Përqindja
Paga					
11110	Pagat neto përmes listës	216,058.66	216,261.82	203.16	99.91
11500	Tatimi i ndalur në të ardhura	14,136.88	14,136.88	-	100.00
11600	Kontributi i punëtorit	12,126.54	12,126.54	-	100.00
11700	Kontributi i punëdhënësit	12,126.54	12,126.54	-	100.00
Shuma		254,448.62	254,651.78	203.16	99.92
Mallra dhe Shërbime					
13132	Akomodimi udhëtime zyrtre brenda vendit	-	2,000.00	2,000.00	-
13141	Meditjet për udhëtime zyrtre jashtë vendit	5,977.09	8,000.00	2,022.91	74.71
13142	Akomodimi udhëtime zyrtre jashtë vendit	567.16	4,000.00	3,432.84	14.18
13143	Shpenzime tjera udhëtime zyrtre jashtë vendit	233.40	1,000.00	766.60	23.34
13320	Shpenzimet e telefonisë mobile	2,176.62	3,300.00	1,123.38	65.96
13330	Shpenzimet postare	-	200.00	200.00	-
13410	Shërbimet e arsimit trajnimit	154,126.44	157,448.00	3,321.56	97.89
13430	Shërbime të ndryshme shëndetsore	-	200.00	200.00	-
13440	Shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshilldhënës	6,603.90	8,000.00	1,396.10	82.55
13450	Shërbime shtypje-jo marketing	-	300.00	300.00	-
13460	Shërbime kontraktuese tjera	36,200.05	40,000.00	3,799.95	90.50
13501	Mobilje (me pak se 1000 euro)	620.00	5,000.00	4,380.00	12.40
13509	Pajisje tjera	3,222.90	3,000.00	(222.90)	107.43
13610	Furnizime per zyre	656.80	11,000.00	10,343.20	5.97
13620	Furnizim me ushqim, pije (jo dreka zyrtare)	2,994.08	5,000.00	2,005.92	59.88
13640	Furnizime pastrimi	-	-	-	-
13720	Nafte per ngrohje qendrore	14,879.10	20,000.00	5,120.90	74.40
13770	Derivate per generator	-	2,000.00	2,000.00	-
13780	Karburant per vetura	1,303.72	6,000.00	4,696.28	21.73
13810	Avancë për parat e imta	-	1,000.00	1,000.00	-
13950	Regjistrim i automjeteve	869.00	1,000.00	131.00	86.90
13951	Sigurimi i automjeteve	1,564.01	1,000.00	(564.01)	156.40
13952	Taksat Komunale e Regjistrimi te automjeteve	-	200.00	200.00	-
13953	Sigurim i ndertesave dhe tjera	13,576.23	14,300.00	723.77	94.94
14010	Mirembajtje dhe riparim i automjeteve	1,006.00	4,000.00	2,994.00	25.15
14020	Mirembajtje e ndertesave	6,997.91	11,000.00	4,002.09	63.62
14040	Mirembajtje e teknologjise informative	-	1,500.00	1,500.00	-
14050	Mirembajtje e mobiljeve dhe pajisjeve	268.00	3,000.00	2,732.00	8.93
14110	Qiraja e ndertesave	90,000.00	90,000.00	-	100.00
14130	Qiraja per pajisjet	2,650.21	6,000.00	3,349.79	44.17
14140	Qiraja per makineri	640.00	-	(640.00)	-
14210	Reklamat dhe konkurset	-	500.00	500.00	-
14220	Botimet e publikimeve	2,448.80	9,000.00	6,551.20	27.21
14310	Dreka zyrtare	77.60	1,000.00	922.40	7.76
14410	Shpenzimet - Vendimet e gjykatave	117.00	-	(117.00)	-
Shuma		349,776.02	419,948.00	70,171.98	83.29
Komunali					
13210	Rryma	8,086.65	8,450.00	363.35	95.70
13220	Uji	291.61	300.00	8.39	97.20
13230	Mbeturinat	606.16	650.00	43.84	93.26
13250	Shpenzimet e telefonit	1,521.13	1,600.00	78.87	95.07
Shuma		10,505.55	11,000.00	494.45	95.51
Kapitale					
31610	Pajise të teknologjisë informative	48,548.51	50,000.00	1,451.49	97.10
Shuma		48,548.51	50,000.00	1,451.49	97.10
Totali		663,278.70	735,599.78	72,321.08	90.17

Tabela nr. 21: Shpenzimet për kategori dhe nën kategori ekonomik

Buxheti përfundimtar për vitet 2022-2024			
Kategoria	2022	2023	2024
Pagat dhe Shtesa	243,649.00	229,115.30	254,651.78
Mallrat dhe Shërbimet	400,000.00	435,000.00	4.19,948.00
Shpenzimet Komunale	16,500.00	16,500.00	11,000.00
Shpenzime Kpaitale	-	196,000.00	50,000.00
Totali	660,149.00	876,615.30	735,599.78

Tabela nr. 22: Krahasimi i buxhetit për vitet 2022 – 2024

Shpenzimet e prezantuara në kuadër të tabelës nr.26 janë shpenzimet e krijuara me rastin e implementimit të projektit me UNDP. Totali i donacioneve të realizuara për vitin 2024 ka qenë 4,043.60 euro, nga të cilat 43.60 euro janë bartje nga viti i 2023.

Mbështetja me grante nga donatorët

Donatorët				
Shpenzimet janar - dhjetor 2024				
Viti	Emri i Donatorit	Shpenzimet	Alokimi	Mbetja
2024	UNDP	4,043.60	4,043.60	-
Shuma		4,043.60	4,043.60	-

Tabela nr. 23: Donacionet e menaxhuara nga AD

Në tabelën 27 si me poshtë janë pasqyruar donacionet e menaxhuara nga vet donatorët që do të thotë se këto mjete nuk kanë rrjedhë përmes llogarisë së Thesarit.

Sipas informatave të ofruar nga përfaqësuesit e projekteve me donator në këtë tabelë bëhet shpalosja e mbështetjes financiare nga donatorët vetëm në totalin e shpenzimeve ashtu siç janë pranuar, pa pasur mundësi të shpalosen në detaje.

Prezantimi dhe shpalosja e donacioneve në këtë rast tregon qartë se AD edhe në këtë vit ka realizuar aktivitetet trajnuese në mbështetje të donatorëve të ndryshëm. Edhe pse nuk janë të specifikuar dhe të detajuara, shpenzimet e mbuluara kanë qenë kryesisht shpenzimet për shërbimet e trajnimit, shpenzimet e botimeve dhe publikimeve, shpenzimet për vizita studimore, vlera totale e këtyre shpenzimeve është 421,058.84 euro.

2024	
Emri i donatorit	Euro
Fondacioni për të drejtat e kafshëve	1,922.61
Humanitarian Law Center Kosovo	2,504.08
I PROCEDS-CYBERCOP	29,254.47
KE/Mbështetja e Gjykatës Kushtetuese në zbatimin dhe shpërndarjen e standardeve të GJEDNJ	12,896.57
Këshilli I Evropës-PRO-FREX	15,300.00
KOMF	10,279.92
UNODC	50,577.35
OPDAT	68,730.81
EULEX	14,578.43
QKRMT	1,405.60

FMC-NL dhe IKD	2,702.46
SCAC	3,500.00
Ambasada Franceze	1,330.00
WBROLI	115,000.00
GIZ	39,390.00
UNHCR	498.12
PECK III	8,849.90
CLARD	2,862.87
Terre des hommes Kosovo	2,520.00
Këshilli I Evropës-Përafrimi I ligjeve dhe olitikave me Konventën e Stambollit	8,400.00
IRZ	3,555.65
Totali i Granteve në euro	421,058.84

Tabela nr. 24: Donacionet e menaxhuara nga donatoret

7.1 Raportimi rreth adresimit të rekomandimeve të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm

Gjatë vitit 2024 ka përfunduar auditimi nga ZKA për vitin 2023 dhe është publikuar raporti i auditimit. Raporti Final i Auditimit të pasqyrave financiare të AD-së për vitin 2023 ka rezultuar pozitiv dhe pasqyrat vjetore financiare në të gjitha aspektet kanë prezantuar një pamje të drejtë dhe të vërtetë.

Me qellim të zbatimit të rekomandimeve të dala nga ky raport është përgatitur dhe zbatuar plani për rekomandimin e dhënë në lidhje me çështjet e gjetura gjatë vitit 2023.

Rekomandimet dhe plani i zbatimit për implementim të rekomandimeve

Nr	Gjetja	Veprimi i ndërmarrë	Afati i zbatimit	Statusi aktual i rekomandimit	Vlerësimi i rrezikut
1	Çështja B1 -Funksionimi i pozitave të lata udhëheqëse me ushtrues detyre	Për të gjitha pozitat që kanë qenë të lira kanë filluar proceset e rekrutimit në fillim të vitit 2024 dhe një pjesë e pozitave janë plotësuar		Realizuar	
2	Çështja A1 – Zotimi i mjeteve dhe nxjerrja e urdhër blerjes pas pranimit të faturës	Zotimi i mjeteve dhe nxjerrja e urdhërblerjeve do të kryhen para pranimit të faturave	Qershor - Dhjetor 2024	Realizuar	

Tabela nr. 25: Plani për zbatim të rekomandimeve

Gjetja B1, të gjitha pozitat që kanë qenë të mbuluara me ushtrues detyre janë plotësuar me staf të rregullit.

Gjetja A1, Pas pranimit të draft raportit të auditimit ka filluar të behet zotimi i mjeteve dhe nxjerrja e urdhërblerjeve para pranimit të faturave.

8. SFIDAT E VITIT PARAPRAK DHE REKOMANDIMET PËR VITIN 2025

AD për gjatë vitit 2024 është përballur me sidat si në vijim:

1. Zhvillimet dhe përfundimi i Projektligjit për Ligjin për Akademinë e Drejtësisë

2. Buxheti jo i mjaftueshëm sipas planifikimeve të përcaktuara për realizimin e të gjitha aktiviteteve në programet e trajnimit, me shume se 60% e aktiviteteve trajnuese ne PTV financohen nga donatorët
3. Staf i jo i mjaftueshëm në raport me kërkesat për programe trajnuese dhe aktivitete tjera sipas ligjit dhe strategjive, si dhe mos përfshirja ne buxhet e 4 pozitave te miratuar me Rregullores nr.05/2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës ne AD.
4. Zbatimi i mekanizmave për vlerësimin e efektit të trajnimeve në punë sipas Doracakut për trajnues;
5. Hapësira e pamjaftueshme dhe jo e përshtatshme e objektit për të përmbushur aktivitetet trajnuese sipas programit
6. Zbatimi i trajnimeve fillestare në periudha të caktuara paralelisht me nga dy gjenerata dhe dy profile njëkohësisht
7. Vështirësitë gjatë përdorimit të sistemit ri për menaxhimin e aktiviteteve trajnuese SMAT

Për tejkalimin e sfidave të lartpërmendura, Akademia e Drejtësisë jep këto rekomandime:

1. Ligji i ri për AD të sigurojë pavarësinë institucionale dhe të adresojë mangësitë dhe pengesat ligjore që i ka ligji aktual në fuqi;
2. Rritja e buxhetit sipas nevojave dhe kërkesës buxhetore të AD-së , duke përfshi edhe 4 pozitave për staf si te parapare me Rregullores nr.05/2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës ne AD.
3. Plotësimi i pozitave të lira dhe pozitave sipas rregullore për organizimin e brendshëm të AD-së
4. Bashkëpunimi me përfituesit e trajnimeve për zbatimin e mekanizmave për efektin e trajnimit në praktikë
5. Sipas pikes 5 dhe 6 Kordinimi dhe bashkëpunimi me me KGJK dhe KPK ;
6. Mirëmbajtja e vazhdueshme e për përdorimin e plotë moduleve të SMAT dhe përfshirja e trajnuesve dhe përfituesve të trajnimeve në përdorimin e platformës

9. Shtojcat

1. Tabela me indikatorët dhe performancën e AD-së për vitin 2024
2. Aneksi I-Trajnimet e realizuara në të gjitha programet e AD-së
3. Aneksi II-Trajnimet e realizuara në PTF;
4. Aneksi III-Trajnimet e realizuara në PTV;
5. Aneksi IV-Aktivitetet e realizuara për stafin administrativ të gjykatave dhe prokurorive;
6. Ankesi V-Trajnimet e realizuara për trajnues;
7. Aneksi VI-Trajnimet e realizuara për profesionet e lira;
8. Aneksi VII-Trajnimet e realizuara përmes platformës së mësimin në distancë;
9. Aneksi VIII-Aktivitetet e realizuara në PHP;
10. Aneksi IX-Aktivitetet me donatorë

Shtojca 1. Tabela me indikatorët dhe performancën e AD-së për vitin 2024

Objektivi i përgjithshëm	Nën objektivi	Veprimi	Indikator/Rezultati
1. Përgatitja profesionale e gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapo emëruar të gjeneratës së X si dhe Hartimi dhe zbatimi i programeve për gjyqtarët e gjeneratës së XI, XII dhe prokurorët e gjeneratës së XI	Zbatimi i trajnimit fillestar për 29 gjyqtarët e sapo emëruar të gjeneratës së X në trajnimin praktik në gjykata nën mbikëqyrjen e mentorit (gjyqtarë) dhe realizimi i testit përfundimtarë.	Organizimi i trajnimeve dhe monitorimi i përmbushjes së trajnimit praktik	29 gjyqtarë të kësaj gjenerate kanë përfunduar trajnimin praktik dhe rrjedhimisht edhe trajnimin fillestar. Është realizuar testi përfundimtar për 29 gjyqtarët e kësaj gjenerate. Është hartuar dhe dërguar Raporti në KGJK, përkatësisht Komisionin për vlerësimin e performancës
	Zbatimi i trajnimit fillestar për 21 prokurorët e sapo emëruar të gjeneratës së X si dhe realizimi i testit përfundimtarë	Organizimi i trajnimeve dhe monitorimi i përmbushjes së trajnimit teorik dhe praktik	21 prokurorë të kësaj gjenerate përfshirë edhe 2 prokurorë të gjeneratës së kaluar të cilat për shkak të pushimit të lehonisë e kanë ndërprerë trajnimin me gjeneratën e tyre kanë përfunduar trajnimin fillestar. Është realizuar testi përfundimtar për prokuror. Është hartuar Raporti përfundimtar për këtë gjenerate dhe është dërguar në KPK-së përkatësisht në Komisionin për vlerësimin e performances.
	Zhvillimi dhe zbatimi i programeve trajnuese për gjeneratën e XI të gjyqtarëve rinj,	Organizimi i trajnimeve dhe monitorimi i përmbushjes së trajnimit teorik dhe praktik	Është hartuar Programi përshtatshëm me kërkesat e KGJK-së nga Këshilli Programor. Trajnimi ka filluar së zbatuari nga muaji shkurt 2024 dhe pritet të përfundoj me 25 shkurt të vitit 2025 Numri i gjyqtarëve në trajnim është 15. Aktualisht janë në process të përmbushjes së trajnimit praktik në gjykata dhe realizimit të estit përfundimtar.
	Zhvillimi dhe zbatimi i programeve trajnuese për gjeneratën e XII të gjyqtarëve rinj,	Organizimi i trajnimeve dhe monitorimi i përmbushjes së trajnimit teorik dhe praktik	Trajnimi ka filluar së zbatuari nga muaji shtator 2024 dhe pritet të përfundoj në shtator të vitit 2025. Numri i gjyqtarëve në trajnim është 31. Aktualisht janë në proces të përmbushjes së trajnimit teorik për të vazhduar më tutje edhe 6 muaj gjatë vitit 2025 në trajnimin praktik në gjykatat përkatëse të emërimit.
2. Avancimi i vazhdueshëm i njohurive profesionale dhe interdisciplinare të gjyqtarëve, prokurorëve, stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial si dhe profesionistëve tjerë ligjor	Zhvillimi dhe zbatimi i trajnimeve dhe aktiviteteve tjera që janë rezultat i kërkesave nga dokumentet strategjike	Organizimi i trajnimeve dhe aktiviteteve tjera në përmbushje të masave	Prej 48 masave që përfshijnë aktivitete trajnuese, hartim të kurrikulave trajnuese dhe aktivitete tjera, përqindja e zbatimit të plotë është 65%, përqindja e aktiviteteve në zbatim e sipër 23 % dhe përqindja e aktiviteteve të pa zbatuara 13 %. Nga 6 masa sipas të cilave parashihej zhvillim i kurrikulave trajnuese konform standardeve të Konventës së Stambollit dhe ofrimit të trajnimeve për gjyqtarët, prokurorët dhe profesionistët e tjerë ligjor janë përmbushur të gjitha. Nga kërkesat që dalin nga Programi Kombëtar për të Drejtat e Njeriut janë realizuar 3 aktivitetet kundër diskriminimit, 5 aktivitete trajnuese për KEDNJ, 1 aktivitet trajnues për procedurën penale të kryesve me çrregullime mendore dhe 8 aktivitete trajnuese për dhunën në Familje dhe dhunës me bazë gjinore vetëm

Objektivi i përgjithshëm	Nën objektivi	Veprimi	Indikatori/Rezultati
			për gjyqtarë pa përfshirë edhe trajnimet tjera në këtë fushë për avokatë, bashkëpunëtorë profesional dhe profesionistë tjerë ligjor. Si rezultat i Planit kombëtar për Integrim Evropian dhe Agjendës Evropiane janë realizuar 10 aktivitete trajnuese në fushën e hetimit financiar dhe pastrimit të parave si dhe për konfiskimin dhe sekuestrimin në kuadër të risive të KPPK-së
	Zbatimi i 9 trajnimeve, përfshirë edhe 6 të specializuara nga lëmia penale prej 225 si dhe 120 pjesëmarrës	Organizimi i trajnimeve për luftimin e krimeve të luftës, formave të korrupsionit dhe krimet të organizuar, krimet kibernetik si dhe dhunës në familje sipas metodave dhe standardeve më bashkëkohore	32 aktivitete trajnuese nga lëmia penale të realizuara me 577 pjesëmarrës
	Zbatimi i 10 trajnimeve në fushën civile me pjesëmarrje deri 200 pjesëmarrës	Organizimi dhe realizimi i tryezave	11 aktivitete trajnuese nga lëmia civile të realizuara me 299 pjesëmarrës
	Zbatimi i 3 trajnimeve në drejtësinë për fëmijë me rreth 50 pjesëmarrës	Organizimi dhe realizimi i trajnimeve nga drejtësia për fëmijë aspekti penal dhe civil	4 aktivitete trajnuese të realizuara me 89 pjesëmarrës
	Zbatimi i 11 trajnimeve nga lëmia komerciale me 110 pjesëmarrës	Organizimi dhe realizimi i trajnimeve	13 aktivitete trajnuese të realizuara me 322 pjesëmarrës
	Zbatimi i 7 trajnimeve nga drejtësia kushtetuese, administrative dhe kundërvajtëse me 90 pjesëmarrës	Organizimi dhe realizimi i trajnimeve	2 aktivitete trajnuese nga drejtësia kushtetuese të realizuara me 34 pjesëmarrës, 5 aktivitete trajnuese nga drejtësia administrative me 72 pjesëmarrës si dhe 2 trajnime në kundërvajtje me 17 pjesëmarrës
	Zbatimi i 4 trajnimeve për KEDNJ me 90 pjesëmarrës	Organizimi dhe realizimi i trajnimeve	5 aktivitete trajnuese të realizuara me 129 pjesëmarrës
	Zbatimi i 4 trajnimeve nga e Drejta e BE-së dhe e drejta ndërkombëtare me 80 pjesëmarrës	Organizimi dhe realizimi i trajnimeve	2 aktivitete trajnuese të realizuara me 48 pjesëmarrës
	Zbatimi i 2 trajnimeve nga kompetenca interdisciplinare me 60 pjesëmarrës	Organizimi dhe realizimi i trajnimeve	2 aktivitete trajnuese të realizuara me 50 pjesëmarrës
	Zbatimi i trajnimeve të obligueshme sipas kërkesave nga KGJK dhe KPK	Organizimi dhe realizimi i trajnimeve	Nuk ka pasur kërkesa për trajnime të detyrueshme nga KGJK dhe KPK prandaj nuk janë realizuar trajnime nga kjo kategori

Objektivi i përgjithshëm	Nën objektivi	Veprimi	Indikatori/Rezultati
	Zbatimi i 50 trajnimeve për bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarët ligjor të gjykatave dhe prokurorive me rreth 170 bashkëpunëtorë profesional dhe 30 yrtarë ligjor	Organizimi dhe realizimi i trajnimeve	60 trajnime të realizuara me pjesëmarrje prej 1524pjesëmarrës. Prej tyre 789 nga radhët e bashkëpunëtorëve profesional dhe 627 nga radhët e zyrtarëve ligjor
	Zbatimi i trajnimeve për stafin administrative dhe prokurorial me rreth 110 pjesëmarrës	Organizimi dhe realizimi i trajnimeve	15 trajnime të realizuara me 273 pjesëmarrës
	Ofrimi dhe zbatimi i trajnimeve sipas kërkesave të institucioneve të profesioneve të lira	Organizimi dhe realizimi i trajnimeve	14 trajnime të realizuara me 296 pjesëmarrës nga radhët e ndërmjetësuesve dhe 31 nga radhët e avokatëve
	Zbatimi i trajnimeve përmes platformës në distancë	Organizimi dhe realizimi i trajnimeve	2 sesione trajnuese në platformën MOODLE (kombinim online dhe fizikisht për hetimet financiare)
Rritja e kapaciteteve analitike dhe hulumtuese si dhe veprimtarisë botuese	Zbatimi i procesit për vlerësim të nevojave trajnuese për vitin 2025	Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave nga mekanizmat e zhvilluar	Është hartuar Raporti me analizën dhe vlerësimin e nevojave trajnuese për vitin 2025 i cili i ka paraprirë hartimit të programit trajnues për vitin 2025
	Identifikimi i praktikës gjyqësore të drejtë dhe vënia në dispozicion për profesionistët ligjor	Identifikimi i praktikës gjyqësore jo unike në çështje penale dhe civile	Përveç hulumtimit të praktikës gjyqësore me gjyqtarët e Gjykatës Supreme nuk ka pasur zhvillime tjera në këtë fushë.
	Zhvillimi i veprimtarisë botuese	Organizimi dhe mbikqyrja e procesit të hartimit dhe përmbledhja e materialeve ligjore	2 përmbledhje të praktikës gjyqësore me Gjykatën Supreme të hartuara dhe të publikuara
	Planifikimin institucional në zbatim të masave dhe politikave euro integruese	Hartimi i raporteve në baza periodike për zbatimin e masave të përcaktuara në Strategjinë për sundimin e Ligjit, Strategjinë për mbrojtjen nga Dhuna në Familje, CEPEJ dhe mekanizmat tjerë euro integrues	Raportet e hartuara dhe dërguar brenda afateve të përcaktuara nga autoritetet përkatëse.
Avancimi i mëtejme i metodologjisë trajnuese	Zbatimi i metodologjisë së mësimdhënies për të rritur në përputhje me doracakun për trajnues		Ky indikatorë është në proces të realizimit. Si mekanizëm i matjes së zbatimit të metodologjisë është hartuar raporti i vlerësimit të performancës së trajnuesve që në mes tjerash ka si kriter edhe metodologjinë trajnuese sipas doracakut për trajnues dhe është bërë vlerësimi nga KP dhe KD i AD-së.

Objektivi i përgjithshëm	Nën objektivi	Veprimi	Indikatori/Rezultati
	Zbatimi i trajnimit për trajnues		7 trajnime të realizuara për TIT. Prej tyre 4 për metodologji trajnuese sipas doracakut për trajnues. Për nenin 10 të KEDNJ-së, 1, për Standardet ndërkombëtare dhe evropiane për të drejtat e fëmijëve dhe drejtësinë për të mitur, teknikat e intervistimit, perspektiva gjinore dhe komunikimi miqësor me fëmijët gjatë proceseve gjyqësore, 1 si dhe për trajtimin rasteve të femicidit 1. Të trajnuar nga radhët gjithsejtë 114 trajnues të AD-së.
Ngritja e transparencës dhe marrëdhënia me publikun	Ofrimi i qasjes për palët e interesit		Azhurnim i faqes së AD-së me 618 postime 64 postime në facebook dhe 33 në LinkedIn
Ngritja e cilësisë së shërbimeve administrative dhe shpenzimeve financiare dhe të buxhetit	Rishikimi i akteve nënligjore në pajtim me reformën legjislativë dhe Ligjin për AD-në	Hartimi i akteve nënligjore	2 Aktet nënligjore të hartuara dhe të miratuara
	Zhvillimin, menaxhimin dhe ngritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore	Zbatimi i procesit të rekrutimit për pozitat e lira ndjekja e trajnimeve të ndryshme për zhvillim profesional të stafit të AD-së	14 procedura të rekrutimit të zhvilluara. 9 procedura kanë përfunduar me sukses dhe 5 procedura kanë rezultuar pa kandidat fitues.
	Planifikimi dhe ekzekutimi i buxhetit	Përgatitja e kërkesave buxhetore për vitin 2025-2027 për të gjitha aktivitetet e përfshira në buxhetim.	KASH 2025-2027 është hartuar sipas nevojave të AD dhe është dërguar në MFTP, ndërsa buxheti për vitin 2024 është realizuar rreth 90.17 %.
	Planifikimi i prokurimit dhe realizimi i suksesshëm me AQP	Hartimi i kërkesave, përcaktimi i fondeve në dispozicion dhe specifikacioneve teknike të dërguara në AQP për zhvillimin e procedurave të prokurimit Përcaktimi i menaxhereve dhe mbikëqyrësve të drejtpërdrejtë për menaxhimin e kontratave Hartimi i planit për menaxhimin e kontratave dhe menaxhimi i kontratave	Janë hartuar kërkesat për zhvillim të procedurave të prokurimit me specifikacionet teknike sipas nevojave të AD-së Janë caktuar menaxherët për zbatimin e kontratave të lidhura përmes AQP-së Është realizuar blerja e pajisjeve të teknologjisë informative sipas planifikimit Është realizuar blerja e mobileve si karrige, tavolina dhe dollapë pune për zyre Janë formuar komisionet për pranimin e mallrave dhe furnizimeve Janë realizuar të gjitha furnizimet me material zyrtar shpenzues, furnizimet me naftë, shfrytëzimi i veturave me qira, furnizim me ushqim të gatshëm dhe pije për pjesëmarrësit në Akademi, furnizim me materiale të shtypura dhe dizajn-botime dhe publikime si dhe

Objektivi i përgjithshëm	Nën objektivi	Veprimi	Indikatori/Rezultati
			furnizimet dhe shërbimet tjera që janë pranuar gjate tërë vitit
	Avancimi, përmirësimi dhe mirëmbajtja e teknologjisë informative në realizimin e funksioneve të Akademisë së Drejtësisë	<p>Mirëmbajtja dhe administrimi i pajisjeve harduerike dhe softuerike të AD-së;</p> <p>Administrimi dhe mirëmbajtja e SMAT</p> <p>Mbështetje për trajnuesit, pjesëmarrësit dhe stafin në përdorimin Teknologjisë Informative</p> <p>Administrimi dhe mirëmbajtja e përditësimi i web-faqes dhe rrjeteve sociale</p> <p>Mbështetje e trajnuesve dhe pjesëmarrësve për përdorimin e platformës së mësimin në distancë</p>	<p>Laptopët funksional për përdorim nga pjesëmarrësit në PTF,</p> <p>Paisjet harduerike dhe softuerike funksionale përfshirë lidhja në rrjet, kyçje në domain qasjen në internet, hapjen dhe qasjen në email adresa etj.</p> <p>Funksionimi i sistemit për menaxhimin e aktiviteteve trajnuese(SMAT)si sistem bazë në Akademinë e Drejtësisë për komplet menaxhimin e aktiviteteve trajnuese në PTF dhe PTV dhe aktivitete tjera të AD-së.</p> <p>Trajnuesit të mbështetur në përdorimin e pajisjeve për realizimin e trajnimeve si dhe vlerësimet për pjesëmarrësit.</p> <p>Pjesëmarrësit të mbështetur në përdorimin e sistemeve të AD-së gjatë trajnimeve si marrja e materialeve, vendosja e detyrave, vlerësimet e trajnimeve etj.</p> <p>Stafi i mbështetur gjatë punës së tyre duke evituar problemet nga ana e TI-së.</p> <p>Ueb faqja në funksion të vazhdueshëm dhe e përditësuar me zhvillimet e reja.</p> <p>Materialet trajnuese për kursin Hetimet financiare të integruara në plaformën e mësimin në distance duke përfshirë edhe pjesëmarrësit e regjistruar.</p>

Tabela nr. 26. Indikatorët e performancës

Aneksi I – Trajnimet e realizuar në të gjitha programet e AD-së

Trajnimet fillestare	Të trajnuar	Gjinia		Sesionet e trajnimit		Ditë trajnimi	Nr. i orëve	Sesione trajnuese	Trajnuesit	Mentorët
Gjyqtarë/prokurorë të sapo emëruar		M	F	teorik	praktik					
Gjyqtarët-gjen X	29	17	12	/	99	99	/	/	/	29
Prokurorët-gjen X	23 ¹⁰	14	9	26	66	112	156	52	15	22
Gjyqtarët-gjen XI	15	9	6	117	96	213	702	234	36	29
Gjyqtarët-gjen XII	31	17	14	79	/	79	474	158	26	/
Totali	98	57	41	222	261	734	1332	444	77	80
Gjyqtarët porot fillestar	15	12	3	/	/	2	/	/	3	3
TIT	99			/	/	11	/	/		/
Trajnimet e vazhdueshme	Nr.i trajnimeve	Nr. i trajnimeve në ditë		Nr. i pjesëmarrësve		Të realizuara nga AD	Të mbështetura nga donatorët	Trajnues të angazhuar		
								Trajnues sipas listes së AD-së	Ekspert të huaj	
Trajnime për gjyqtar dhe prokuror	84	125		gjyqtarë	962	11	73	63	41	
				prokuror	274					
				Profes. tjerë ligjor	478 ¹¹					
Trajnime për Bashkëpunorë profesional, zyrtarë ligjor dhe profesionistë tjerë	60	67		Bashkp. prof. dhe Zyrtare ligjor	789	34	26	15	6	
					627					
				Zyrtarë të ANJF	73					
				Tjerë ¹²	35					
Stafi administ. gjyqësor/prokuror.	15	17		273		11	4	6	/	
Menaxhim i prokurorise	1	1		20		/	1	/	1	
Profesione të lira - ndermjetesues & avokatë	14	26		327		/	14	12	2	
Totali	174	236		3858		56	118	96	50	
Trajnime në EJTN dhe ERA	6	12		8		/	/	/	/	

¹⁰ Grupit prej 22 prokurorëve sa ishin në këtë gjeneratë nga muaji dhjetor 2023 i është bashkuar prokuroria nga gjenerata e IX e cila për shkak të pushimit të lehonisë nuk ka përfunduar sesionet e trajnimit me gjeneratën përkatëse.

¹¹ Në trajnime bashkë me gjyqtarë dhe prokurorë kanë marrë pjesë edhe bashkëpunorë profesional, zyrtarë ligjor, staf administrativ gjyqësor dhe prokuror, zyrtarë të ndihmës juridike falas, zyrtarë nga shërbimi sprovues, mbrojtës të viktimave, avokat shtetëror, ndërmjetësues zyrtarë policor dhe profesionistë tjerë nga komuniteti ligjor.

¹² Zyrtarë nga Agjencia për Informim dhe Privatesi, nga Oda e Avokatëve, nga OJQ, IKD etj.

Aneksi II-Trajnimet e realizuara në PTF gjatë vitit 2024

Trajnimet e zbatuara për gjeneratën e X të gjyqtarëve

Muaji	Aktivitetet për gjyqtarët e sapo emëruara gjenerata e X	Numri i sesioneve në trajnim teorik	Numri i orëve në trajnim teorik	Numri i ditëve në trajnim praktik	Financuesi
Janar	Trajnimi praktik në gjykata në lëmin penale	/	/	20	AD
Shkurt	Trajnimi praktik në gjykata në lëmin civile	/	/	20	
Mars	Trajnimi praktik në gjykata në lëmin civile	/	/	21	
Prill	Trajnimi praktik në gjykata në lëmin civile	/	/	21	
Maj	Trajnimi praktik në gjykata në lëmin civile	/	/	17	
	Totali			99	

Trajnimet e zbatuara për gjeneratën e X të Prokurorëve

Muaji	Aktivitetet për prokurorët e sapo emëruara gjenerata e X	Nr. i sesioneve në trajnim teorik	Nr. i orëve në trajnim teorik	Nr. i ditëve në trajnim praktik Vizita në institucione jo gjyqësore	Financuesi
Janar	Aktakuza procedura e shqyrtimit	7	21	13	
	Procedurat alternative	5	15		
	Roli i prokurorit në shqyrtim gjyqësor	2	6		
	Totali	14	42	13	
Shkurt	Procedurat alternative	2	6	13	
	Shqyrtimi gjyqësor	5	15		
	Procedurat e veçanta sipas KPPK	4	12		
	Ushtrimi i mjeteve juridike	2	6		
	Arsyetimi i vendimeve akteve akuzuese	1	3		
	Totali	14	42	13	
Mars	Arsyetimi i vendimeve akteve akuzuese	3	9	13	
	Ushtrimi i mjeteve juridike	3	9		
	E drejta e BE-së	4	12		
	Udhëzuesi për politikën ndëshkimore	4	12		
